

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
Lënda numër: P Kr 448/2014

Aktgjykim i datës 7 gusht 2015

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jetë i formës së prere dhe mund të jetë objekt i ankesës në bazë të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Marie Tuma, si kryetare e trupit gjykues dhe gjyqtarja Shpresa Hasaj-Hyseni dhe gjyqtari i EULEX-it Vitor Hugo Pardal, si anëtar të trupit gjykues me Muhamet Musliun, si mbajtës të procesverbalit, në lëndën penale kundër të pandehurve G. A., R. A., E. G., A. S. dhe H. G.,

NGARKOHEN me Aktakuzë të Prokurorit Special të EULEX-it të Zyrës Speciale të Prokurorisë së Republikës së Kosovës (SPRK) **PPS nr.77/2013**, të datës 22 gusht 2014 dhe të ngritur me datën 25.08.2014, për pikat e akuzës si në vijim;

Pika 1 e akuzës – A. S.

Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale, në kundërshtim me nenin 283, 1 dhe 2, të Kodit Penal të Kosovës (KPRK), e dënueshme me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.

Për shkak se,

Nga marsi i vitit 2013 deri në nëntor të vitit 2013, i pandehuri i sipër përmendur, në territorin e Kosovës, domethënë në Prishtinë, kreu veprën penale të pjesëmarrjes në organizim të grupit të organizuar kriminal, duke:

1. organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe drejtuar veprimtaritë e një grupi të organizuar kriminal të përbërë nga R. A., G. A., E. G., H. G., E. G., I. E., A. D., P. F. dhe kryes të tjerë të paidentifikuar;
2. me qëllim që të kryej një apo më shumë vepra penale të dënueshme me burgim së paku katër vite, domethënë me qëllim që të kryhet një grabitje në një butik luksoz të “Rolex-it” në Qendrën Tregtare të Qytetit në M., qytetin e Bahrejnit, Mbretëria e Bahrejnit;
3. me qëllim dhe me dijeni ose të synimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit të organizuar kriminal, duke marr pjesë aktive në veprimtari kriminale të grupit, - në mënyrë që të fitojë, në mënyrë të drejt për drejt apo tërthorazi përfitime financiare dhe përfitime tjera materiale;

Pika 2 e akuzës - G. A., E. G., H. G. dhe R. A.

Pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale, në kundërshtim me nenin 283, par. 1, të KPRK-së, e dënueshme me gjobë deri në dyqindpesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim së paku shtatë (7) vite.

Sepse

Nga marsi i vitit 2013 deri në tetor të vitit 2013, të pandehurit e sipër përmendur plus A. D., P. F., E. G., I. E. si dhe kryes të tjerë të paidentifikuar, në territorin e Kosovës, Prishtinë, kryen veprën penale të pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal, duke:

- (1) pranuar të formojnë një grup personash nën udhëheqjen e të pandehurit D. D. me qëllim dhe me dijeni ose të qëllimit apo veprimtarisë së përgjithshme të grupit të organizuar kriminal dhe me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale të dënueshme me burgim së paku prej katër viteve;
- (2) domethënë, me qëllim që të kryejnë një grabitje në një butik luksoz të “Rolex-it” në Qendrën Tregtare të Qytetit në M., qytetin e Bahrejnit, Mbretëria e Bahrejnit;
- (3) duke marr pjesë aktivisht në veprimtarit kriminal të grupit, duke e ditur që një pjesëmarrje e tillë do të kontribuon në kryerjen e veprimtarive kriminale të grupit - në mënyrë që të fitojnë, në mënyrë të drejt për drejt apo tërthorazi përfitime financiare dhe përfitime tjera materiale.
- (4) Të pandehurit vendosen që të ndanin detyrat sipas një plani për të cilin kanë rënë dakord përgjithësisht mes vete. Prandaj u vendos që A. S., G. A., R. A., E. G., A. D. dhe P. F. të udhëtonin në Mbretërinë e Bahrejnit për të kryer

plaçkitjen, ndërsa H. G. do rrinte në Kosovë duke i siguruar mbështetje grupit. Në të vërtetë pas kryerjes së krimit H. G. ishte shumë i zënë duke i siguruar ndihmë grupit në mënyrë që të fsheh të paktën një nga orët e grabitura. E. G. ra dakord që të shkonte në mbretërinë e Bahrejnit pas kryerjes së krimit për të qenë në kontroll të orëve, sepse kryesit e veprës duhej që të i linin ato atje në mënyrë që të mos tërhiqnin vëmendjen e doganës, kufirit dhe autoriteteve të aeroportit në Mbretërinë e Bahrejnit. I. E. kishte për detyrë që të takoj E. G. në qytetin e Bahrejnit për dorëzimin e orëve dhe t'i largonte ato në një vend që pritet të zbulohet.

Pika 3 e akuzës - A. S., G. A., E. G. dhe R. A.

Grabitja, në kundërshtim me nenin 329, par. 1, 2, 3 dhe 4 të KPRK-së e dënueshme me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Sepse

- (1) Pasi që u pajtuan për të krijuar grupin e organizuar kriminal, të pandehurit vendosen që të ndajnë detyrat siç kishin rënë dakord ata më përpara. Gjersa H. G. qëndroi në Kosovë për të mbështetur grupin, A. S., G. A., E. G., R. A., P. F. dhe A. D. fluturuan për Mbretërinë e Bahrejnit ku ata qëndruan në tri hotele të ndryshme në zonën e kryeqytetit, qytetin e Bahrejnit dhe shumë afër Qendrës Tregtare të Qytetit, në M.
- (2) Me datë 10 shtator 2013, pothuajse në orën 23:00, A. S., G. A., E. G., R.A., P.F. dhe A. D., të maskuara me veshje femrash islamike, me fytyra dhe trupa të mbuluar, iu afruan Butikut të “Rolex-it” në Qendrën Tregtare të Qytetit, M., në qytetin Bahrejn.
- (3) Kur u gjenden në afërsi të Butikut, të pandehurit sulmuan Z. M. Z., rojën e paarmatosur të sigurimit i cili ishte në detyrë, duke ruajtur Qendrën Tregtare. Ata e sulmuan atë duke i hedhur atij në sy spërkatje të piperit, të paktën tri ose katër herë, në mënyrë që të pamundësonin atë të ndërmernte ndonjë veprim. Roja e sigurimit pësoj një përcëllim të rëndë të syve dhe nuk pati mundësi që të mbronte veten e vet gjersa një i pandehur tjetër e goditi atë me shkop druri prapa kokës duke e bërë që të rrëzohet përtokë, duke ia pamundësuar atij që të rezistonte.
- (4) Pas këtij veprimi, të pandehurit thyen vitinën dhe derën prej xhamit të Butikut të “Rolex-it” i cili në atë kohë ishte i mbyllur. Ata hynë në Butik dhe thyen disa nga raftet e vitrinës ku ishin vendosur orët e vlefshme të dorës.
- (5) Brenda një kohe prej vetëm dy minutave të pandehurit grabiten shtatëdhjetë (70) orë dore “Rolex” dhe nëntë (9) orë dore “Theodore” që

- ishin vendosur brenda në raftet e vitrinës së Butikut dhe u larguan nga vendi duke marr me vete shtatëdhjetë e nëntë (79) orë dore.
- (6) Orët e vjedhura të dorës kanë vlerë prej pesëqind e tetëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e tridhjetë (583 930) Dinar të Bahrejnit, e që është barazi me një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatë qind e gjashtëdhjetë e shtatë Euro dhe tetë Cent (1,162 767.08).
 - (7) Shkatërrimi i Butikut të “Rolex-it” shkaktoi një dëm material prej pesëdhjetë mijë Dinarësh të Bahrejnit e që është e barabartë me nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tri Euro dhe nëntëdhjetë e një cent (99,563.91).
 - (8) Pronarët e Butikut u detyruan që të mbyllnin këtë Butik për disa ditë për shkak të nevojës së rikonstruktimit të dyqanit dhe rafteve të vitrinës që u shkatërruan. Ata nuk patën mundësi që të ushtronin asnjë biznes gjatë kësaj periudhe kohore, çka shkaktoi humbje të tjera materiale.
 - (9) Të pandehurit së shpejti pas grabitjes u larguan nga Qendra Tregtare e Qytetit, në posedim të 79 orëve, me një automjet që ata më parë e kishin marr me qira, por me targa regjistrimi të vjedhura të një automjeti tjetër.
 - (10) Ata fshehën 63 orë në një apartament të marr me qira në zonën e M. dhe u kthyen në hotele ku ishin vendosur duke sjell me vete orët tjera të mbetura.
 - (11) Ditën tjetër, ata u larguan nga Mbretëria e Bahrejnit me aeroplan, u kthyen në Ballkan, duke sjell me vete orët tjera të mbetura.
 - (12) Të 63 orët e lëna u morën përsëri disa ditë më pas nga pjesëtari tjetër i grupit, E. G., i cili sipas planit të miratuar bashkërisht nga pjesëtarët e grupit dhe në bazë të udhëzimeve të A. S., fluturoi në një datë tjetër nga Kosova për në Bahrejn. Kjo ishte për të marr orët nga apartamenti ku orët ishin fshehur. Pastaj E. G., shkoi në hotel në qytetin e Bahrejnit, ku ai takoi pjesëtarin tjetër të grupit, shtetasin Turk I. E., i cili ishte aty duke e pritur atë dhe ia dorëzoi atij të 63 orët.
 - (13) Në kohën kur E. G. po ia dorëzonte 63 orët I. E., ata, që të dy, u arrestuan nga Policia e Bahrejnit dhe u paraburgosen. Ata tani po gjykohen për krimet e lartcekura.
 - (14) Të 63 orët u gjeten përsëri dhe iu kthyen Butikut “Rolex”, por ato janë të prishura.
 - (15) 16 orët tjera akoma nuk janë gjetur.
 - (16) Me t’u kthyer në Kosovë, H. G., i cili ishte anëtar i grupit të organizuar kriminal, por që nuk kishte shkuar në Bahrejn, ishte udhëzuar që të ndihmonte të pandehurit e sipër përmendur për të fshehur dhe mbajtur të fshehtë të paktën një orë të vjedhur. H. G. kishte njohuri të plotë për

grabitjen dhe vjedhjen e orëve në Bahrejn. Veç kësaj, prokurori thotë se pasi që të gjithë ishin në dijeni për përpjekjet e autoriteteve për të kapur të dyshimtët dhe për të gjetur orët, grupi punoi bashkërisht që të ruaj të ardhurat nga krimi dhe u munduan që të fshihnin veten e vetë nga krimi.

Pika 4 e akuzës – H. G.

Mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armë në kundërshtim me nenin 374, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, Ligji nr. 03/L-246, neni 1.20, dhe e dënueshme me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite.

Sepse

1. Nga një datë që pritet të përcaktohet e deri me datën 8 tetor 2013, në Prishtinë, Kosovë, në shtëpinë ku po jetonte H. G., (rruga 'I. K.', numër 377), i pandehuri mbante në posedim dhe kontroll të tij dyqind e shtatëdhjetë e shtatë (277) fishek të kalibrit 7.62 mm; katërqind e njëzet e pesë (425) fishek të kalibrit 9 mm; treqind e tridhjetë e tre (333) fishek të kalibrit 7.65 mm; pesëdhjetë (50) fishek të kalibrit 9 mm dhe nëntëmbëdhjetë (19) fishek të kalibrit 12 mm (në total njëmijë e njëqind e katër municion– 1104).
2. I pandehuri nuk kishte leje legale apo autorizim për mbajtjen e këtij municioni në posedimin dhe kontrollin e tij.

PAS MBAJTJES së seancave të shqyrtimit gjyqësore në gjykim të hapur me datë 19 dhe 24 nëntor 2014; 10, 11 dhe 16 dhjetor 2014; 14, 27, 28 dhe 29 janar 2015; 3 dhe 11 shkurt 2015, 18 maj 2015, 16 dhe 17 qershor; 22 korrik 2015; 5, 6 dhe 7 gusht 2015, në prani të të akuzuarve G. A., R. A., E. G., A. S. dhe H. G., dhe avokatëve të tyre mbrojtës B. T¹ dhe A. H. (për A. S.), R. K.² dhe Z. J. (për G. A.), S. J.³ (për E. G.), N. P.⁴ (për R. A.) dhe Z.P.⁵ (për H. G.) në prani të Prokurorit Special të EULEX-it Romulo Mateus të PSRK-së;

PAS marrjes së vendimit dhe votimit mbajtur me datë 6 gusht 2015, nxjerr në vijim këtë;

¹ Zëvendësuar nga avokatja M. G. me datë 3 shkurt 2015; autorizimi i avokatit i është paraqitur gjykatës.

² Zëvendësuar nga avokati A.B. me datë 27 janar 2015; autorizimi i avokatit i është paraqitur gjykatës.

³ Zëvendësuar nga avokati D. G. me datë 29 janar 2015; autorizimi i avokatit i është paraqitur gjykatës.

⁴ Zëvendësuar nga avokati R. K. me datë 15, 16 dhjetor 2014 dhe 28 janar 2015, dhe avokati F. G. me datë 7 gusht 2015; autorizimi i avokatit i është paraqitur gjykatës.

⁵ Zëvendësohet nga avokatja Z. Gj. me datë 5, 6 dhe 7 gusht 2015; e caktuar sipas detyrës zyrtare

AKTGJYKIM

I.

A. (i njohur edhe si D.) S. (i njohur edhe si Dj.), emri i babës xxx., emri i nënës xxx., e lindur xxx., i lindur me datë xxxx, në xxxx, i gjinisë mashkull, me banim në rrugën ‘xxxx’, me kombësi shqiptar, shtetas i Kosovës dhe Maqedonisë, i martuar, me numër letërnjoftimi xxxxx,

Në bazë të nenit 364, 1.3 të KPPRK-së,

Lirohet nga pika 1 e akuzës në Aktakuzë – Pjesëmarrje ose organizim të një grupi të organizuar kriminal për të kryer një apo më shumë vepra penale, në kundërshtim me nenin 283, par. 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPRK), e dënueshme me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim të paktën dhjetë (10) vite.

Sepse nuk është argumentuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilin ai është ngarkuar.

II.

Në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, i pandehuri A. S. me të dhëna personale si më sipër,

Është fajtor

Sepse

Të paktën që nga marsi i vitit 2013 e deri në tetor të vitit 2013, i pandehuri A. S. së bashku me G. A., E. G., dhe R. A. plus A. D., P. F., E. G., I. E. dhe kryes tjerë të paidentifikuar, në territorin e Kosovës, në Prishtinë, pranuan të formojnë një grup të personave, nën drejtimin e një personi të paidentifikuar, me qëllim që të kryejnë një grabitje në një butik luksoz të orëve të ‘Rolex-it’ në qendrën tregtare të qytetit në M., kryeqyteti i Bahrejnit, Mbretëria e Bahrejnit, duke marr pjesë aktive në veprimtarit kriminale të grupit, duke e ditur që një pjesëmarrje e tillë do të kontribuonte në arritjet e veprimtarive kriminale të grupit- në mënyrë që të siguroj,

ne mënyrë të drejt për drejt apo tërthorazi përfitime financiare si dhe përfitime të tjera materiale. Pasi që kanë rënë dakord që të krijojnë grupin e organizuar kriminal, i pandehuri A. S. së bashku me G. A., E. G., R. A., P. F. dhe A. D. udhëtuan për në Mbretërinë e Bahrejnit ku ata qëndruan në tri hotele të ndryshme shumë afër Qendrës Tregtare të Qytetit, në M. Me datë 10 shtator 2013, gati në orën 23:00, A. S., G. A., E. G., R. A., P. F. dhe A. D, të maskuar me veshje femrash islamike, me trup dhe fytyra të mbuluara, shkuan tek butiku i orëve të 'Rolex-it' në Qendrën Tregtare të Qytetit, në M, qytet në Bahrejn dhe sulmuan rojën e sigurimit, M. Z., ku një anëtar i grupit e spërkati syve me spërkatje piperi, si dhe njëri nga grupi e goditi atë nga prapa me shufër druri. Pasi që e neutralizuan rojën e sigurimit, grupi i cili përfshinte këta të pandehur theu vitrinën dhe derën e xhamit të butikut 'Rolex' e cila në atë kohë ishte e mbyllur dhe kështu hyn në butik dhe thyen disa nga raftet e vitrinës ku po mbaheshin orët e çmuara të dorës dhe menjëherë pas kësaj i pandehuri A. S. së bashku me anëtarët tjerë të grupit grabiti shtatëdhjetë (70) orë dore 'Rolex' dhe nëntë (9) orë dore 'Theodore' të cilat ishin të vendosura brenda rafteve të vitrinës së butikut dhe u larguan nga vendi duke marr me vete shtatëdhjetë e nëntë (79) orë dore në vlerë të pesëqind e tetëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e tridhjetë (583 930) Dinar të Bahrejnit, që janë baras me një milion, njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë, e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro e tetë cent (1,162 767.08).

Pak pas grabitjes, i pandehuri A. S. së bashku me anëtarët e sipër përmendur të grupit u larguan nga Qendra Tregtare e Qytetit në posedim të 79 orëve, me një automjet Toyota paraparakisht të marr me qira nga njeri prej anëtarëve të grupit, dhe rrugës për në hotelet e tyre ata ndërrojnë automjetin me - një Mitsubishi Gallant, paraparakisht të marr me qira nga R. A., dhe fshehën 63 orë në një apartament, të marr me qira nga njëri prej anëtarëve të grupit, në zonën e M. dhe kthehen në hotelet ku ata po qëndronin, ndërsa ditën e nesërme ata largohen nga Mbretëria e Bahrejnit me fluturime të ndryshme për në shtete të ndryshme të rajonit të Ballkanit.

Të 63 orët që u lan në apartament, o morën disa ditë më vonë nga E. G., i cili pas udhëzimeve të dy individëve nga Shqipëria fluturoi në një datë më vonë nga Kosova për në Bahrejn në mënyrë që të merrte orët nga apartamenti në të cilin ishin fshehur orët. Pastaj E. G., shkon në hotel në qytetin e Bahrejnit, ku ai takon I.

E. në mënyrë që të ia dorëzonte orët I. E. Të dy edhe E. G. dhe I. E. u arrestuan dhe u dënuan nga autoritetet e Bahrejnit, ndërsa 63 orët u gjeten dhe iu kthyen butikut të 'Rolex-it'.

NË KËTË MËNYRË, i pandehuri A.S. ka kryer veprën penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim me nenin 283, par 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me nenin 329, par 3 të KPRK-së.

DUKE QENË SE fajësohet për veprën penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim me nenin 283, par 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me nenin 329, par 3 të KPRK-së, i pandehuri A. S., dënohet me dënim prej **12 (dymbëdhjetë) vjet burgim dhe gjobës në shumë prej 12, 500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro**, që do të paguhet brenda 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

III.

Në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurit;

G.A., me nofkën 'G.', emri i babës xxx., emri i nënës xxxx. e lindur S., lindur me datë xxxx, në xxxx, Kosovë, i gjinisë mashkull, me banim në rrugën 'xxxxx, , me kombësi shqiptar, shtetas i Kosovës, i martuar, xxxxx, me profesion marangoz, ka të kryer shkollën e mesme, me numër të letërnjoftimit xxxxx;

R. (i njohur edhe si R.) A. pseudonimi Z, me nofkën 'R.', emri i babës xxx., emri i nënës xxx. , i lindur me datë xxxxx, në xxxxx, i gjinisë mashkull, me banim në xxxxxxxx, me kombësi shqiptar, shtetas i Kosovës, i martuar, xxxxx, me profesion është shitës i automjeteve të përdorura, ka të kryer shkollën e mesme, me numër letërnjoftimi xxxxxxx;

E.G., emri i babës Sh., emri i nënës xxxx. e lindur xxxx., lindur me xxxx, në xxxx, Kosovë, i gjinisë mashkull, me banim në rrugën 'xxxx', Prishtinë, me kombësi shqiptar, shtetas i Kosovës, i martuar, xxxxx, me profesion biznesmen, me numër letërnjoftimi xxxxx;

JANË FAJTOR

Sepse

Të paktën që nga marsi i vitit 2013 e deri në tetor të vitit 2013, i pandehuri G.A., R.A. dhe E.G., së bashku me të pandehurin A. S. plus A.D., P.F., E. G., I.E. dhe kryes tjerë të paidentifikuar, në territorin e Kosovës, në Prishtinë, pranuan të formojnë një grup të personave, nën drejtimin e një personi të paidentifikuar, me qëllim që të kryejnë një grabitje në një butik luksoz të orëve të 'Rolex-it' në Qendrën Tregtare të Qytetit në M., kryeqyteti i Bahrejnit, Mbretëria e Bahrejnit, kanë marr pjesë aktive në veprimtarit kriminale të grupit, duke e ditur që një pjesëmarrje e tillë do të kontribuonte në arritjet e veprimtarive kriminale të grupit në mënyrë që të sigurojnë, në mënyrë të drejt për drejt apo tërthorazi përfitime financiare si dhe përfitime të tjera materiale. Pasi që kanë rënë dakord që të krijojnë grupin e organizuar kriminal, i pandehuri G.A., E.G., R.A. dhe A.S. së bashku me P.F. dhe A.D. udhëtuan për në Mbretërinë e Bahrejnit ku ata qëndruan në tri hotele të ndryshme shumë afër Qendrës Tregtare të Qytetit, në M.. Me datë 10 shtator 2013, gati në orën 23:00, G.A., E.G., R.A., A.S., P.F. dhe A.D., të maskuar me veshje femrash islamike, me trup dhe fytyra të mbuluara, shkuan tek butiku i orëve të 'Rolex-it' në Qendrën Tregtare të Qytetit, në M., qytet në Bahrejn dhe sulmuan rojën e sigurimit, M.Z., ku një anëtar i grupit e spërkati syve me spërkatje piperi, si dhe njëri nga grupi e goditi atë nga prapa me shufër druri. Pasi që e neutralizuan rojën e sigurimit, grupi i cili përfshinte këta të pandehur theu vitrinën dhe derën e xhamit të butikut 'Rolex' e cila në atë kohë ishte e mbyllur dhe kështu hyn në butik dhe thyen disa nga raftet e vitrinës ku po mbaheshin orët e çmuara të dorës dhe menjëherë pas kësaj të pandehurit G.A., E.G., R.A. dhe A.S. së bashku me anëtarët tjerë të grupit grabitën shtatëdhjetë (70) orë dore 'Rolex' dhe nëntë (9) orë dore 'Theodore' të cilat ishin të vendosura brenda rafteve të vitrinës së butikut dhe u larguan nga vendi duke marr me vete shtatëdhjetë e nëntë (79) orë dore në vlerë të pesëqind e tetëdhjetë e tri mijë e nëntëqind e tridhjetë (583 930) Dinar të Bahrejnit, që janë baras me një milion, njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë, e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë Euro e tetë Cent (1,162 767.08).

Pak pas grabitjes, i pandehuri G.A., E.G., R.A. dhe A.S. së bashku me anëtarët e sipër përmendur të grupit u larguan nga Qendra Tregtare e Qytetit në posedim të 79 orëve, me një automjet Toyota paraprakisht të marr me qira nga njeri anëtar i

grupit, dhe rrugës për në hotelet e tyre ata ndërrojnë automjetin me - një Mitsubishi Gallant, paraprakisht të marr me qira nga R.A., dhe fshehën 63 orë në një apartament, të marr me qira nga njëri prej anëtarët e grupit, në zonën e M. dhe kthehen në hotelet ku ata po qëndronin, ndërsa ditën e nesërme ata largohen nga Mbretëria e Bahrejnit me fluturime të ndryshme për në shtete të ndryshme të rajonit të Ballkanit.

Të 63 orët që u lan në apartament, o morën disa ditë më vonë nga E. G., i cili pas udhëzimeve të dy individëve nga Shqipëria fluturuan në një datë më vonë nga Kosova për në Bahrejn në mënyrë që të merrnin orët nga apartamenti në të cilin ishin fshehur orët. Pastaj E. G., shkon në hotel në qytetin e Bahrejnit, ku ai takon I.E. në mënyrë që të ia dorëzonte orët I.E.. Të dy edhe E. G. dhe I.E. u arrestuan dhe u dënuan nga autoritetet e Bahrejnit, ndërsa 63 orët u gjeten dhe iu kthyen butikut të 'Rolex-it'.

NË KËTË MËNYRË, të pandehurit G.A., E.G. dhe R.A. kanë kryer veprën penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim me nenin 283, par 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me nenin 329, par 3 të KPRK-së.

DUKE QENË SE fajësohen për vepër penale të Krimin të Organizuar, në kundërshtim me nenin 283, par 1 të KPRK-së, lidhur me veprën penale të grabitjes, në kundërshtim me nenin 329, par 3 të KPRK-së, ata dënohen si në vijim:

-G.A., dënohet me **11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim dhe gjobë prej 12, 500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro**, që do të paguhet brenda 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

-E.G. dënohet me **11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim dhe gjobë prej 12, 500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro**, që do të paguhet brenda 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

-R.A., dënohet me **11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim dhe gjobë prej 12, 500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) Euro**, që do të paguhet brenda 30 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë.

IV.

Në bazë të nenit 364, 1.3 të KPPRK-së,

H.G., emri i babës xxx., emri i nënës xxx. e lindur xxx., i lindur me xxxx, në xxxx, Kosovë, i gjinisë mashkull, me banim në rrugën 'xxxxxx, me kombësi shqiptar, shtetas i Kosovës, i martuar, xxxx, me profesion biznesmen, me numër letërnjoftimi xxxx.

Lirohet nga pika e 2 e akuzës - **Pjesëmarrje në një grup të organizuar kriminal** me qellim të kryerjes së një apo më shumë veprave penale, në kundërshtim me nenin 283, par. 1, të KPPRK-së.

Sepse nuk është argumentuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën ngarkohet.

V.

Në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, i pandehuri H.G.

Është fajtor për pikën 4 të akuzës në aktakuzë

Sepse

3. Nga një datë që pritet të përcaktohet e deri me datën 8 tetor 2013, në xxxx H.G., (xxxxx), i pandehuri mbante në posedim dhe kontroll të tij dyqind e shtatëdhjetë e shtatë (277) fishek të kalibrit 7.62 mm; katërqind e njëzet e pesë (425) fishek të kalibrit 9 mm; treqind e tridhjetë e tre (333) fishek të kalibrit 7.65 mm; pesëdhjetë (50) fishek të kalibrit 9 mm dhe nëntëmbëdhjetë (19) fishek të kalibrit 12 mm (në total njëmijë e njëqind e katër municion– 1104).
4. I pandehuri nuk kishte leje legale apo autorizim për mbajtjen e këtij municioni në posedimin dhe kontrollin e tij.

Në këtë mënyrë i pandehuri H.G. ka kryer veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armë në kundërshtim me nenin 374, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, Ligji nr. 03/L-246, neni 1.20.

DUKE QENË SE fajësohet për veprën penale Mbajtje në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 374, par. 1 dhe 2 të KPRK-së, Ligji nr. 03/L-246, neni 1.20, i pandehuri H.G. dënohet me dënim prej **3 (tre) vjet burgim.**

Municioni do të konfiskohet në bazë të paragrafit 3 të nenit 374 të KPPRK-së.

NË BAZË TË nenit 83 (1) të KPRK-së koha e kaluar në paraburgim nga data 8 tetor 2013 (G.A., R.A., H.G.), 16 nëntor 2013 (A.S.), dhe 17 shtator 2013 për E.G. deri me këtë datë do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Pas dëgjimit të palëve do të nxjerrët aktvendim i veçantë mbi masat kufizuese.

Palët e dëmtuara udhëzohen që të ndjekin padi pronësore në procedure civile në bazë të nenit 463, par. 2 të KPPRK-së.

NË BAZË TË nenit 450, par. 3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës A.S., G.A., R.A. dhe E.G. do të paguajnë shumën paushallë, të vlerësuar në shumën prej 300 (treqind) Eurosh, dhe H.G. në shumë prej 200 (dyqind) eurosh.

ARSYETIM

A)

i. Kompetencat e Gjykatës dhe Përbërja e Trupit Gjykues

Gjykata Themelore e Prishtinës, e Republikës së Kosovës, është kompetente për të gjykuar këtë lëndë, në neneve 1, 2, par. 1.2, 9 par. 2.1, 15 par. 1.20 dhe 15, par. 2 të Ligjit mbi Gjykatat (L. nr. 03/L-199).

Çështja e juridiksionit diskutohet gjerësisht dhe jepet formë përfundimtare në sektorin ‘Juridiksioni i Gjykatës dhe çështje tjera paraprake’.

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Prishtinë është krijuar në mënyrë të drejt nga një panel i përzier prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtare vendore, në përputhje me nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë⁶ (e korigjuar me Ligjin Nr. 04/L-273) lidhur me përbërjen e trupi gjykues⁷.

Nuk ka pasur kundërshtime të ngritura lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

-Ligji i aplikueshëm substancial dhe procedural

Veprat penale me të cilat ngarkohen të pandehurit janë kryer në vitin 2013.

Në bazë të nenit 3, par. 1 të KPRK-së, Ligjit 04/L- 082 të vitit 2012 (i cili hyri në fuqi me datë 1 janar 2013), ligji në fuqi në kohën e kryerjes së një vepre penale do të zbatohet kundër të pandehurit. Pasi që veprat penale janë kryer në vitin 2013, trupi gjykues vendosi që ligji i zbatueshëm të jetë Ligji nr. 04/L- 082 i vitit 2012.

Në rastin në fjalë Aktakuza është ngritur me datë 22 gusht 2014, në kohën kur ishte i zbatueshëm Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), Ligji 04/L-123 i vitit 2012 në fuqi që nga data 1 janar 2013. Prandaj, trupi gjykues vendosi që ligji procedural i zbatueshëm është Ligji 04/L-123.

⁶ Ligji Nr. 03/L-053.

⁷ Shumica e gjyqtarëve të EULEX-it e kryesuar me gjyqtaren e EULEX-it.

ii. Prapavija Procedurale

Me datë 23 shtator 2013, prokurori i Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm “PSRK”) morri një raport se një numër i të dyshimtëve që besohet se janë nga rajoni i Ballkanit kishin kryer një grabitje në Bahrejn me datë 10 shtator 2013. Nisur nga marrja e kësaj informate një numër Urdhëresash për Masa të Fshehta u bënë nga gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Gjyqtari i procedurës paraprake po ashtu lëshoi urdhëresa duke pranuar në mënyrë retroaktive lejimin e bastisjeve të pronave.

Me datë 9 tetor 2013⁸, prokurori i PSRK-së nxori Aktvendimin mbi Fillimin e Hetimeve kundër A.S. (i njohur edhe si D. D.), G.A., R.A. (i njohur edhe si R.Z.), H.G., E.G., P.F. dhe A.D. për veprën penale të pjesëmarrjes në grup të organizuar kriminal, në kundërshtim me nenin 283, par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)⁹, sulm, në kundërshtim me nenin 187, par. 2 të KPRK-së, lëndime të rënda trupore, në kundërshtim me nenin 189, par 1 lidhur me nën-par. 5 të KPRK-së, vjedhje e rëndë, në kundërshtim me nenin 327, par 2 të KPRK-së, grabitje në kundërshtim me nenin 329, par 4 të KPRK-së, falsifikim dokumentesh, në kundërshtim me nenin 398, par. 2 të KPRK-së. Me datë 9 nëntor 2013 prokurori i PSRK-së nxori Aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve kundër E. G.t.

Me datë 8 tetor 2013 të pandehurit G.A., R.A. dhe H.G. arrestohen në Republikën e Kosovës dhe dërgohen në paraburgim pas mbajtjes së seancës për paraburgim me datë 10 tetor 2013 para gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe mbeten në paraburgim gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor. I pandehuri A.S. arrestohet me datë 16 nëntor 2013 në Kosovë dhe dërgohet në paraburgim pas mbajtjes së seancës për paraburgim para gjyqtarit të procedurës paraprake mbajtur në Gjykatën Themelore të Prishtinës me datë 18 nëntor 2014, i cili ngeli në paraburgim që atëherë.

Me datë 28.10.2013, prokurori i PSRK-së duke vepruar lidhur me përgjigjen ndaj komunikatës së pranuar nga Mbretëria e Bahrejnit përmes Ministrisë së Drejtësisë

⁸ Fashikull 2, lidhja 20 – S. et al PPKR.nr. 314/13 Kërkesa & Urdhëresa

⁹ Ligji nr. 04/L-082, në fuqi që nga 1 janar 2013

së Republikës së Kosovës, (ref. MD/DBGJ/23385/gc/13 dhe DLA/2013-2333385) lidhur me krimin e grabitjes së kryer në Bahrejn me datë 10 shtator 2013¹⁰, zyrtarisht pranoi juridiksionin për të hetuar dhe ndjekur penalisht veprën penale të grabitjes kështu që procedura gjyqësore penale për të hetuar dhe ndjekur penalisht këtë rast u transferua nga Mbretëria e Bahrejnit në Republikën e Kosovës në bazë të nenit 46, par. 1 të Ligjit Nr. 04/L020013 mbi Bashkëpunimin Ligjor Ndërkombëtar për Çështje Penale.

Me datë 9 dhjetor 2013 i pandehuri E.G. u ekstradua nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës dhe u dërgua në paraburgim pas seancës para gjyqtarit të procedurës paraprake mbajtur në Gjykatën Themelore të Prishtinës me datë 10 dhjetor 2013¹¹, i cili u qua në mbajtje ku edhe mbeti gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor

Me datë 26 shkurt 2014¹², gjyqtari i procedurës paraprake miratoi kërkesën e PSRK-së për të mbajtur Mundësi Hetuese e Veçantë (në tekstin e mëtejme MHV) që u mbajt me datë 1, 2, 3 7 dhe 8 korrik 2014 (me kryetaren e trupit gjykues këtu si anëtare atij paneli) dhe u dëgjuan provat nga oficerët e policisë përgjegjës për të hetuar rastin e Grabitjes në Bahrejn, një numër të palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve okular në Mbretërinë e Bahrejnit. Të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës iu dha mundësia që të marrin në pyetje nga ana tjetër dëshmitarët dhe palët e dëmtuara në pikëpamje të dëshmimeve të tyre.

Aktakuza e datës 22 gusht 2014 u parashtrua në Gjykatën Themelore të Prishtinës me datë 25 gusht 2014¹³. Me datë 27 gusht 2014, dhe pas kësaj menjëherë Kryetarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës iu dërgua një letër se rasti mbetet me përbërjen e shumicës së trupit gjykues të EULEX-it duke pasur parasysh rrethanat

¹⁰ Dosja me Fashikull të Prokurorit Vëllimi 3, lidhja 3

¹¹ E.G. arrestohet me datë 17 shtator 2014 në aeroportin e Shqipërisë në bazë Njoftimit të Kuq të Mbretërisë së Bahrejnit.

¹² Dosja 11 MPH- S. dhe të tjerët PKR 314/13.

¹³ Të njëjtën datë PSRK pezulloj hetimet kundër A.D., P.F. dhe E. G.. Gjyqtari i procedurës paraprake i GjTh të Prishtinës ka lëshuar një Njoftim të KUQ kundër A.D. dhe P.F. por ata akoma janë të lirë . veç kësaj, deri më tani autoritetet e Bahrejnint nuk janë përgjigjur pozitivisht kërkesës së NNL-së për ekstradimin e E. G.t.

urgjente të rastit. Seanca fillestare u mbajt me datë 11 shtator 2014¹⁴ me orarin për parashtrim të parashtrësve nga palët.

Me datë 20 tetor 2014, kryetarja e trupit gjykues lëshoi aktvendim duke i refuzuar si të pabazuara të gjitha kërkesat¹⁵ e të pandehurve, A.S., G.A., R.A. (i njohur edhe si R.Z.) E.G. dhe H.G., për hedhjen poshtë të aktakuzës.

Seanca e parë publike e shqyrtimit gjyqësor u mbajt me datë 19 nëntor 2014. Pas rënies dakord që aktakuza¹⁶ të konsiderohej si e lexuar, pas paralajmërimit të të gjithë të pandehurit mbi të drejtat e tyre, asnjëri nga ta nuk e pranoi fajësinë. Pas kësaj, të gjitha palëve iu dha mundësia që të paraqesin deklaratat e tyre hyrëse.

Shqyrtimi kryesor duhej të ndërpritej për më shumë se një muaj për shkak të grevës së kolegëve vendor¹⁷.

Gjatë shqyrtimit kryesor, pati shenja se palët ishin të gatshme që të hynin në negociata mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë, dhe gjykata iu dha kohën e duhur, megjithatë ata nuk arritën marrëveshje. Shqyrtimi kryesor vazhdoi në mënyrë normale dhe kjo iniciativë e palëve nuk pati çfarëdo qoftë ndikim tek trupi gjykues gjersa vlerësuan përgjegjësin penale të të pandehurve. Provat u paraqiten kryesisht nga prokurori edhe pse të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës iu dha mundësia e barabartë për të prezantuar provat e tyre.

Me datë 28 maj 2015¹⁸ përmes Njesisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar brenda EULEX-it, u kontaktuan autoritetet e Bahrejnit në mënyrë që të njoftonin palët e dëmtuara se ata kanë të drejtë për të parashtruar padi për kompensim si dhe fjalët e tyre përmbyllëse. Të njëjtën datë, gjykata u njoftua se paditë për kompensim veç sa

¹⁴ Seanca fillestare u caktua për datën 2 shtator 2014, megjithëse në atë seance u vërtetua se jo të gjithë të pandehurit kishin marr aktakuzën

¹⁵ Kërkesat janë depozituar nga avokatet e tyre mbrojtës

¹⁶ Veç kësaj, në këtë datë prokurori korrigjoi aktakuzën sepse gabimisht ishte thënë se ishte R.A. ai i cili rezervoi automjetin por se ishte P.F. ai i cili e bëri këtë gjë (faqe 20 e aktakuzës, nr 18). Me datë 6 gusht 2015 avokati mbrojtës R. P. propozoi përmirësimin e aktakuzës sepse kombësia e R.A. gabimisht ishte thënë se ishte serb në vend se shqiptar.

¹⁷ Mars 2015

¹⁸ Një e-mail iu dërgua F. B. nga njësiti i NLN si pikë kontakti me autoritetet e Bahrejnit.

nuk ishin pranuar, dhe se palët e dëmtuara nuk kishin ndërmend të dërgonin ndonjë fjalë përmbyllëse.

Përpos H.G. i cili vendosi që të deklarohet lidhur me rastin e tij dhe i kërkoi gjykatës që ta lironte, të pandehurit A.S., G.A., R.A. dhe E.G. shfrytëzuan të drejtën për të heshtur (Nenin 323 i KPPRK-së).

Prokurori paraqiti fjalën e tij përfundimtare¹⁹ me datë 5 gusht 2015, dhe i kërkoi gjykatës që t'i shpall të pandehurit fajtor sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ata kanë kryer veprat penale me të cilat akuzohen.

Avokati mbrojtës B. T. dhe A. H. (për A.S.), Zh. J. dhe R.K. (për G.A.), R. P. (për R.A.), S. J. (për E.G.), dhe Z. Gj²⁰ (për H.G.) paraqiten fjalimet e tyre përfundimtare me datë 6 gusht 2015, me ç' rast që të gjithë kërkuan nga gjykata që të liroj të mbrojturit e tyre në mungesë të provave.

iii. Kompetencat e gjykatës dhe çështje tjera paraprake.

Gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor, avokatet mbrojtës ngritën çështjen parimit *ne bis in idem* pasi që Mbretëria e Bahrejnit tashmë kishte vendosur lidhur me rastin kundër të mbrojturve të tyre²¹. Gjykata përmes Kërkesës për Ndihmë Ligjore Ndërkombëtare siguroi Aktgjykimet nga Mbretëria e Bahrejnit²².

-Gjendja e palëve sa i përket çështjes së ne bis in idem

1. Parashtrësia e prokurorit e datës 16 shkurt 2015

1.1 Prokurori në parashtrësën e tij të datës 16 shkurt 2015 përmbledh gjendjen e tij se çështja e *ne bis in idem* thjesht nuk vlen tek ndjekjet penale

¹⁹ Kjo i është bashkëngjitur procesverbalit të datës 5 gusht 2015

²⁰ Zëvendëson avokatin mbrojtës, Z.P. i cili parashtroi fjalën e tij përfundimtare me shkrim me datë 30 korrik 15, dhe e njëjta i është bashkëngjitur po ashtu procesverbalit të shqyrtimit kryesor të datës 6 gusht 15.

²¹ Duke përjashtuar H.G.

²² Shqyrtimi kryesor Dosja V- Aktgjykimi i Gjykatës së Katërt të Lartë i Mbretërisë së Bahrejnit i datës 18.09.2014 me të cilin të pandehurit A.S., R. G.A. dhe E.G. janë dënuar me burgim të përjetshëm, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Lartë të Apelit për krime të rënda i Mbretërisë së Bahrejnit, i datës 30.12.2014, ku vendoset mbi ankesat e E. G. dhe I.E.

që kanë ndodhur jashtë Kosovës dhe ndërsa parimi vlen ‘vertikalisht’ dmth brenda juridiksionit të njëjtë, nuk vlen në mënyrë ‘horizontale’ dmth. gjykimi në një shtet nuk pengon domosdo në shtetin tjetër të njëjtën çështje – subjekt i kushteve të caktuara. Më pas prokurori parashton²³ se akuzat, edhe pse të bazuara në fakte të njëjta paksa ndryshojnë me ato të ngarkuara në Bahrejn “*për shkak të kornizës së ndryshme ligjore*”. Në mbështetje të propozimit vertikal se sa të zbatimit horizontal të parimit *ne bis in idem*, prokurori citon nenin 4, protokollin 7 të Konventës Evropiane për Mbrojtje të të Drejtave Njerëzore, e cila, pohon ai, kanë interpretuar ‘në mënyrë të vazhdueshme’ zbatimin e parimit brenda një juridiksioni nacional. Ai po ashtu i referohet parimit të ‘komplementaritetit’ ku parimi njihet brenda një juridiksioni nacional. Prokurori po ashtu ngriti²⁴ çështjen e normave të të drejtave njerëzore dhe ndikimit të tyre në pranimin e ndërsjellë të aktgjykimeve, dhe –në mënyrë të nënkuptueshme – gjasat e dorëzimit.

1.2 Prokurori ngriti një theks domethënës²⁵ nga një rast padyshim të vjetër të Gjykatës Kushtetuese të Italisë e cila propozon që gjykata e tyre do të shtjelloj një aktgjykim të huaj si të një ndjekje penale të përsëritur ku “*vlerësimi shoqëror dhe ligjor-politikë i veprimeve të drejtave të njeriut në vende të ndryshme është i njëjtë apo i barasvlershëm*”, Ky vendim sigurisht se është vetëm precedent bindës dhe se në asnjë mënyrë nuk detyron gjykimin, por se shërben për të ilustruar një nga fijet qendrore të argumentit se prokurori fton trupin gjykues që të pranoj. Prokurori po ashtu sugjeron se komentari në këtë rast sugjeron se *ne bis in idem* nuk njihet si rregull i ligjit ndërkombëtar.

1.3 Prokurori thekson gjithashtu atë që ai e konsideron si kulmin e moslogjikës së argumenteve të të pandehurve lidhur me këtë pikë, që do të thotë se pasi që janë gjykuar në Bahrejn ata nuk mund të gjykohen në Kosovë, por në mënyrë të njëjtë ata nuk mund të kthehen në Bahrejn dhe kështu ata përjashtojnë kompetencat e të dy juridiksioneve, në mënyrë që të mos përballen as me gjykim e as me sanksion. Ai parashton se të pandehurve duhet të iu mundësohet (po qe se ekziston juridiksioni për ta bërë këtë gjë)

²³ Në faqen 3 të shkresës së tij; paragrafi 3, Shqyrtimi kryesor Dosja V ‘Kërkesat’, lidhja 13

²⁴ Në faqen 4 të shkresës së tij, paragrafi 10.

²⁵ Në faqen 6 të shkresës së tij, paragrafi 16 dhe 17

sipas zgjedhjes së tyre – gjykimi në Kosovë apo të dorëzohen në Bahrejn për të vuajtur dënimet e caktuara atje.

1.4 Prokurori thekson gjithashtu se Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nuk lejon dënimet në mungesë dhe as burgimin e përjetshëm për veprat përkatëse në Kosovë²⁶.

1.5 Së fundi prokurori pohon se edhe në instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare, pikërisht Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 14 (7) dhe Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale, neni 20, të cilat të dyja e pranojnë parimin *ne bis in idem* brenda një juridiksioni të caktuar kombëtar ose brenda juridiksionit të vet, e njëjta zbatohet në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë (GjNPJ), neni 10 i Statutit të GjNPJ-së.

2. Parashtrësa e avokatit mbrojtës B. T. në emër të A.St, datë 16 shkurt 2015

2.1 Z. T. parashtron se zbatimi i parimit *ne bis in idem* duhet të shërbejë për të pushuar procedurën në këtë rast. Ai citon Kushtetutën e Kosovës dhe i referohet –në paragrafin 8 të parashtrësës së tij – “konventave ndërkombëtare, të hartuara në Strasburg (sic) më 15.03.1972, në kapitullin 5, neni 35.1 i cili shkruan:- “*personi ndaj të cilit është nxjerrë aktgjykim i formës së prerë dhe ekzekutiv nuk mund të ndiqet penalisht (sic), të dënohet apo të zbatohet ekzekutimi i sanksionit penal ndaj tij në një vend tjetër*”²⁷.

2.2 Z. T. parashtron se pasi kjo konventë është pranuar nga Ish Republika Federative e Jugosllavisë dhe e pranuar në kohën e UNMIK-ut, atëherë kjo konventë duhet të pranohet këtu nga ky trup gjykues.

2.3 Ai pohon gjithashtu se parimet universale të drejtësisë nuk mund të relativizohen, se ato janë të detyrueshme për të gjitha palët dhe ato duhet të zbatohen në mënyrë të përpiktë.

²⁶ Raporti mbi të Drejtat e Njeriut i vitit 2015 vë në dukje se dënimet e Mbretërisë së Bahrejnit mes tjerash janë në mos përputhje dhe prandaj mund të ngritin shqetësimin e njohjes reciproke të aktgjyqimeve mes Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Bahrejnit.

²⁷ Kjo konventë duket të jetë Konventa Evropiane për Transferimin e Procedurës në Çështjet Penale e bërë në Strasburg, më 15.V.1972

3 Parashtrësia e avokatit mbrojtës Z. J. në emër të G.A. e datës 11 shkurt 2015 dhe përgjigja e parashtruar për të nga prokurori më 26 shkurt 2015.

3.1 Në parashtrësën e tij Z. J. bën një prezantim pothuaj identik me Z. T., duke kërkuar gjithashtu përkrahjen për propozimin se gjykimi duhet të ndërpritet duke iu referuar Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 35 të Konventës Evropiane për Transferimin e Procedurës në Çështjet Penale ("Konventa"). Ai, parashtron gjithashtu, se ky ligj shtrihet deri në të tashmen me anë të ligjit dhe duhet të pranohet nga trupi gjykes.

3.2 Në përgjigje të parashtrësës së Z. J., PSRK-ja ka parashtruar një përgjigje parashtrësë më 26 shkurt 2015. Kjo parashtrësë është drejtuar vetëm si përgjigje ndaj parashtrësës së Z. J., por në fakt ajo i drejtohet parashtrësave të bëra nga të dy, ai dhe Z. T.

3.3 Prokurori parashtron se konventa është vetëm ligj dytësor ndërkombëtar, se ajo nuk e detyron Kosovën dhe, madje edhe në qoftë se e ka detyruar, dhe për ndryshe, ajo nuk e detyron, ajo kurrë nuk ka mundur të detyrojë Bahrejin. Ai thekson gjithashtu se neni 35 nuk është cituar plotësisht në asnjë nga parashtrësat.

4. Parashtrësia e avokates mbrojtëse S.J. në emër të E.G., e datës 25 shkurt 2015.

4.1 Në parashtrësën e saj, Znj J. i referohet kushteve të Kushtetutës së Kosovës dhe "Konventës Evropiane" (përsëri pa citimin e duhur për të njëjtën) dhe parashtron se kjo Konventë është miratuar në kodin ligjor të Kosovës. Ajo parashtron se Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar është relevant dhe rregullon mënyrën e marrëdhënieve ndërmjet qeverive.

4.2 Megjithatë ajo thekson gjithashtu se dënimet e shqiptuara në Bahrejn janë dukshëm më të mëdha se ato që mund të shqiptohen në Kosovë, pra, ajo gjithashtu vë në dukje se klienti i saj nuk ka qenë i pranishëm në gjykimin në Bahrejn pra nuk i është dhënë mundësia për të paraqitur dëshminë e tij apo, për këtë çështje, të kundërshtonte aktgjykimin në këtë mungesë.

5. Parashtrësja e avokatit mbrojtës N.P. në emër të R.A., e datës 25 shkurt 2015.

5.1 Kjo parashtrësë është pa dyshim e njëjtë me atë të Znj. J, përveç se aty përmendet një i pandehur tjetër dhe avokat tjetër.

Vendimi i trupit gjykues.

A. Hyrje

1. Për të përcaktuar nëse parimi *ne bis in idem* zbatohet në aktgjykimin e instancës së parë të Bahrejnit, trupi gjykues ka marrë në konsideratë kushtet e Kodit²⁸ të Procedurës Penale të Kosovës dhe Kodit²⁹ Penal të Kosovës, Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale³⁰, Kushtetutës së Kosovës³¹, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Evropiane për Transferimin e Procedurës në Çështjet Penale, Konventës Evropiane për Liritë Themelore të Njeriut dhe funksionimin i Ligjit Penal në Bahrejn. Trupi gjykues ka marrë në konsideratë gjithashtu jurisprudencën përkatëse duke përfshirë rastin OLIVIERA datë 30 korrik 1988, rastin e Goktanit kundër Francës, dëgjuar më 02 korrik 2002, në rastin e A.P. kundër Italisë KDR OKB-së CCPR/C/31/D/204/1986, dhe komentarin për *ne bis in idem* në parim nga revistat e së drejtës ndërkombëtare. Në këtë aspekt, trupi gjykues ka marrë në konsideratë gjithashtu jurisprudencën³² e Kosovës.
2. Si përmbledhje, prokurori pohon se parimi *ne bis in idem* është ai që zbatohet në kuadër të gjykatave të një vendi të caktuar, “vertikalisht” në formulimin e tyre, por se parimi nuk zbatohet “horizontalisht”, domethënë mes gjykatave të një vendi dhe një tjetri. Ai pohon se nuk ka asnjë rregull ndërkombëtar zakonor që të sugjerojë se *ne bis in idem* është një parim i përcaktuar në këtë fushë. Pra, ai e fton trupin gjykues të pranojë propozimin se *ne bis in idem* është së pari një çështje e brendshme dhe për këtë është e pazbatueshme në këtë rast.

²⁸ Ligji nr. 04/L-123, në fuqi që nga 1 janari 2013

²⁹ Ligji nr. 04/L-082, në fuqi që nga 1 janari 2013

³⁰ Ligji Nr. 04/L-031

³¹ Kapitulli dy; nenet 21 - 34

³² Aktvendim i GJTH Gjilan PPr.Kr. 92/13, datë 05.01.2015

3. Të pandehurit, nga ana e tyre, e përmbledhin qëndrimin e tyre duke sugjeruar se Kushtetuta e Kosovës – përfshirë Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike- dhe (mbase) Konventën Evropiane mbi Transferimin e Procedurave, nuk e lejojnë gjykimin kur aktgjykim i formës së prerë është lëshuar në një vend tjetër.

B. Juridiksioni i Gjykatave të Kosovës

4. Trupi gjykues së pari duhet të vërtetojë situatën faktike në këtë rast, dhe vini re se me datë 28 tetor 2013, në një aktvendim të lëshuar nga prokurori, në përgjigje të komunikimit të marrë nga Mbretëria e Bahrejnit përmes Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës, (ref. MD/DBGJ/23385/gc/13 dhe DLA/2013-2333385) në lidhje me krimin e grabitjes së kryer në Bahrejn më 10 shtator 2013³³, zyrtarisht e ka pranuar juridiksionin për të hetuar dhe ndjekur veprën penale të grabitjes. Kështu, trupi gjykues ka pikëpamjen se, që nga ajo datë, si data më e fundit, Gjykata Themelore e Prishtinës ka qenë e veshur me juridiksion për të trajtuar këtë rast. Trupi gjykues dëshiron të theksojë se nuk ka prova para vetes se Bahrejni ka kërkuar, në çfarëdo faze të procedurës, të ekstradojë të pandehurit në Bahrejn për t'u përballur atje me gjykimin, apo të pohojë se ka pasur përparësinë që të trajtojë këtë rast.
5. Dihet gjithashtu se më 8 tetor 2013, G.A. dhe R.A. janë arrestuar dhe tashmë i janë nënshtruar masave të paraburgimit në Kosovë. Më 9 tetor 2013, prokurori i PSRK-së ka nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimit ndaj A.S.t, G.A.t, H.G.t, E.G., P.F.t dhe A.D.t dhe me datë 9 nëntor hetimet kanë përfshirë edhe E. G.n me anë të një vendimi për zgjerim të hetimeve. Më 16 nëntor A.S. u arrestua në Kosovë dhe në muajin tjetër me datë 9 dhjetor E.G. u ekstradua nga Republika e Shqipërisë në Republikën e Kosovës dhe vihet në paraburgim më aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake. Të gjithë të pandehurit³⁴ janë shtetas të Republikës së Kosovës dhe kanë banim të përhershëm në Prishtinë.

³³ Fashikulli i Prokurorit dosjet Vëllimi 3, ndarja 3

³⁴ Përveç kësaj A. S. ka edhe shtetësi maqedonase

6. Kompetenca e juridiksionit për të dëgjuar këtë rast rrjedh gjithashtu nga nenet 29, 32 të KPPRK-së dhe nenet 10, 114, 115 dhe 117 të KPRK-së. Neni 10 i KPRK-së përcakton: *‘Vepra penale kryhet në vendin ku kryesi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë ashtu si dhe në vendin ku është shkaktuar pasoja’*. Trupi gjykues është i mendimit se të paktën kryerja e veprës penale të krimit të organizuar pjesërisht është kryer në territorin e Kosovës, sepse grupi i organizuar kriminal është formuar në territorin e Republikës së Kosovës. Për më tepër, diskutimet mbi atë se si të ndahen detyrat, planifikimi, si dhe rezervimi i fluturimeve, për të pandehurit, aranzhimet e hoteleve si dhe e udhëtimeve janë bërë në Republikën e Kosovës për të vazhduar në Mbretërinë e Bahreinit. Si rregull kryesor juridiksioni territorial, sipas nenit 29 (1) të KPPRK-së, i vishet gjykatës themelore brenda territorit të secilës, është kryer *çfarëdo veprimi* i veprës penale. Anëtarët e grupit kriminal ashtu si përmendet më sipër, kanë bërë planifikimin, rezervimin dhe sigurimin e vizave brenda territorit të Republikës së Kosovës. Si kriter i dytë për juridiksionin në këtë rast zbatohet neni 32 (1) i cili përcakton se *‘Në qoftë se vendi i kryerjes së veprës penale nuk është në territorin e Kosovës, kompetente është gjykata në territorin e së cilës i pandehuri e ka vendbanimin ose vendqëndrimin e përhershëm’*. Në këtë rast, të gjithë të pandehurit kanë pasur vendbanim të përhershëm dhe/ose aktual në Kosovë. Ata janë arrestuar të gjithë, me përjashtim të E.G. brenda territorit të Kosovës, këto rrethana bëjnë që për të gjithë, me përjashtim të E.G., është i zbatueshëm neni 32 (3) i cili i jep juridiksion gjykatës në Kosovë. Megjithëqë E.G. është shtetas i Kosovës me banim të përhershëm në Prishtinë.
7. Gjithashtu ia vlen të theksohet se neni 33 i KPPRK-së përcakton se nëse një person kryen vepra penale si në Kosovë ashtu dhe jashtë Kosovës, gjykata e cila ka juridiksionin për veprën e kryer në Kosovë ka juridiksionin për veprën penale të kryer jashtë Kosovës. Ky përcaktim e bën të qartë se gjykata e Prishtinës, Kosovës, ka juridiksionin për veprën penale të krimit të organizuar dhe grabitjes.
8. Gjykata vë në dukje po ashtu se juridiksioni i Gjykatave në Kosovë bazohet gjithashtu në nenet 114, 115 dhe 117 të KPRK-së. Zbatimi i ligjit penal të Kosovës duhet të zbatohet kur së paku kryerja e krimit ka ndodhur pjesërisht në territorin e Kosovës, ashtu siç e kemi rastin këtu, neni 114, paragrafi 1 i KPRK-së. Nëse vepra penale është kryer jashtë territorit të Kosovës dhe i pandehuri është shtetas i Kosovës dhe vepra aktuale është gjithashtu e ndëshkueshme në shtetin tjetër, në këtë rast në Mbretërinë e Bahreinit, si në

këtë rast, neni 115 (3). Kjo vlen për të gjithë të pandehurit. Trupi gjykues në veçanti vëren kushtet e nenit 117, paragrafi 2, i cili përcakton bazën e ngushtë kur NUK mund të fillojë procedura penale. Në rrethanat kur asnjë nga kushtet e paragrafëve 2.1, 2.2 dhe 2.3 të nenit 117 të KPRK-së nuk janë përmbushur – ashtu si nuk janë përmbushur në këtë rast – atëherë, kuptohet se procedura penale mund të fillojë në Kosovë. Trupi gjykues vëren gjithashtu se nuk ka asnjë material në dosjen e rastit që tregon se Bahrejni ka kërkuar ndonjëherë ekstradimin e të katër të pandehurve për t'u përballur me drejtësinë. Kjo sipas mendimit të trupit gjykues, është një faktor shumë i rëndësishëm për të përcaktuar nëse gjykimi në Kosovë duhet të vazhdojë ose jo.

9. Trupi gjykues ka mendimin se kur një shtet duke pranuar juridiksion për një veprë penale nuk duhet të pengohet në ndjekjen penale të një veprë në aspekt më të gjerë nga të njëjtit kryes veprë brenda territorit të tij sidomos kur veprimet e të pandehurve janë të njëjta. Pra, është e pakontestueshme se prokurori ka juridiksion që penalisht të ndjekë këtë rast dhe nga kjo rrjedh se nëse prokurori i PSRK-së ka juridiksion të ndjekë këtë rast atëherë Gjykatat në Kosovë kanë kompetencë për ta dëgjuar rastin. Trupi gjykues vëren gjithashtu se mungesa e një marrëveshje për ekstradim mes Kosovës dhe Bahrejnit është një faktor që është marrë në konsideratë në lidhje me zbatimin e aktgjyqimit që është nxjerrë në *mungesë* nga Mbretëria e Bahrejnit dhe kjo çështje trajtohet më tej më poshtë.
10. Më tej, është e qartë se Gjykatat në Kosovë nuk e lejojnë gjykimin në mungesë. Ky është një fakt që rrjedh nga detyrimet që ka Kryetari i Trupit Gjykues për të njoftuar të akuzuarit për të drejtat e tyre me rastin e fillimit të shqyrtimit gjyqësor, neni 323 të KPPRK-së i cili përcakton procedurën kur i akuzuari nuk merr pjesë në shqyrtimin gjyqësor pasi është ftuar (neni 307 i KPPRK-së). Të dy këto fakte nënkuptojnë se gjykimi që është mbajtur në Bahrejn nuk mund të ishte mbajtur në Kosovë nën rrethana të njëjta. Vetëm kjo nënkupton se gjykata duhet të shikojë nenin 72 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështje Penale.
11. I ndodh trupit gjykues që zbatimi i aktgjyqimit të huaj të mos lejohet nëse zbatimi do të ishte në kundërshtim më parimet themelore të sistemit ligjor të Kosovës sipas nenit 72, paragrafi 1, (1.1) të këtij ligji. Trupit gjykues është i mendimit se e drejta për të qenë i pranishëm, për t'u përballur me akuzuesit dhe për të u marrë personalisht me dëshmitë ËSHTË një nga të drejtat

themelore që duhet të përmbushet për të pandehurit në sistemin³⁵ ligjor të Kosovës. Kjo do të ishte zgjidhja e çështjes, por trupi gjykues vëren gjithashtu se nën paragrafi (1.6) i të njëjtit nen përcakton se aktgjykimi nuk do të pranohet nëse është nxjerrë në mungesë DHE PËRVEÇSE kur shteti që ka bërë kërkesën ofron prova në mbështetje të njoftimit të duhur të të pandehurve për procedurën. Si përmbledhje, aktgjykimi duhet të jetë në mungesë – duket që këtu nuk ka problem me këtë gjë – dhe, së dyti, shteti tjetër, në këtë rast Bahrejni, duhet të ketë kërkuar dorëzimin e të pandehurve për të vuajtur dënimin e tyre DHE ofrimin e provave për shërbimin e njoftimit për procedurën penale.

12. Kështu, në mungesë të ndonjë kërkesë të bërë nga Bahrejni për kthimin e të pandehurve- vërtet në rrethanat kur kemi një rast të kundërt dhe kur Kosova është pyetur dhe ka rënë dakord për të ndjekur të pandehurit, pa asnjë mëdyshje Gjykatat në Kosovës kanë juridiksionin të gjykojnë këtë çështje.

C. Aktgjykimet e Bahrejnit dhe rëndësia e tyre

1. Pasi që të përcaktohet se gjykatat e Kosovës kanë juridiksion për gjykimin e çështjes, duhet të merret parasysh rëndësia e aktgjykimeve të lëshuara në Mbretërinë e Bahrejnit, këto janë aktgjykime të shkallës së parë të Bahrejnit, të datës 18 shtator 2012 që dënojnë të pandehurit A.S., R.A., G.A. dhe E.G. secilin me burgim të përjetshëm, dhe aktgjykimi i Gjykatës se Apelit të datës 30 dhjetor 2014 e cila dënoi E. G. dhe I. E. secilin me nga pesëmbëdhjetë vjet burgim.
2. Në interpretimin e këtyre aktgjykimeve dhe në përputhje me detyrimin e Gjykatës për të mbrojtur të drejtat e të akuzuarit në çdo kohë dhe për të interpretuar kodet në mënyrë të harmonizuar, trupi gjykues ka vendosur ta

³⁵ Neni 14 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, një traktat që e detyron Republikën e Kosovës, rregullon të drejtat e të akuzuarit ose të të pandehurit. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për të qenë i pranishëm gjatë gjyimit, të drejtën për të mbrojtur vetveten dhe të drejtën për të marrë në pyetje dëshmitarët, të cilat nuk mund të realizohen nëse gjykimi mbahet në mungesë. Po ashtu, Gjykata Ndërkombëtare Penale në nenin e saj 63 i ndalon gjykimet në mungesë, ashtu si është rasti edhe me gjykatat ad hoc, si .GJNPJ-ja, e cila ndalon gjykimet në mungesë. Neni 6 (3) i Konventës Evropiane për të Drejtat e njeriut dhe Liritë Themelore përcakton se cilido që akuzohet për një vepër penale ka të drejtën të mbrojë veten personalisht ose përmes ndihmës ligjore sipas zgjedhjes së tij. Në rastin C. kundër Italisë deklarohet se objekti dhe qëllimi i nenit 6 është që i pandehuri të ketë të drejtën të marrë pjesë në gjykim. Heqja dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim duhet të jetë e qartë dhe pa mëdyshje, KEDNJ, P. kundër Francës, 1193 18, E.H.R.R. 130, paragrafi 31.

trajtojë aktgjykimin e shkallës së parë të Bahrejnit sikur të ishte një aktgjykim i formës së prerë. Kjo lind nga rrethanat ku nuk është e qartë nëse aktgjykimi i shkallës së parë aktualisht është definitiv dhe aktgjykimi ka marrë formën e prerë, për shembull, kur ka kaluar afati kohor brenda të cilit është lejuar ankesa. Ky interpretim siguron që çështja të konsiderohet në mënyrën më të favorshme për të akuzuarin. Ai siguron gjithashtu që të zbatohen garancitë kushtetuese dhe të parashkrimit që mbrojnë të drejtat e të akuzuarit dhe e shmang rrezikun që trupi gjykues mund të mbështetet në një interpretim apo përshtypje të gabuar të Ligjit të Procedurës Penale të Bahrejnit.

D. ÇËSHTJA NE BIS IN IDEM

3. Është e rëndësishme se ashtu si Neni 4 i KPPK-së, neni 14 (7) i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 35 i Konventës Evropiane për Transferimin e Procedurës (kur riprodhohet plotësisht ashtu si është detyrë e të gjithë avokatëve për ta bërë nëse ata propozojnë që të mbështeten në të në përkrahje të argumenteve të tyre) dhe neni 56 i Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Çështjet Penale (i cili thotë se transferimi nuk bëhet nëse aktgjykimi nuk është i formës së prerë), të gjitha i referohen *ne bis in idem*, ose kushteve të transferimit për të vuajtur dënimin zbatohen VETËM kur aktgjykimi është i formës së prerë. Është e qartë se fjalës "formë e prerë" në KPPK duhet t'i jepet kuptimi i saj i thjeshtë dhe i zakonshëm, dhe se ajo duhet të nënkuptojë atë kur ankesat të jenë dëgjuar dhe të gjitha rrugët e ankimit janë shteruar, ose kur afati kohor për të bërë ankimin ka kaluar.
4. Trupi Gjykues gjithashtu ka marrë parasysh rastin e O. kundër Zvicrës³⁶, referuar nga prokurori në parashtrësën e tij dhe lidhur me këtë rast ka theksuar kushtet e nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku thuhet:-

NENI 4 I PROTOKOLLIT NR. 7 të Konventës Evropiane të për Drejtat e Njeriut

³⁶ O. kundër ZVICRËS (84/1997/868/1080) 30 korrik 1998

Neni 4

1. Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksioni i të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë është shpallur i pafajshëm ose dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij Shteti.

Është e qartë për trupin gjykues se çështja kryesore këtu është se Konventa parashikon një ndalim për ri-gjykimin "*nën juridiksionin e të njëjtit shtet*". Në rrethanat kur Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të kërkohet në gjykatat e Kosovës³⁷, atëherë kjo deklaratë e ligjit duhet të konfirmojë se sa i përket ligjit të Kosovës, kërkesa e *ne bis in idem* është e zbatueshme VETËM si një mjet juridik kundër një ri-gjykimi vendor.

5. Trupi gjykues ka kërkuar gjithashtu të marrë udhëzime nga vendimet në dispozicion të rasteve të tjera që janë vendosur nga Gjykatat Themelore të Kosovës dhe thekson se në një rast nga Gjykata Themelore e Gjilanit e cila ka prekur çështjen e *ne bis in idem*, kjo gjykatë³⁸ - kur e ka marrë në konsideratë nëse parimi *ne bis in idem* ka përfshirë aktgjykimet e huaja të formës së prerë – shpreh se:

'Duke pasur parasysh se faktet e pretenduara janë kryer në IRJM dhe se Gjykata Primare [e redaktuar] ka lëshuar tashmë një vendim përfundimtar për [e redaktuar] për të njëjtat fakte, gjyqtari i procedurës paraprake ka shqyrtuar nëse fillimi i procedurës penale për veprimet e njëjta nga ana e Prokurorit në Kosovë do të shkelte parimin e "ne bis in idem", ashtu si përcaktohet në nenin 4 të KPK-së.. Ky parim kërkon që të ndalohet inicimi i procedurës penale kundër një personi, i cili tanimë është liruar nga akuza apo është dënuar për të njëjtat akte apo vepra penale³⁹. Gjyqtari gjithashtu ka marrë parasysh faktin se procedura në IRJM është zhvilluar në mungesë, e cila është e lejuar sipas ligjit maqedonas, por jo sipas ligjit në Kosovë. Në vitin

³⁷ Për shembull në nenin 433 dhe 441 të KPPK-së; dhe duke theksuar dispozitat e nenit 22, paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës i cili përshkruan Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj; në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe në rast të konfliktit kanë prioritet mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike;

³⁸ Në vendimin datë 05 janar 2015 (rasti kundër të pandehurit LJ)

³⁹ Neni 10 I Kushtetutës së Kosovës, neni 14(7) I Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

2010 autoritetet maqedonase i kanë paraqitur një kërkesë për ekstradim Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës, megjithatë, kërkesa nuk është përpunuar më tej për shkak se Kosova nuk ekstradon shtetasit e vet. Që atëherë është lidhur një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet IRJM-së dhe Kosovës për ekstradimin, por duke ia lënë të drejtën secilit vend të refuzojë ekstradimin e shtetasve të tyre. Kështu, në këtë fazë ekstradimi do të ishte i pamundur duke pasur parasysh faktin se Ministria nuk ka vepruar pas kërkesës të mëparshme, se IRJM-ja nuk do të paraqesë kërkesë tjetër për ekstradim dhe se ekstradimi në çdo rast do të kërkonte që të ofrohet siguri se një gjykim i ri mund të zhvillohet për [emri i redaktuar] duke pasur parasysh faktin se gjykimi i parë ishte kryer në mungesë (sic) dhe se ai nuk do të ekstradohet në vende të tjera të mëtejshme ku ai kërkohet, të tilla si [redaktuar]. Në ndërkohë, autoritetet maqedonase ia kanë ofruar Prokurorit në Kosovë të gjitha provat dhe dokumentet. Ekzekutimi i aktgjykimit të IRJM-së konsiderohet gjithashtu i pamundur lidhur me faktin se ligji i Kosovës nuk lejon gjykimin në mungesë, i cili mund të shkeli parimin e gjykit të drejtë dhe të paanshëm, siç parashihet me nenin 31 të Kushtetutës dhe përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të KEDNJ-së dhe nenit të saj 6. Sipas mendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake nuk është e sigurt nëse barazia e armëve është respektuar në gjykimin në IRJM dhe nëse të drejtat e të pandehurit janë mbrojtur në masë të mjaftueshme nga avokati ex-officio. Së fundi, nëse gjyqtari i procedurës paraprake nuk do ta merrte parasysh se këto procedura penale mund të zhvillohen në mënyrë ligjore sipas ligjit të Kosovës, lidhur me faktin se ekstradimi i [redaktuar] nuk ka gjasa të ndodhë dhe se ekzekutimi i aktgjykimit të IRJM-së nuk është i mundur atëherë kjo mund të rezultonte në dështim të drejtësisë. Në të vërtetë, gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se zbatimi i përpiktë i ne bis in idem në vendimet apo aktgjykimet e lëshuara nga juridiksionet e huaja duhet të merret në konsideratë me kujdes në dritën e marrëdhënieve ndërmjet shteteve sovrane sepse mungesa e bashkëpunimit të duhur ndërkombëtar mund të çojë në dështimin e parimeve të larta të drejtësisë. Konflikti në mes të dy aktgjykimëve në rastet identike ndërmjet anëtarëve të Bashkimit Evropian duhet të konsiderohet ndryshe nga situatat e ngjashme në

mes të dy shteteve sovrane të tilla si Kosova dhe Maqedonia të cilat kohët e fundit janë prekur nga një konflikt dhe me dyshim të ndërsjellë në sistemin përkatës të drejtësisë. Megjithatë, përcaktimi i veprave penale të cilat mund të konsiderohen si identike me vepra penale për të cilat i pandehuri është dënuar është një objekt i hetimit dhe ndjekjes penale në vazhdim dhe do të rivlerësohet gjatë gjykimit të këtij rasti. Vlerësohet se në mes të rrezikut të dështimit të drejtësisë dhe interpretimit formal të parimit ne bis in idem, gjyqtari i procedurës paraprake ka vendosur se duhet të jepet drejtësi në këtë rast. Kështu, gjyqtari i procedurës paraprake arrin në përfundimin se procedura penale e kryer kundër [redaktuar] nuk është në kundërshtim me parimin ne bis in idem’.

6. Trupi gjykues thekson se përmbledhja e mësipërme edhe pse e gjatë, ofron mbështetje për propozimin se edhe një aktgjykim i formës së prerë nga jashtë nuk është i mjaftueshëm për të nxitur parimin *ne bis in idem* sepse ky parim është i zbatueshëm vetëm për juridiksionin vendor.

E. Përfundim.

7. Trupi gjykues konsideron se jurisprudenca e kombinuar vendore, jurisprudenca ndërkombëtare, së bashku me dispozitat e marrëveshjeve të ndryshme ndërkombëtare për të cilat Kosova ka rënë dakord për t'i përmbushur - dhe në fakt ti përcaktojë si përparësi ndaj legjislacionin vendor - të gjitha konfirmojnë që kërkesa për *ne bis in idem* është e zbatueshme VETËM për aktgjykimet e mëparshme vendore. Për më tepër, vetë neni 4 i KPPK-së hesht lidhur me atë nëse ai zbatohet për aktgjykime të huaja ose jo, në mungesë të asaj që është deklaruar shprehimisht, se ai nuk mund të interpretohet si diçka që ishte synuar qartë nga ligjvënësit brenda kuptimit të nenit. Në të vërtetë, neni 4, paragrafi 2 shkruan se një vendim i formës së prerë i gjykatës mund të ndryshohet vetëm përmes mjeteve të jashtëzakonshme juridike, siç parashikohet nga kodi dhe është mendimi i trupit gjykues që këta dy paragrafë duhet të lexohen në mënyrë të ndërlidhur, dhe për rrjedhojë aktgjykimi i formës së prerë nënkupton aktgjykimin i formës së prerë brenda skemës të KPPK-së dhe KPK-së.

8. Duke qenë kështu, trupi gjykues e konsideron të panevojshme për të vendosur nëse ekziston një e drejtë zakonore ose jo se *ne bis in idem* zbatohet mes gjykatave të juridiksionit të barabartë në vende të ndryshme.
9. Për të gjithat arsytet e cekura më sipër, neni 72 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështje Penale zbatohet e që bënë të i referohemi arsyetimit të mësipërm se neni 4 i KPPK-së është i pazbatueshëm në këtë rast. Pra, Gjykata Themelore e Prishtinës, Kosovës, ka juridiksionin për të gjykuar këtë rast.

B) Shqyrtimi gjyqësor.

i. Prova të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjatë rrjedhës së mundësisë hetuese të veçantë dhe shqyrtimit gjyqësor janë marrë në pyetje dëshmitarët vijues dhe janë administruar provat vijuese.

i. Deklarata të dëshmitarëve

Deklaratat e mëposhtme të dëshmitarëve janë përfshirë në dosjen e rastit dhe janë regjistruar si prova:

- (1) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me M.Z., datë 16 shtator 2013;
- (2) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me J. V.E. R, datë 22 shtator 2013;
- (3) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me J. V. S., datë 25 shtator 2013;
- (4) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me M. M. A. Z. A., datë 25 shtator 2013;
- (5) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me kapitenin G. A. A., datë 26 shtator 2013;
- (6) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me I., datë 2 tetor 2013;
- (7) Intervistë e Prokurorisë së Bahrejnit me E. G., datë 2 tetor 2013;
- (8) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me R. P., datë 11 shtator 2013;
- (9) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me Sh. R. B., datë 11 shtator 2013;
- (10) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me A. A. I. A. M., datë 11 shtator 2013;
- (11) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me H. A. I. A. M., datë 11 shtator 2013;
- (12) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me M.Z., datë 11 shtator 2013;

- (13) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me A. C., datë 15 shtator 2013;
- (14) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me A. S., datë 16 shtator 2013;
- (15) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me M., datë 15 shtator 2013;
- (16) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me M. A. M., datë 15 shtator 2013;
- (17) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me J. V. S., datë 23 shtator 2013;
- (18) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me M. M. A. Z. A., datë 23 shtator 2013;
- (19) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me A. Y. G. A. A., datë 1 tetor 2013;
- (20) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me E. G., datë 1 tetor 2013;
- (21) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me I., datë 2 tetor 2013;
- (22) Intervistë e Policisë së Bahrejnit me A. C., datë 2 tetor 2013.⁴⁰

ii.

Dëshmi të procedurës paraprake të Prokurorit të Kosovës me të pandehurit dhe dëshmitarët:

- 1. Dëshmi e procedurës paraprake të Prokurorit me të pandehurin H.G., datë 9 tetor 2013;
- 2. Dëshmi e procedurës paraprake të Prokurorit me të pandehurin G.A., datë 9 tetor 2013;
- 3. Dëshmi e procedurës paraprake të Prokurorit me të pandehurin R.A., datë 9 tetor 2013;
- 4. Dëshmi e procedurës paraprake të Prokurorit me të pandehurin A.S., datë 17 nëntor 2013;
- 5. Dëshmi e procedurës paraprake të Prokurorit me të pandehurin E.G., datë 9 dhjetor 2013;
- 6. Intervistë e Prokurorit me B. H., datë 24 tetor 2013;
- 7. Intervistë e Prokurorit me L. S., datë 11 nëntor 2013;
- 8. Intervistë e Prokurorit me Sh. A., datë 11 nëntor 2013;
- 9. Intervistë e Prokurorit me A. G., datë 18 nëntor 2013;
- 10. Intervistë e Prokurorit me A. B., datë 18 nëntor 2013 dhe 24 dhjetor 2013;
- 11. Intervistë e Prokurorit me B. B., datë 24 dhjetor 2013;
- 12. Intervistë e Prokurorit me A. G., datë 26 dhjetor 2013;
- 13. Intervistë e Prokurorit me R. G., datë 30 dhjetor 2013;

iii. Marrja në pyetje me gojë e dëshmitarëve

⁴⁰ Dëshmitarë nga Lidhjet 1-22 – të dosjeve të Prokurorisë së Bahrejnit. Volumi 10.

Gjykata dëgjoi dëshmitarët e mëposhtëm:

Dëshmitarët J. F. A. R., R. T. P., M. Z., Sh. R. B., G. A. A. E. A.; J. V. S. dhe Sh. T. M. Sh. M. u dëgjuan përmes video lidhjes në seancë të mundësisë hetuese të veçantë të mbajtur më 1, 2, 3, 7 korrik 2014⁴¹.

ii. Dëshmi të dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor

Zyrtarë policorë në cilësinë e dëshmitarëve:

R. B. u dëgjua më 24 nëntor 2014;

N. G. u dëgjua më 24 nëntor 2014;

M. A. u dëgjua më 24 nëntor 2014;

A. M. u dëgjua më 16 dhjetor 2014;

Xh. M. u dëgjua më 16 dhjetor 2014;

Sh. A. u dëgjua më 16 dhjetor 2014.

Dëshmitarë të tjerë:

A. B., menaxher i shitjeve të Agjencia e Udhëtimit ‘xxxx’, u dëgjua më 29 janar 2015, 3 shkurt 2015;

B. H., argjendar, u dëgjua më 14, 27 dhe 28 janar 2015.

Sh. G. u dëgjua më 28 janar 2015;

Dëshmitarë nga Bahrejni të dëgjuar përmes video lidhjes.

I. E. u dëgjua përmes video lidhjes më 10 dhjetor 2014;

M. S. u dëgjua përmes video lidhjes më 11 dhjetor 2014.

⁴¹ Një seancë tjetër dëgjimore ishte caktuar për më 8 korrik 2014 ku duhej të merrej në pyetje I.E. dhe H. A. I. A. M, megjithatë, kjo nuk ndodhi pasi seanca u ndërpre për shkak të sëmundjes të të pandehurit R.A..

Prova materiale:

Sa i takon procedurës së provave, në pajtim me nenin 311, paragrafi 1 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve, u ra dakord nga të gjithë që të konsiderohen si të lexuara, administruara ose shqyrtuara provat e marra nga PSRK-ja si edhe pjesët e provave të grumbulluara nga autoritetet e Bahrejnit dhe të transferuara në Republikën e Kosovës. Më tej, në këtë aspekt, avokatët mbrojtës B. T. dhe A. H. paraqitën në gjykatë një propozim të përbashkët, datë 22 qershor 2015, me të cilin propozonin që të mos shqyrtoheshin disa prej pjesëve të provave, ashtu si janë shënuar në këtë parashtresë në paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, me arsyetimin se këto pjesë të provave ose nuk lidhen me procedurën e tanishme ose tregojnë veprime procedurale të ndërmarra nga prokurori dhe/ose gjyqtari i procedurës paraprake dhe si të tilla nuk mund të trajtohen si prova.

Gjykata ndan mendimin e njëjtë me mbrojtjen në lidhje me shumicën e çështjeve të përmendura në kërkesën e mbrojtjes. Më tej, në lidhje me propozimin nr. 5, meqë rreshteri R. B. është dëgjuar si dëshmitar më 24 nëntor 2014, është pranuar përmbledhja e bisedës së tij me E. G. Gjithashtu u pranua si provë propozimi i mbrojtjes për të administruar si provë Vaktia e Ramazanit për vitin 2013 dhe 2015.

Lista e provave të Prokurorisë

Lidhja I- Dosjet e Policisë Volumi 1,

Transkriptimi i një bisede telefonike të zhvilluar ndërmjet zyrtarit të policisë së Bahrejnit, përgjegjës për hetimet dhe Kapitenit të Policisë së Kosovës në të cilën bisedë janë dhënë hollësitë e grabitjes. Shpjegohet shkurtimisht se kopja e pasaportës që është përdorur për të marrë më qira një veturë përputhet me filmimin CCTV nga hyrja në aeroportin ndërkombëtar të Bahrejnit të cilat çuan në identifikimin e një prej të dyshuarve, P.F. Më tej, vërtetohet nga autoritetet lidhja mes Agjencisë së Udhëtimit ‘xxxx’, Agjencisë së Udhëtimit ‘xxxx’ dhe Agjencisë të Vizave ‘xxxx’. Faqet 2-9: shfaqin fotografitë e të dyshuarve, pasaportat e tyre, hotelet ku kanë qëndruar, datat e hyrjes dhe datat e daljes nga Bahrejni në lidhje me tri udhëtimet e ndryshme të bëra nga të dyshuarit gjatë vitit 2013, *ndarja 2, faqe 1.*

Lista e orëve të dorës të vjedhura, me modelet dhe numrat e serisë, të ofruara nga Policia⁴² e Bahrejnit, *ndarje 7, faqet 66-67.*

Kopjet e faqes së parë të pasaportave të të pandehurve A.S., R.A., G.A. dhe E.G., si edhe të atyre që kanë të bëjnë me P. F. dhe A.D. Gjithashtu (faqe 69) kopje e pasaportës të një personi me emrin A. S.- kopje e një pasaporte të falsifikuar dhe vula e falsifikuar, *ndarje 8, faqe 70-79.*

Raport informues në lidhje me ‘Victoria-n’ – Përmbledhje e bisedave telefonike të mbajtura midis rreshter R. B. nga Policia e Kosovës dhe shtetasit amerikan/kosovar të arrestuar në Bahrejn, E. G., datë 2 tetor 2013, nr. reference 2013DKKO0034, *ndarje 15, faqe 120, 121.*

Një fletë e shtypur nga Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës- të dhëna personale në lidhje me R.A. i njohur si R.Z., *ndarje 21, faqe 284.*

Raport për kontrollin e shtëpisë, datë 8 tetor 2013, në lidhje me shtëpinë e R.A., *ndarje 23, faqe 287-306.*

Raport për kontrollin – Vërtetime të regjistrimit të Agjencisë së Vizave ‘xxxx’, me vendndodhje në Prishtinë, Kosovë, *ndarje 24, faqe 308-309.*

Raport për kontrollin e shtëpisë, datë 8 tetor 2013 në lidhje me shtëpinë e G.A., *ndarje 25, faqe 341/326.*

Lidhja II- Dosjet e Policisë Volumi 2

Raport për kontrollin e shtëpisë – shtëpia e A.S.; Bileta të shtypura udhëtimi (bileta avioni) Prishtinë/Frankfurt/Bahrejn/Frankfurt/Prishtinë, data e daljes 24 janar 2013, data e hyrjes 2 shkurt 2013 në emra të D.D. dhe B.B.; bileta Prishtina/Stamboll/Bahrejn/Stamboll/Prishtina, me të njëjtat data, në emra të R.A. dhe A.G.; Bileta të shtypura udhëtimi (bileta avioni) Prishtinë/Vienë/Dubai/Bahrejn/Dubai/Vienë/Prishtinë, data e daljes 26 janar 2013, data e hyrjes 5 shkurt 2013 në emra të D. D. dhe B. B.; Kopje e listës me shkrim dore të markave të orëve të dorës përfshirë fjalët “4 x Rolex”; Kopje e vizës 7 ditore për biznes për Bahrejn në emër të R.A., data e skadimit: 19 shkurt 2013; Konfirmim hoteli për hotelin ‘Parse xxx’, dhomë dyshe standarde me mëngjes në emra të B.B. dhe A. G.; Kopje e vizës 7 ditore për biznes për Bahrejn në emër të B.B., data e skadimit: 19 shkurt 2013; Konfirmim hoteli për hotelin ‘xxxx International’, dhomë dyshe standarde me mëngjes në emra të D.D. dhe R.A.;

⁴² Lista tregon 81 orë dore, megjithatë më vonë u vërtetua se ishin 79 orë dore.

Kopje e vizës 7 ditore për biznes për Bahrejn në emër të D.D., data e skadimit: 20 shkurt 2013; Kopje e vizës 7 ditore për biznes për Bahrejn në emër të A.G., data e skadimit: 20 shkurt 2013; Kopje e letërnjoftimit nga Republika e Maqedonisë në emër të A.S. dhe letërnjoftimit të lëshuar nga Republika e Kosovës në emër të A.S.; Kopje e faqes së parë të pasaportës të A.S. (Republika e Kosovës), *ndarje 26, faqe 25, 26, 50, 68, 70, 71, 72, 75, 88 dhe 90.*

Lidhja III- Dosjet e Policisë Volumi. 3

Raport Informativ i Policisë, datë 7 tetor 2013, numër reference 2013-DKKO-034 konfirmon se numri e telefonit 045-412-..8 është në përdorim nga G.A. dhe numri i telefonit 049-495-..5 është në përdorim nga A.S., *ndarje 3, faqe 44-46.*

Raport për kontrollin e shtëpisë, datë 8 tetor 2013, në shtëpinë e H.G. me fotografitë dhe përshkrimin e municioneve të konfiskuara, *ndarje 5, faqe 65-81.*

Kërkesë e policisë, datë 11 tetor 2013, numër reference: 2013-DKKO-034, për lëshimin e urdhrit për ekzaminimin e pajisjeve dixhitale të konfiskuara prej të pandehurve, të cilat përfshijnë si vijon: një telefon celular dhe një kartelë SIM janë konfiskuar në posedim të G.A.; një telefon celular dhe dy kartela SIM janë konfiskuar në posedim të R.A.; janë konfiskuar 21 kartela SIM në posedim të A.S., *ndarje 12, faqe 184-189*

Letër e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës për Mbretërinë e Bahrejnit me të cilën kërkohet transferimi i procedurës penale ndaj D. D., G.A. dhe R.A., *Ndarje 18, faqe 207-208*

Raport policie, datë 21 tetor 2013, me fotografitë e të gjithave artikujve që u janë konfiskuar A.S., H.G., R.A. dhe G.A. dhe që janë dërguar në Njësinë e Ekzaminimit si edhe një listë të atyre që nuk janë dërguar në Njësinë e Ekzaminimit, *ndarje 20, faqe 216-238.*

Letërkëmbimi datë 28 tetor 2013, i dërguar nga V. E. prokurorit Robert Kucharski, në të cilin janë dërguar fletë të shtypura të Sistemit të Menaxhimit të Kufirit (SMK) me datat e hyrjes dhe daljes të të dyshuarve: disa nga të dhënat e regjistruara në regjistrat e SMK-së përputhen me udhëtimet e planifikuara dhe rezervuara me Agjencinë e Udhëtimit ‘xxxx’, si edhe shenjat e gishtërinjve, *ndarje 24, faqe 305-336.*

Dosjet e Policisë Volumi 4- Dokumentet e kontrolluara tek ‘Xxxx’

Të gjitha dokumentet e udhëtimit të ‘Xxxx-’ – të lexuara në seancën gjyqësore kur dha dëshminë e tij A. B. me 29 janar 2015 dhe 3 shkurt 2015.

Lidhja, Dosjet e Policisë Volumi 5

Dorëzimi i 1 CD-je me të dhëna hartografike IMEI nga VALA. Fletë dorëzimi mban datën 25 tetor 2013 dhe është bërë nga rreshter R. B. tek PSRK-ja, *ndarje 3, faqe 21-52;*

Dorëzimi i 1 CD-je, datë 28 tetor 2013, me të dhëna hyrëse dhe dalëse nga VALA. Posta elektronike e kapiten Ghazi në Bahrej për V. E. në lidhje me konstatimet e filmimeve CCTV nga hoteli për të dy të pandehurit. Kërkesë nga Policia e Kosovës për autoritetet e Bahrejit për të dorëzuar dosjet e policisë, *ndarje 4, faqe 53-61.*

Raport për kontrollin, datë 23 tetor 2013, e rezidencës të G.A. me qëllim të konfiskimit të këpucëve që përputhen me këpucët e veshura nga të pandehurit në filmimet CCTV nga Bahrej. Bashkangjitur raportit, janë fotografitë e atleteve të konfiskuara, *ndarje 7, faqe 157-172.*

Raport për kontrollin, datë 24 tetor 2013, e rezidencës të N.Z., babai i të pandehurit R.A.-Z., me qëllim të konfiskimit të këpucëve që përputhen me këpucët e veshura nga të pandehurit në filmimet CCTV nga Bahrej. Bashkangjitur janë fotografitë e vendit ku mbaheshin këpucët, *ndarje 8, faqe 173-189.*

Raport për kontrollin, datë 24 tetor 2013, e R.A. në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë me qëllim të konfiskimit të këpucëve që përputhen me këpucët e veshura nga të pandehurit në filmimet CCTV nga Bahrej. Bashkangjitur raportit janë fotografitë e atleteve të konfiskuara, *ndarje 9, faqe 190-198.*

Raport Informimi, datë 28 tetor 2013, në lidhje me numrin e telefonit xxxxx që i përket bashkëshortes të A.S.t, i cili deklaron se ky numër është përdorur gjithashtu nga A.S., *ndarje 10, faqe 199-204.*

Raport, datë 5 nëntor 2013, në lidhje me kontrollin e shtëpisë të Sh. G. në vitin 2007 dhe artikujt e konfiskuara. Ky raport konfirmon se zyrtarët policorë kishin marrë municionin e paligjshëm nga kjo rezidencë në vitin 2007, *ndarje 15, faqe 224-226.*

Raport për kontrollin e kryer në datën 18 tetor 2013 në rezidencën e R.A./Z. dhe listën e artikujve të konfiskuara, *ndarje 25, faqe 294-302.*

Përgjim i telekomunikimeve (vetëm ato përkatëset me datat e treguara në arsyetim) të përfshira në Lidhjen I-Dosjet e Policisë Volumi 1, Lidhja III-Dosjet e Policisë Volumi 3, Lidhja-Dosjet e Policisë Volumi 5, dhe Lidhja VI-Dosjet e Policisë Volumi 6.

Lidhja VII-Dosjet e Policisë, Volumi 7

Memorandum Zyrtar në lidhje me raportin e mjekësisë ligjore për analizën e ADN-së, datë 2 prill 2014, numër reference AKF/2014-0753/2014-607 – që vërteton se ADN-ja e G.A.t përputhet me mostrën e indit njerëzor të marrë nga një shkop të gjendur në vendin e ngjarjes, *ndarje 9, faqe 91-103.*

Raport nga Agjencia e Kosovës për Mjekësi Ligjore, datë 11 gusht 2014 me të cilin informohet prokurori se ekspertiza e spërkatjes (Nato spray) nuk mund të kryhet në këtë institucion, *ndarje 13, faqe. 108.*

Lidhja V – Dosjet e Prokurorit, Volumi 1

Kërkesa për ndihme juridike ndërkombëtare e dërguar në Shqipëri, datë 7 tetor 2013 në lidhje me E.G., *ndarje 14, faqe 146-151.*

Lidhja VI – Dosjet e Prokurorit, Volumi 2

Lista e artikujve të konfiskuara në kontrollin e shtëpisë të A.S.t, *ndarje 13, faqe 150-156.*

Shënim zyrtar për artikujt e konfiskuar në kontrollin e shtëpisë të A.S., *ndarje 14, faqe 157-210.*

Lidhja – Dosjet e Prokurorit, Volumi 3

Aktvendim për pranimin e transferimit të procedurës nga Mbretëria e Bahrejnit, datë 28 tetor 2013, *ndarje 3, faqe 22-23.*

Lidhja – Dosjet e Prokurorit, Volumi 6

Fotografi të orës së dorës ‘Rolex’, *ndarje 2 faqe 33 dhe 34.*

Procesverbal për kontrollin e CD-së në lidhje me ADN-në dhe testin e shenjave të gishtërinjve, *ndarje 6, faqe 62-68A plus shtojcat – 2,3, 4,6 dhe fotografitë e shenjave të gishtërinjve*

Lidhja, Dosjet e Prokurorisë, Dokumentet e Bahrejnit, Volumi 7

Informacion nga Mbretëria e Bahrejnit në lidhje me grabitjen e butikut ‘Rolex’ dhe të dhëna për të dyshuarit, *ndarje 2, faqe 17-45.*

Kodi Penal i Bahrejnit 1976 (dispozitat përkatëse), *ndarje 5.*

Lidhja, Dosjet e Prokurorisë, Volumi 8

Mostra të ADN-së- Raport i Interpolit, *ndarje 4, faqe 164-165.*

Fotografi në lidhje me kontrollin e shtëpive, *ndarje 5, faqe 166-172*

Raport në lidhje me mostrat e ADN-së të grumbulluara nga E.G., R.A., G.A. dhe A.S., *ndarje 13, faqe 322-336.*

Material Hetimor në Bahrejn, dosja Ii

Letër-reshtim Ndërkombëtar- përfshirë fotografi CCTV nga skena e krimit. *ndarje 2, faqe 5-25.*

Raport Fillestar i Policisë së Bahrejnit pasi është informuar për grabitjen tek butiku ‘Rolex’ dhe procesverbali i procedurës- raport rreth njësive që kanë marrë pjesë në vendin e ngjarjes më 11 shtator 2013, *ndarje 3, faqe 26-55.*

Vëzhgimi i filmimit CCTV – të pandehurit largohen dhe kthehen në hotelet e tyre, *ndarje 18, faqe 136 dhe 138.*

Të dhëna qarkullimi për xhipin ngjyrë hiri, targë 8079, *ndarje 21, faqe 145,*

Material Hetimor në Bahrejn, dosja Iii

Përmbledhje e shqyrtimit hetimor nga ndihmësi i Prokurorit, M.S. për Drejtorin e Drejtorisë së Policisë së Guvernatoriatit të Kryeqytetit, *ndarje 1, faqe1-3.*

Ekzaminime të mjekësisë ligjore për konstatimet në vendin e ngjarjes dhe tek viktima M. Z., *ndarje 4 dhe 7.*

Të dhëna për hyrjen e dytë, për mbërritjen e P.F.; A.D.; D. D. dhe G.A., *ndarje 11, faqe 61-63.*

Të dhëna për hyrjen e tretë, për mbërritjen e P.F.; A.D.; D. D, G.A., E.G. dhe R.A., *ndarje 12, faqe 64-66.*

Hetimet e mëtejme që tregojnë orën kur të pandehurit janë larguar nga hotelet dhe aktivitetin e tyre gjatë ditëve para grabitjes. Ata largohen dhe kthehen në hotelet e tyre në kohë të përafërt, shkojnë në qendër tregtare, kryejnë sulmin dhe grabitjen dhe kthehen përsëri, *ndarje 19, 87-94.*

Raport për kontrollin e dhomës të zënë nga I.E. ku u gjetën 63 orët e dorës, *ndarje 20, faqe 95-97.*

Të dhëna për hyrjen dhe daljen e E. G., *ndarje 22, faqe 102-104.*

Të dyshuarit u identifikuan se kanë veshur me vello të zezë, *ndarje 28, faqe 131-162.*

Fotografi nga filmimet CCTV të të pandehurve në qendrën tregtare dhe në hotele, *ndarje 29, faqe 163-168.*

Intervistë me E. G. me të cilën ai e ka informuar policinë e Bahrejnit se kishte ardhur në Bahrejn më 29 shtator 2013 dhe kishte qëndruar në banesë, atij i ishte thënë të takonte I.E. tek hoteli 'xxxxx', *ndarje 30.*

Procesverbal për hetimet e Prokurorit Publik të Mbretërisë së Bahrejnit- Informacion për dy të pandehurit: I.E. dhe E. G. të cilët ishin ndaluar për 6 ditë; dorëzimi i 63 orëve të dorës, *ndarje 31, faqe 227-233;*

Lidhja – Material Hetimor Bahrenj 2

Permbledhje e veprimeve hetimore, *Tab 1, faqet 1-8.*

Pasaportat dhe informacion për viza të të pandehurve, *Tab 5, faqet 120-146.*

Perbledhje e të dhënave të hotelit dhe flutirimeve për të pandehurit, dhe levizjet e P.F., *Tab 6, faqet 147-203.*

Të dhëna për lëvizjet e D. D. (A.S.), A.D., G.A., E.G., R.A., *ndarje 7, faqe 204 -263*

Dokumentacioni për marrjen me qira të veturës dhe inventari i artikujve të vjedhur, *ndarje 9, faqe 303-318.*

Dokumentacioni për marrjen me qira të veturës dhe fotografi të A. D. dhe . D.D. në grabitje, *ndarje 10, faqe 319-327.*

Informacion për vizën e kategorisë për biznes dhe përmbledhje e rezervimit të hotelit, *ndarje 11, faqe 328-467.*

Lidhja – Material Hetimor në Bahrejn 3

Raport mjekësor për M. Z. që konfirmon se ai është spërkatur në sy, *ndarje 2, faqet 109-111, dhe ndarje 11 faqe 148-159*.

Shtojca: Artikuj të konfiskuara në veturë; kopje e pasaportave dhe patentë shoferit; kopje e vulës hyrëse të falsifikuar dhe e origjinale; fotografi e të pandehurit të parë jashtë aeroportit të Bahrejnit pas kryerjes së krimit; kopje e pasaportës të të pandehurit të parë, origjinalja dhe ajo e falsifikuara; raport për të dhënat e veturës, *ndarjes 12-19 të gjitha faqet*.

Rezervimi në hotel ‘xxxxx’, *ndarje 29, faqe 243-308*.

Raporti Balistik, i dates 14 gusht 2014 lidhur me municionin e konfiskuar ne shtepine e H.G., Dosja e Prokurorise pas ngritjes se Aktakuzes, *Lidhja 1, ndarja 3*

Prova të mbrojtjes

Orari i Ramazanit për vitin 2013 dhe 2015, *Lidhja e Shqyrtimit Gjyqësor VII, ndarje 3*.

Dëshmi të dëshmitarëve:

Përmbledhje e dëshmive të dëshmitarëve

a) Atyre të seancave të mundësisë hetuese të veçantë.

Menaxheri i shitjeve në butikun ‘Rolex’ në Qendrën Tregtare të Qytetit në M., Bahrejn, **J.R.** dha dëshmi gjatë seancës së mundësisë hetuese të veçantë më 1 korrik 2014. Ai deklaroi se kishte punuar si menaxher në butikun e veçantë ‘Rolex’, dyqan që ndodhej në nivelin e parë të Qendrës Tregtare të Qytetit në M.. Ai kishte ardhur në dyqan në mëngjesin e datës 11 shtator 2013, pasi kishte ndodhur grabitja. Pastaj, ai kishte vëzhguar xhamin e thyer, se të gjitha orët e dorës ishin marrë dhe deklaroi se zyrtarët policore ishin të pranishëm në dyqan po ashtu. Më tej, ai deklaroi se kishte bërë një listë inventari të orëve të dorës të vjedhura; ishin shtatëdhjetë e nëntë orë dore (79), ‘Rolex’ dhe orë dore ‘Theodore’. Dyqani ishte mbyllur për dhjetë ditë. Ai deklaroi se kishte parë njolla gjaku në

xhamin e thyer dhe se ekipi i mjekësisë ligjore i kishte marrë këto prova të mjekësisë ligjore me vete. Ai deklaroi gjithashtu se policisë i ishin dhënë kopje të video regjistrimit të grabitjes nga kamerat e ndryshme.

Në lidhje me dëmet në butikun 'Rolex', dëshmitari J.R. deklaroi se ishte thyer dera kryesore, ishin thyer të gjitha dollapët vitrinë dhe dy vitrinat në mur po ashtu ishin thyer.

Në lidhje me njollat e gjakut, deklaroi se vitrina e xhamit ishte 130-150 centimetra e lartë dhe se ana e vitrinës ishte prej druri dhe ana tjetër prej xhami, pra kur xhami ishte thyer ajo kishte rënë në ndarje dhe ai kishte parë gjak atje. Ai deklaroi gjithashtu se kishte gjak në copat e thyera të xhamit të dollapit vitrinë. Xhamat e thyer me njolla gjaku ishin brenda dollapit vitrinë ku ishin ekspozuar orët e dorës. Së fundi, dëshmitari J.R. deklaroi se në dyqan ndodheshin pesë kamera video, nga të cilat njëra ishte përballë derës, një kamerë ishte përballë kasafortës dhe kamerat e tjera ishin përballë dollapëve vitrinë.

Dëshmitari **R.T.P.**, menaxher i butikut 'Rolex', dha dëshmi në seancën e mundësisë hetuese të veçantë më 1 korrik 2014. Ai deklaroi se kishte arritur në butikun 'Rolex' rreth orës 11:30 afër mesnatës më 10 shtator 2013, dhe kishte vërejtur se dera ballore ishte thyer, se të gjithë dollapët vitrinë ishin thyer, dritarja vitrina ishte thyer dhe mungonin shumë orë dore. Ai deklaroi gjithashtu se ishin të pranishëm policia dhe drejtuesit e dyqanit kur kishte mbërritur ai.

Dëshmitari R.T.P. deklaroi më tej se kishte bërë një listë inventari. Ai kishte arritur në përfundimin se ishin vjedhur gjithsej 79 orë dore nga të cilat 70 orë dore ishin 'Rolex' dhe 9 orë dore ishin 'Theodore'. Departamenti i kontabilitetit i butikut 'Rolex' kontrollloi numrin e orëve të dorës të vjedhura dhe konfirmoi se numri dhe marka e orëve të dorës ishin të sakta. Ai deklaroi gjithashtu se shtatë nga orët e dorës 'Rolex' që kishin mbetur në dyqan ishin dëmtuar. Kur u pyet, ai shpjegoi se bëhej inventari pas secilit turn me qëllim që të numëroheshin se sa ora ishin aty. Dëshmitari R.T.P. dëshmoi se dyqanit iu kthyen përsëri 63 orë dore nga policia, megjithatë orët e dorës ishin të dëmtuara. Ai deklaroi gjithashtu se ende mungonin 16 orë dore 'Rolex'.

Më tej, deklaroi se kishte parë gjak në dollapët vitrinë dhe se dollapi vitrinë ishte marrë nga policia. Ai nuk e dinte se sa njolla gjaku ishin atje. Së fundi dëshmitari

deklaroi se të katër dollapët vitrinë ishin dëmtuar dhe orët e dorës ishin marrë nga dy dollapë vitrine dhe nga një dritare vitrinë.

Pala e dëmtuar, **Z. M.Z.**, dha dëshmi gjatë mundësisë hetuese të veçantë më 2 korrik 2014, dhe deklaroi se ka qenë në detyrë si roje sigurie në Qendrën Tregtare më 10 shtator 2013, dhe rreth orës 11:20 në darkë ose 11.00 ai ka parë 5-6 njerëz që kishin veshur të ashtu quajturat *abaya* dhe me karrocë fëmije.

Papritmas, një apo dy prej tyre nxorën një sprek dhe e spërkatën atë në fytyrë. Ai u përpoq të thërriste kolegët e tij me një radio marrëse dhënëse. Dëshmitari deklaroi se dikush nga grupi i njerëzve e ka goditur atë në shpinë dhe ai ka rënë përtokë. **Z. Z.** tha se nuk ka mundur të shikojë asgjë. Megjithatë ai ka dëgjuar se diçka ishte thyer në dyqan. Më tej, dëshmitari deklaroi se kishte bërëtitur dhe thirrur për ndihmë dhe kur kishte arritur kolegu i tij, dëshmitari **Z. B.**, 5-6 njerëzit e veshur në *abaya* u larguan dhe grupi e gjuajti atë me një kaçavidë.

Më tej, dëshmitari deklaroi se kur grupi u largua ata vrapuan dhe kishin një shufër hekuri me vete, me të cilën grupi theu derën rrëshqitëse prej xhami për të dalë nga qendra tregtare. Kur u pyet, dëshmitari deklaroi se grupi kishte hyrë në qendrën tregtare nëpërmjet portës numër 5 dhe se nuk kishte mundur të shikonte fytyrat e personave që ishin në grup sepse ata ishin veshur me *abaya*, megjithatë gjatë vrapimit ata u sollën si të ishin burra. Së fundi dëshmitari deklaroi se pas incidentit, atë e kishin dërguar në spital me ambulancë dhe sipas tij sytë i kishin djegur për 8-9 ditë.

Dëshmitari **Z. Sh.R.B.**, oficer sigurimi në qendrën tregtare dha dëshmi gjatë seancës së mundësisë hetuese të veçantë të mbajtur më 2 korrik 2014. Ai deklaroi se punonte si oficer sigurimi në qendrën tregtare dhe se kishte veshur uniformë si oficer sigurimi. Me këtë rast, kishte dëgjuar një zë të lartë se dikush po bërtiste duke kërkuar ndihmë, dëshmitari deklaroi se kishte vrapuar për të mbështetur kolegun e tij, **M.Z.**. Dëshmitari **Z. Sh.R.B.**, oficer sigurimi në qendrën tregtare dha dëshmi gjatë seancës së mundësisë hetuese të veçantë të mbajtur më 2 korrik 2014. Ai deklaroi se punonte si oficer sigurimi në qendrën tregtare dhe se kishte veshur uniformë si oficer sigurimi. Me këtë rast, kishte dëgjuar një zë të lartë se dikush po bërtiste duke kërkuar ndihmë, dëshmitari deklaroi se kishte vrapuar për të mbështetur kolegun e tij, **M.Z.**.

Dëshmitari Z. B. konfirmoi vëzhgimet e kolegëve të tij, dëshmitarit Z. B, duke thënë se ai kishte parë xhamin e thyer dhe dollapët vitrinë të thyera në butikun 'Rolex'. Dëshmitari deklaroi gjithashtu se pasi kishte mbërritur në butikun 'Rolex', ai kishte thirrur eprorin dhe policinë gjithashtu.

Dëshmitari deklaroi se kishte vrapuar pas grupit të njerëzve, por kishte ndaluar kur grupi i njerëzve kishte thyer derën rrëshqitëse duke i hedhur diçka derës rrëshqitëse ata e kishin thyer atë.

Dëshmitari **G.A.A.E.A.S**, zyrtar policor dhe hetuesi udhëheqës i rastit kriminal në Mbretërinë e Bahrejnit dha dëshmi më 3 korrik 2014, ai deklaroi se policia kishte mbërritur në skenën e krimit në qendrën tregtare menjëherë pas grabitjes. Ekipi i mjekësisë ligjore të policisë së Mbretërisë së Bahrejnit kishte mbërritur në skenën e krimit për të mbledhur dëshmi. Dëshmitari deklaroi se ai vetë kishte shkuar në vendin e ngjarjes dy ditë pas grabitjes. Dëshmitari përshkroi veprimet dhe konstatimet e hetuesve të policisë të Mbretërisë së Bahrejnit në lidhje me grabitjen në butikun 'Rolex'.

Ai ka parë filmimet CCTV që ishin marrë nga butiku 'Rolex'. Gjatë rrjedhës së hetimit, ai arriti në përfundimin se vetura që është përdorur nga grupi i njerëzve, një 'Toyota Fortuner' për t'u larguar nga skena e krimit, i kishte të vjedhura targat e regjistrimit nga një veturë tjetër. Targat e vjedhura ishin të një veture tjetër të parkuar në një qendër tjetër tregtare. Më vonë policia e ka gjetur veturën 'Toyota Fortuner' të braktisur dhe brenda saj ishte një vello dhe një sëpatë. Ai shpjegoi se vetura ishte marrë me qira tek 'Bahrain Rent a Car', dhe se marrëveshja e qirasë ishte bërë me një person të quajtur A.S.. Dëshmitari deklaroi se ky person kishte përdorur letërnjoftim grek për marrjen me qira të veturës dhe se pasaporta e përdorur nga ky person i quajtur A.S. ishte e falsifikuar dhe se të dyja, pasaporta dhe vula e hyrjes ishin falsifikuar. Kjo është demonstruar nga Mbretëria e Bahrejnit se një pjesë e vulës ishte e pasaktë pasi ajo nuk ishte shkruar në gjuhën arabe.

Më tej, dëshmitari deklaroi se kur policia kishte kontrolluar Sistemin e Menaxhimit të Kufirit (SMK), kishte konstatuar se personi A.S. nuk kishte hyrë asnjëherë në Mbretërinë e Bahrejnit. Pastaj policia kishte filluar të shikonte filmimet CCTV të Aeroportit Ndërkombëtar të Bahrejnit me qëllim që të kontrollonte fytyrat e

njerëzve që dilnin nga aeroporti në ditët menjëherë pas grabitjes dhe konstatuan një përputhje; ata gjetën një fytyrë të ngjashme me atë të A.S.. Burri që përputhej me fotografinë ishte P.F. i cili ishte larguar nga Aeroporti Ndërkombëtar në mëngjesin e nesërm pas grabitjes së qendrës tregtare.

Dëshmitari shpjegoi se policia kishte zbuluar se P.F., sipas filmimeve CCTV, kishte arritur në aeroport me veturë 'Toyota Corolla'. Përmes shoferit të kësaj veture, policia kishte arritur të vërtetonte se P.F. kishte qëndruar në "Safir Hotel" në qytetin M., së bashku me një person tjetër, A.D. Policia kishte kontrolluar se si ata kishin ardhur në Bahrejn dhe në hotel dhe me anë të kësaj ishte vërtetuar se rezervimet ishin bërë në nga kompani në Bahrejn e quajtur "xxx". Më pas, duke kontaktuar këtë kompani, policia e Bahrejnit ka vërtetuar se kishin ardhur gjashtë persona në Mbretërinë e Bahrejnit me anë të të njëjtit rezervim të bërë nga një kompani në Prishtinë; Agjencia e Udhëtimit 'Xxxx' dhe Agjencia e Udhëtimit 'Vita'.

Më tej, dëshmitari deklaroi se policia ka konstatuar gjashtë rezervime në gjashtë emra të ndryshëm; E.G., A.S. (D. D.), G.A., E. G., P.F. dhe A.D. dhe se këta persona kanë qëndruar në hotele të ndryshme në qytetin M., Bahrejn. Dëshmitari deklaroi se përmes Agjencisë së Udhëtimit "xxx" hetimi ka arritur në përfundimin se janë bërë tre udhëtime; udhëtimi i parë për në Mbretërinë e Bahrejnit është bërë nga A.S., P.F. dhe A.D. ndërmjet 6-12 korrikut 2013, udhëtimi i dytë është bërë nga personat e lartpërmendur përfshirë G.A. ndërmjet 29 korrikut – 5 gushtit 2013, ndërsa udhëtimi i fundit për në Mbretërinë e Bahrejnit është bërë më 5 shtator 2013, ku kanë marrë pjesë të gjithë të pandehurit.

Më tej, dëshmitari deklaroi se policia ka vërtetuar përmes filmimeve CCTV, se të pandehurit kanë qëndruar në hotele të ndryshme para se të ndodhte grabitja; P.F. dhe A.D. kanë qëndruar tek hoteli 'H. V.', ndërsa A.S. (D. D.) dhe G.A. kanë qëndruar tek hoteli 'A. S.' dhe E.G. dhe R.A. kanë qëndruar tek hoteli 'P. I'. Të gjitha këto hotele gjenden rreth 15-20 minuta larg Qendrës Tregtare të Qytetit në qytetin M.. Më tej, dëshmitari deklaroi se tre ose katër orë para grabitjes, personat e ndryshëm janë larguar nga hotelet përkatëse; P.F. dhe A.D. janë larguar nga 'Holiday Villa', A.S. (D. D.) është larguar nga hoteli 'Al Safir' dhe E.G. dhe R.A. janë larguar nga hoteli 'Pars International' dhe kjo mund të shihet në filmimet CCTV. Në lidhje me këtë, dëshmitari deklaroi se mund të shihet gjithashtu në

filmimet CCTV, se ata mbanin disa çanta dhe qese plastike kur janë larguar nga hotelet. Dëshmitari deklaroi gjithashtu se pas grabitjes, kryesit janë kthyer në kohë të ndryshme në hotelet përkatëse, gjë e cila mund të shihet në filmimet CCTV.

Më tej, dëshmitari deklaroi se hetimi i policisë ka treguar se R.A. ka marrë gjithashtu me qira një veturë ‘Mitsubishi Gallant’ tek ”Oscar Rent a Car” më 5 shtator 2013. Më vonë, policia gjeti veturën e braktisur dhe ka sekuestruar një patentë shoferi në veturë në emër R.A. Vetura e braktisur ‘Toyota Fortuner’ është zbuluar nga policia në Bahrejn dhe brenda është gjetur një vello dhe një sëpatë.

Dëshmitari deklaroi gjithashtu se në bashkëpunim me policinë e Kosovës është vërtetuar se personi “D. D.” është A.S..

Dëshmitari shpjegoi gjithashtu rezultatin e hetimit në lidhje me personin E.G., i cili ka përdorur pasaportë amerikane. Në këtë kohë ai ka qenë tashmë në Bahrejn dhe policia ka lëshuar urdhër arresti ndaj tij, kjo sipas dëshmitarit.

Dëshmitari deklaroi se kontaktet që ka pasur policia e Bahrejnit me ‘Turkish Airlines’ rezultuan në atë se E. G. mund të arrestohej dhe se E. G. kishte pranuar gjithçka kur ishte marrë në pyetje nga policia. Kur u pyet, ky dëshmitar deklaroi se E. G. i kishte treguar policisë se si orët e vjedhura të dorës gjendeshin në banesën e marrë me qira, se A.S. (D.D.) kishte marrë me qira banesën tek ‘Delmon Plaza’, dhe se si E. G. ia kishte dorëzuar orët e dorës një personi tjetër, një të punësuar turk, I.E.-s. Dëshmitari tregoi se si 63 orët e dorës ‘Rolex’ ishin gjetur nga policia në dhomën e hotelit të këtij të fundit. Në këtë aspekt, dëshmitari shpjegoi se hapi tjetër hetues ishte arrestimi i I.E.-s. I.E. kishte pranuar dhe kishte thënë; *“Ai kishte marrë udhëzime nga një person nga Kosova që të merrte orët e dorës nga Bahrejni dhe t’ia dorëzonte një personi në ose nga Kosova”*.

Pastaj dëshmitari shpjegoi një pjesë të filmimit CCTV nga hoteli ku mund të shihet se A.S. kishte veshur të njëjtat pantallona të shkurtra para grabitjes dhe kur ishte kthyer në këtë hotel.

Kur u pyet për njollat e gjakut që ishin marrë nga skena e krimit, dëshmitari deklaroi se mjekësia ligjore u mor me këtë.

Dëshmitari Z. G.A.A.E.A.S e pa filmimin CCTV dhe komentoi si vijon: *‘Në orën 06:53 pas dite, P.F. dhe A.D. largohen nga hoteli para grabitjes. E.G. dhe E. G.*

po largohen. G.A. po arrin në hotel. Në orën 20:13 Gentiani dhe E.G. të shoqëruar nga R.A. në orën 20:35 u larguan nga hoteli. Në filmimin CCTV mund të shihet gjithashtu vetura e përdorur në skenën e krimit”. Më tej, në filmimin CCTV, sipas dëshmitarit, mund të vërehet se si P.F. dhe A.D. po vijnë në hotel me taksì në orën 12:27 pas mesnate, po ashtu të dy ata mund të shihen në ashensorin e hotelit, pastaj dëshmitari vazhdoi të thoshte “tani shikojmë A.S. dhe G.A. dhe shikojmë se D.D. e ka ndërruar bluzën me mëngë të shkurtra, bluzën me mëngë të shkurtra që kishte veshur kur ka kryer krimin e ka në duart e tij, ajo që ka veshur tani është e E.G.”. Dhe së fundi E.G. dhe R.A. po kthehen tek hoteli i tyre.

Më tej, për filmimin CCTV dëshmitari përshkruan; ‘P.F. dhe A.D. në orën 01:11 po largohen për në aeroportin e Bahrejnit (menjëherë pas grabitjes), se A.S. dhe G.A. po çregjistrohen nga hoteli me qëllim që të shkojnë në aeroport në orën 12:20 dhe se fundi E.G. dhe R.A. po çregjistrohen për të shkuar në aeroport në orën 03:04’.

Dëshmitari komentoi filmimet nga aeroporti dhe deklaroi se ashtu si shihet - “i pari D. dhe G.A. u larguan me ‘Turkish airlines’. Tani shikojmë P.F. dhe A.D.: ata me këmisha të bardha, dhe E. G. dhe R.A.; ata u larguan me ‘Etihad airlines’. Dëshmitari komenton për shtojcën 25, ku mund të shihet se E.G. u largua dhe u kthye në hotel me të njëjtën çantë dhe se ai kishte veshur të njëjtat këpucë.

Dëshmitari i fundit që u dëgjua gjatë mundësisë hetuese të veçantë ishte dëshmitari **J.V.S.**, punonjës ekzekutiv i shitjeve tek ‘Oscar Rent a Car’ në Bahrejn i cili dha dëshmi më 3 korrik 2014. Ky dëshmitar ka deklaruar së më 5 shtator 2013, R.A. ka marrë me qira një veturë ‘Mitsubishi Gallant’.

Trupi gjykues i lejoi të shikojë një foto-reshtim të të pandehurve dhe ky dëshmitar e identifikoi pozitivisht R.A., si edhe e theksoi E.G.⁴³ si një nga personat që ka qenë së bashku me R.A. tek ‘Oscar Rent a Car’.

Ky dëshmitar deklaroi se vetura nuk i është kthyer kompanisë së tyre dhe se ata mësuan nga policia se vetura ishte braktisur, çelësi mungonte dhe kishte një gërvishtje. Më tej, fakti se R.A. kishte marrë me qira veturën nuk u kontestua nga mbrojtja.

⁴³ Dëshmitari e tregoi gabimisht H.G. si personi i cili kishte qenë së bashku me R.A..

b) Përmbledhje e dëshmimeve të dëshmitarëve gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Rreshteri i Policisë së Kosovës, **R.B.** dha dëshmi më 24 nëntor 2014 para trupit gjykues. Dëshmitari deklaroi se Policia e Kosovës kishte filluar hetimin dhe kishte marrë gjithashtu disa masa hetimi të tilla si masat e fshehta dhe kontrollin e shtëpive. Kur u pyet nga prokurori, dëshmitari deklaroi se është bërë një kontroll shtëpie në vitin 2007 në shtëpinë e Sh.G. dhe ishte gjetur municion dhe konfirmoi se policia kishte bërë kontrollin e komplet rezidencës dhe se i gjithë municioni ishte larguar nga e gjithë rezidenca në atë kohë. Dëshmitari konfirmoi se kontrolli i objekteve të H.G., A. S., dhe Agjencisë së Udhëtimit “Xxxx Travel” janë bërë pas urdhrorit të gjyqtarit të procedurës paraprake. Kur u pyet për hollësitë, dëshmitari preferoi më mirë t’u referohej raporteve⁴⁴ përkatëse pasi ato përmbanin informacionin më të saktë. Më tej, dëshmitari konfirmoi se kishte pasur një bisedë, përmes telefonit, me E. G. dhe nuk donte të shtonte as ndryshonte asgjë nga ajo që ishte shkruar në raportin⁴⁵ që dëshmitari i kishte paraqitur prokurorit.

Zyrtari i Policisë së Kosovës, **N.G.**, dha dëshmi para trupit gjykues më 24 Nëntor 2014. Ai deklaroi se kishte marrë pjesë në kontrollin e shtëpisë të H.G. më 8 tetor 2013. Ai tha se shtëpia në të cilën banonte H.G. përbehej nga disa kate dhe se H.G. banonte në një kat. Ai kishte konfiskuar municion të kalibrave të ndryshëm në një dhomë gjumi brenda në gardërobe.

Dëshmitari deklaroi se atij i ishte thënë nga personat e pranishëm në kontroll se në cilën pjesë të shtëpisë banonte H.G.. Dëshmitari ka deklaruar se policia ishte e bindur se cili kat i takonte H.G. dhe ku banonte ai. Policia kontrolloi të gjithë katin. Kati përbëhej nga dy dhoma gjumi, një dhomë ndenje, një kuzhinë dhe një korridor dhe se ka pasur qasje të lirë për të gjitha dhomat e katit për gjithsecilin.

Dëshmitari deklaroi se atij i ishte thënë nga anëtarët e familjes se dhoma në të cilën u gjet municioni i takonte babait të H.G.. Kur u pyet nga trupi gjykues, dëshmitari deklaroi se H.G., gjithë kohën, e shoqëroi policinë gjatë kryerjes së kontrollit dhe kur po kontrollohej dhoma e veçantë, H.G. nuk tha se kujt i takonte

⁴⁴ Datë 8, 12 tetor dhe 16 nëntor 2013.

⁴⁵ 2 tetor 2013.

kjo dhomë, por vetëm kur u gjet municioni H.G. mohoi të kishte lidhje me municionin.

Zyrtari i Policisë së Kosovës, **M. A.**, u dëgjua gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 24 nëntor 2014. Ai deklaroi se kishte marrë pjesë në kontrollin e shtëpisë të A.S. më 8 tetor 2013 së bashku me kolegët e tij dhe se i pranishëm kishte qenë prokurori, bashkëshortja dhe fëmijët e A.S. dhe avokati i tij mbrojtës, A.H..

Kur u pyet për artikujt e konfiskuara, dëshmitari preferoi t'i referohej raportit pasi ai përmbante informacionin më të saktë dhe konfirmoi se ai e kishte hartuar raportin-listën e artikujve që ishin konfiskuar. Në një çast, prokurori i tregoi dëshmitarit një palë pantallona të shkurtra, dhe pasi kontrolloi procesverbalin e kontrollit, dëshmitari konfirmoi se pantallonat e shkurtra ishin marrë gjatë kontrollit të dytë tek banesa e A.S. – në dhomën e tij të gjumit. Më tej, dëshmitari shpjegoi se kontrolli i dytë është kryer më 16 nëntor 2013 mbi bazën e disa fotografive të ofruara nga prokurori; pra policia po kërkonte disa artikuj të veçantë të tilla si veshje, pantallona, disa atlete dhe gjithçka tjetër që ngjasonte me artikujt e fotografive.

Kur u pyet nga trupi gjykues, dëshmitari shpjegoi se roli i tij gjatë kontrollit të dytë ka qenë të ndihmonte kolegët e tij në identifikimin e artikujve që u ngjanin artikujve në fotografi; megjithatë R.B., si udhëheqës i rastit, ishte ai që vendoste nëse një artikulli veçantë i ngjante artikujve në fotografi.

Më 10 dhjetor 2014 **I.E.** dha dëshmi përmes video lidhjes nga Bahrejni. Kur u pyet, ai deklaroi se ishte dënuar nga autoritetet e Bahrejnit për fshehjen e orëve të dorës nga grabitja në Qendrën Tregtare të Qytetit në M., Mbretëria e Bahrejnit më 10 shtator 2013. Në lidhje me këtë rast, ai deklaroi se kishte mbërritur në Mbretërinë e Bahrejnit më 28 shtator 2013, dhe kishte qëndruar në hotel 'Ramadan Palace'. Ai deklaroi se më 1 tetor 2013, E. G. kishte shkuar në dhomën e tij në hotel dhe kishte sjellë orët e dorës, megjithatë ai nuk kishte sjellë dokumentet me qëllim që orët e dorës të dërgoheshin jashtë shtetit. Ai konfirmoi se ishin 63 orë dore 'Rolex' dhe orë të tjera. Më tej, dëshmitari I.E. deklaroi se atij i ishte kërkuar nga E. G. që t'i mbante orët pasi ai do t'i sillte dokumentet më vonë, megjithatë, E. G. u arrestua para se ai të vinte me dokumentet. Dëshmitari I.E. deklaroi gjithashtu

se ai ishte arrestuar në të njëjtën ditë dhe orët mbetën në dhomën e hotelit dhe u konfiskuan nga policia.

Dëshmitari **M. S.**, dha dëshmi më 11 dhjetor 2014. Dëshmitari deklaroi se punonte si koordinator i klientëve tek ‘Bahrain Car Hiring’, në Bahrejn. Ai deklaroi se ishte lëshuar me qira një ‘Toyota Fortuner’ nga ‘Bahrain Car Hiring’ në datën 8 shtator 2013. Dëshmitari iu referua marrëveshjes⁴⁶ së qirasë ndërsa ai personalisht nuk ishte marrë me marrëveshjen e qirasë për këtë veturë. Megjithatë, dëshmitari konfirmoi se ‘Toyota Fortuner’, e cila iu tregua në fotografi nga prokurori, i takonte flotës së veturave për qiradhënie.

Zyrtari i Policisë së Kosovës, **A. M.**, dha dëshmi më 16 dhjetor 2014. Ai deklaroi se së bashku me zyrtarë të tjerë policorë kishin kryer kontroll në Agjencinë e Udhëtimit ‘Xxxx’ në Prishtinë, Kosovë. Ky dëshmitar kishte një kujtesë të paqartë rreth kontrollit, megjithatë ai iu referua raportit⁴⁷ të policisë i cili ishte përpiluar gjatë kontrollit dhe ishte nënshkruar si duhej nga zyrtarët policorë sipas zinxhirit komandues. Në këtë aspekt, ai deklaroi se raporti përmban informacion të vërtetë. Dëshmitari deklaroi se me sa mbante mend ai, emrat e personave të dyshuar përputheshin me emrat e personave që kishin udhëtuar jashtë shtetit.

Në të njëjtën ditë, më 16 dhjetor 2014, zyrtari policor **Xh. M.** dha dëshmi para trupit gjykues. Dëshmitari përshkroi se kishte marrë pjesë në kontrollin e shtëpisë të A.S.t në Prishtinë, Kosovë, në të cilin ishin konfiskuar një palë pantallona të shkurtra. Dëshmitari deklaroi se në bazë të informacionit që kishte ai dhe kolegët e tij, kishte ndodhur një grabitje e rëndë dhe i ishte treguar një fotografi në të cilën ishte një person i veshur me pantallona të shkurtra kur kishte ndodhur grabitja dhe zyrtarët policorë në Prishtinë, Kosovë po kërkonin për një palë pantallona të shkurtra të ngjashme. Dëshmitari deklaroi se ai dhe koleget e tij kishin gjetur në rezidencën e A.S.t një palë pantallona të shkurtra të ngjashme si ato që tregoheshin në fotografi. Dëshmitari deklaroi se ai kishte nënshkruar raportin për konfiskimin e pantallonave të shkurtra.

⁴⁶ Lidhja Materiali Hetimor, Bahrejn, volumni 3, tabela 30

⁴⁷ Raport i Policisë datë 9 tetor 2013.

Oficeri i policisë, **Sh. A.**, i policisë së Kosovës, dha dëshmi të njëjtën ditë me datë 16 dhjetor 2014. Dëshmitari deklaroi se ai dhe kolegët e tij kryen bastisjen në shtëpinë e H.G. në Prishtinë. Ai deklaroi se ata gjetën municion në apartamentin/shtëpinë e H.G.. Dëshmitari po ashtu deklaroi se H.G. iu tregoi atyre se ku jetonte ai pasi që ata e kishin pyetur atë. Ai më tej deklaroi se oficerët e policisë gjetën një sasi të konsiderueshme municioni. Më pas dëshmitari iu përgjigj pyetjes së prokurorit se H.G. nuk pati asnjë reagim me rastin e gjetjes së municionit. Prokurori e pyeti dëshmitarin në rast se pati ndonjë keqardhje në çfarëdo momenti apo pronësi të tjetër kujt lidhur me municionin dhe dëshmitari u përgjigj *”Jo, asgjë nuk u përmend aty.”* Dëshmitari në fund deklaroi se gjatë bastisjes e pranishme ishte nëna e H.G. dhe se ajo nuk tha asgjë lidhur me pronësinë e municionit; ajo nuk tha që municioni ishte i babës së H.G.. Avokati mbrojtës i H.G., Z. Z.P., e pyeti dëshmitarin se si ai besoi që municioni ishte i H.G., pas së cilës pyetje dëshmitari u përgjigj se municioni u gjet në apartamentin e H.G.

Dëshmitari **Z. B. H.**, argjendar në dyqanin ‘xxxx’ në Prishtinë, Kosovë, dha dëshmi me datë 14, 27 dhe 28 janar 2015. Ai konfirmoi se A.S. përpara vinte tek dyqani i tij gjithë të tjerët. Njëra vizitë ndodhi diku rreth datës 24 shtator 2013⁴⁸ dhe ajo vizitë u bë nga A.S. i cili ishte me dy persona të tjerë të panjohur për te. Dëshmitari deklaroi se ai kishte parë A.S. kishte të vënë në këtë vizitë orë dore dhe se dëshmitari e kishte parë gjysmën e orës. Prokurori e konfrontoi dëshmitarin me deklaratën e tij të mëhershme në procedurën paraprake të datës 24 tetor 2013⁴⁹, Vëllimi 1, faqe 73 si dhe dokumentet e Interpol-it faqe 16. Dëshmitari pasi që u morr në pyetje nga prokurori ku iu tha se, a e kishte vënë personi (duke iu referuar A.S.t), shënim nga gjykata) orën e 3^{të} nga e majta, orën Rolex. Dëshmitari po ashtu tha se ai i kishte thënë A.S.t se ai nuk ishte i interesuar për atë orë edhe pse atij nuk ia kishte ofruar orën. Dëshmitarit iu bë përkujtua se në deklaratën e tij të mëhershme ai deklaroi se kishte gur rreth orës. Më tej, dëshmitarit iu bë me dije se në deklaratën e tij të më hershme kur iu kishin treguar atij fotot, dëshmitari ka deklaruar *‘është e mundur dhe po më përngjan me atë që ia pashë atij në dorë’*, dhe përgjigjja e tij ishte *‘po, është e mundur’*.

⁴⁸ Dëshmitari konfirmoi këtë pasi që prokurori ia rikujtoi atij.

⁴⁹ Deponimi i të pandehurve dhe dëshmitarëve në procedurën paraprake - Dosja e Prokurorisë.

Dëshmitari **Sh.G.**, babai i H.G. dha deklaratë me datë 28 janar 2015. Ai deklaroi se në vitin 2007, Policia e Kosovës në Prishtinë kreu bastisje në shtëpinë e tij dhe konfiskoi një sasi të madhe municioni dhe se sipas tij ato kishin ngelur lufta e vitit 1999 në Kosovë. Ai deklaroi se municioni mbeti në shtëpi pas bastisjes së shtëpisë së vitit 2007. Ai deklaroi se ai vuajti dënim në burg dhe se kur doli ai i vendosi disa nga plumbat në dollap në shtëpi. Dëshmitari po ashtu më vonë në deklaratën e tij tha se gjatë bastisjes së vitit 2007 policia morën çdo gjë që gjeten dhe për këtë arsye ai u dënua me burg. Ai po ashtu deklaroi se ai ishte në burg kur ndodhi bastisja e shtëpisë në vitin 2013. Dëshmitari deklaroi se nuk fjeti dhe as përdori dhomën e fjetjes ku u gjet municion gjatë bastisjes së shtëpisë së vitit 2013. Ai flinte me të ëmën në dhomë të ndejës. Ai më pas deklaroi se dhoma përdorej vetëm për gjësende si një dhomë depo.

Me datë 29 janar 2015 për të vazhduar me datën 3 shkurt 2015 dëshmitari **A. B.**, menaxher i shitjes në Agjencinë për Udhëtime Xxxx në Prishtinë, Kosovë, dha dëshmi para trupit gjykues. Dëshmitari konfirmoi se policia bastisi Kompaninë dhe se ai ishte po ashtu i pranishëm gjatë bastisjes. Ajo bastisje lidhej me disa udhëtar të cilët udhëtuan në Lindjen e Mesme, dhe dëshmitari përmendi Bahrejnin. Kur u pyet, dëshmitari konfirmoi se ka ndodhur që grup njerëzish të udhëtonin në Bahrejn, dhe vazhdoj se të thoshte se kjo do ishte normale. Në atë moment prokurori ia përkujtoi sepse në dëshminë e procedurës paraprake të datës 18 nëntor 2013 dëshmitari kishte deklaruar se kjo ishte e rrallë. Dëshmitarit iu tregua Fatura nr. 22191⁵⁰ e datës 17 janar 2013, dhe edhe pse nuk i kujtohej përmendsh, ai e vërtetoi se ishte faturë e lëshuar nga ‘xxxxxWLL’- një kompani me të cilën bashkëpunon ‘Xxxx Travel. Fatura tregon emrat e Xh. Xh., R.A., B. B. dhe A. G. Kur u pyet, dëshmitari nuk ishte në gjendje të mbante mend emrat e të pandehurve të cilët bënë aranzhime me Agjencinë Turistike Xxxx.

Më tej, dëshmitarit iu paraqit një dokument dhe ai e konfirmoi se ishte pagesa e kryer nga Agjencia Turistike Xxxx për te ‘Xxxx’ për faturën 22193⁵¹, dhe shuma prej 1576 Eurosh ishte çmimi total i faturës.

Më pas dëshmitari u pyet për sqarimin e procedurës për aranzhimin e udhëtimeve për në Bahrejn si dhe mendimi i tij i kërkuar lidhur me dokumentet – një Faturë nr.

⁵⁰ Faqe 77 – Dosja Policore Vëllimi 4 Dokumentet nga kontrolli i ‘Xxxx’.

⁵¹ Faqe 62- Dosja Policore, Vëllimi 4 Dokumentet nga kontrolli i ‘Xxxx’.

22193⁵², e datës 29 gusht 2013 në shumë prej 2.693US\$. Dëshmitari sqaroi se kjo është shuma totale e udhëtimit pa biletë të fluturimit. Përpos kësaj dëshmitarit iu tregua një dokument, dhe ai e konfirmoi se ishte transferim bankar për faturën 22193⁵³, kërkimin e vizave për Xh. Xh., G.A., A.D., P.F., R.A. dhe E.G. Më pas, dëshmitarit iu treguan dokumente dhe ai e konfirmoi se ato ishin dëftesat për të hyrë në hotel⁵⁴.

Dëshmitarit po ashtu iu treguan një varg e-mail-ash⁵⁵ të dërguara nga ‘Xxxx’ ku kërkonin sqarime lidhur me individët⁵⁶ që udhëtuan në Bahrejn me datë 6 dhe 22 korrik dhe me 5 shtator 2013, si dhe parashtrim pyetjesh të caktuara. Lidhur me këtë kur u pyet nga prokurori, dëshmitari deklaroi se kjo nuk është e zakonshme për një partner të huaj që të parashtrij këto pyetje duke e nënvizuar se ishte i befasuar.

Dëshmitari po ashtu iu përgjigj pyetjeve të mbrojtës, dhe konfirmoi se asnjëherë nuk kishte marrë ndonjë premtim nga ndonjë person i pasur apo ndonjë politikan se ata do të mbulonin shpenzimet e udhëtimeve në Bahrejn. Se ai nuk i kishte bërë ndonjë të mirë këtij grupi për të ua mundësuar udhëtimet në Bahrejn. Dhe se Agjencia Turistike Xxxx organizonte udhëtime individuale si dhe udhëtime grupore.

KONSIDERATA NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E PROVAVE

I. Barra dhe standardi i provës.

Gjatë mbajtjes së gjykimit, parimi i prezumimit të pafajësisë është nënkuptuar se barra e provës për çfarëdo akuzë penale i takon prokurorisë (Telfner kundër Austrisë, 2001, KEDNJ 228, paragrafi 15 dhe Barbera, Messagué dhe Jabardo kundër Spanjës, 1998, KEDNJ 25, paragrafi 77). I takon prokurorisë të sjellë prova të mjaftueshme për të dënuar të pandehurit. Faji i të pandehurit nuk mund të prezumohet derisa të provohet akuza përtej dyshimit të arsyeshëm (OKB, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, CCPR Koment i Përgjithshëm 32, 2007,

⁵² Faqe 240- Dosja Policore Vëllimi 4 Dokumentet nga kontrolli i ‘Xxxx.

⁵³ Faqe 76- Dosja Policore Vëllimi 4 Dokumentet nga kontrolli i ‘Xxxx.

⁵⁴ Faqe 115, 117, 119 - Dosja Policore Vëllimi Vol 4 Dokumentet nga kontrolli i ‘Xxxx.

⁵⁵ Faqe 91-93- Dosja Policore Vëllimi 4 Dokumentet nga kontrolli i ‘Xxxx.

⁵⁶ D. D. (A. S.), A.D., P.F., G.A., R.A. dhe E.G..

paragrafi 30 dhe Sobhraj kundër Nepali, Komunikim i KDNJ-së 1870/2009, Dok i OKB-së CCPR/C/99/D/1870/2009 (2010), paragrafi 7.3). Në përfundim të rastit, i pandehuri ka të drejtën të përfitojë nga dyshimi nëse vepra penale është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Provat që paraqit mbrojtja duhet të jenë e mjaftueshme për të treguar dyshimin e arsyeshëm.

Neni 6 (2) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tej “KEDNJ”), Kushtetuta e Kosovës dhe neni 3 (1) i KPPRK-së e ruajnë prezumimin e pafajësisë për të cilën i pandehuri ka të drejtë. Ky prezumim i jep Prokurorisë barrën e vërtetimit të fajësisë të të pandehurit, barrë e cila i mbetet prokurorisë gjatë gjithë gjykimit.

Neni 370 (7) i KPPRK-së përcakton se ‘*gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara*’. Rrjedhimisht, Trupi gjykues duhet të vendosë nëse është përmbushur, në bazë të të gjitha provave dhe nëse është i sigurt, se është vërtetuar çdo element i krimit. Çfarëdo dyshimi zgjidhet në favor të të pandehurit.

Trupi Gjykues, në pajtim me nenin 7 (1), (2) të KPPRK-së, ‘*...detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm*’ dhe ‘*...detyrohet që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojë faktet kundër të pandehurit si dhe ato .. në favor të tij ...*’.

Vlerësimi i provave

Gjykata ka marrë prova të drejtpërdrejta dhe rrethore, dëshmi të grumbulluara nga bastisjet, prova të dokumentuara, transkriptime të përgjimeve, prova të paraqitura përmes mundësisë hetuese të veçantë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes video lidhjes në bashkëpunim me autoritet gjyqësore të Mbretërisë së Bahrejnit. Prokuroria ka paraqitur gjithashtu prova të mbledhura nga policia e Mbretërisë së Bahrejnit si dëshmitarët, dokumentacion dhe regjistrime të CCTV. Këto prova, në përputhje me nenin 43 të Ligjit për Bashkëpunimin Juridik

Ndërkombëtar për Çështjet Penale⁵⁷ janë transferuar nga Mbretëria e Bahrejnit në Republikën e Kosovës

Gjykata ka vlerësuar të gjitha provat e sjella në gjykim në kuptimin e tërësisë së dokumentacionit gjyqësor dhe në përputhje me KPPRK-në. Provat janë administruar në atë mënyrë që t'i shërbejnë me mirë vendosjes së drejtë të rastit dhe në pajtueshmëri me praktikën e sistemit juridik të Kosovës dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës, përfshirë parimin e *in dubio pro reo*.

Ashtu si është përmendur, të pandehurit prezumohen të pafajshëm derisa të provohet fajësia. Prokuroria bart tërësisht barrën e vërtetimit të secilit element të krimit dhe të mënyrës së përgjegjësisë ndaj secilit prej të pandehurve, si edhe ndaj çdo fakti që është i domosdoshëm për dënimin përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata ka përcaktuar nëse pesha maksimale e provave të pranuar është e mjaftueshme për të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm elementet e krimit të akuzuar në aktakuzë, dhe së fundi përgjegjësinë për secilin të pandehur.

Në vlerësimin *viva voce* Gjykata ka marrë në konsideratë sjelljen dhe karakterin e dëshmitarit.

Provat rrethimore mund të jenë të nevojshme për të vërtetuar një fakt të pretenduar. Gjërat individuale të provave rrethimore, në vetvete, mund të jenë të pamjaftueshme për të vërtetuar një fakt, por efekti i tyre grumbullues apo së bashku me provat e tjera, mund të kenë rol vendimtar.

Sa iu përket të gjithë dëshmitarëve, përfshirë këtu edhe dëshmitarët e paraqitur nga mbrojtja e H.G., Gjykata ka vlerësuar mundësin si dhe përputhshmërinë e provave të tyre si edhe rrethanat e rastit dhe vërtetimin me prova të tjera.

Në disa raste, vetëm një dëshmitar ka dhënë dëshmi për një ngjarje të caktuar. Edhe pse, sipas mendimit të Gjykatës, dëshmia e një dëshmitari të vetëm për një fakt material, si çështje e së drejtës, nuk kërkon vërtetim; megjithatë, në situatë të tillë, Gjykata ka shqyrtuar me kujdes provat para se të mbështetej në ato në masë vendimtare.

Aty ku vërtetësia e provave mjeko-ligjore u kundërshtua, Gjykata mori në konsideratë faktorë të ndryshëm në vlerësimin e tyre, përfshirë provat që lidheshin me burimin e tyre, zinxhirin e ruajtjes si dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm.

⁵⁷ Ligji Nr. 04/L-031

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor janë vlerësuar nga Gjykata në përputhje me parimin e përgjithshëm të vlerësimit të provave. Gjykata ka konstatuar se provat e paraqitura nga palët kanë plotësuar standardet e kërkuara të besueshmërisë.

Neni 323 i KPPRK-së përcakton se i pandehuri nuk detyrohet që të dëshmoj. Me përjashtim të H.G.t të pandehurit ushtruan te drejtat e tyre për të heshtur. Gjykata nuk ka nxjerrë asnjë konkluzion negativ që do të ndërmerrej ndaj të pandehurve që ushtruan të drejtën e tyre për të qëndruar të heshtur.

Gjatë vlerësimit të provave, gjykata nuk ka deklaruar *ex officio* asnjë pjesë të provave si të papranueshme.

Konsiderata të veçanta për provat

Komunikimet e përgjuara:

Gjykata ka pranuar përgjime individuale dhe këto përgjime përfshihen në fashikuj – dosjet e policisë, Vëllimi 1, fashikulli III- dosjet e policisë, Vëllimi 3, fashikulli - dosjet e policisë, Vëllimi 5, fashikulli VI- dosjet e policisë, Vëllimi 6, dhe regjistrimet CCTV.

Gjykata është e kënaqur që prokurori ka demonstruar se përgjimet dhe regjistrimet CCTV kanë përmbushur kërkesat përkatëse për t'u pranuar si prova. Mbrojtja nuk i ka kundërshtuar përgjimet dhe regjistrimet CCTV si provë.

C. PËRFUNDIMI FAKTIT DHE LIGJI GJEGJËS

Në bazë të Akuzës 1 kundër A.S.; pjesëmarrje ose organizim i grupit të organizuar kriminal me qëllimin të kryerjes së një ose me shumë veprave penale, në kundërshtim me nenin 283 (1) dhe (2), të Kodit Penal të Kosovës (KPRK).

Përkufizimi ligjor /elementët e veprës penale të krimit të organizuar

Neni 283 thotë:

- (1) *Kushdo që me dashje dhe me dijeni qoftë të qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme të grupit kriminal të organizuar ose qëllimit të grupit për të kryer një apo më shumë vepra penale të cilat janë të dënueshme me burgim prej së paku katër (4) vjet, aktivisht merr pjesë në veprimtari të kriminale të grupit duke ditur se pjesëmarrja e tillë do të kontribuojë në realizimin e veprimtarive kriminale të grupit, dënohet me gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250.000) Euro dhe me burgim prej së paku shtatë (7) vjet.*
- (2) *Kushdo që organizon, themelon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton veprimtari të grupit kriminal të organizuar, dënohet me gjobë deri në pesëqind mijë (500.000) Euro dhe me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet.*

Neni 120, paragrafi 13 i KPRK-së e përcakton termin grupi i organizuar kriminal si bashkim i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë.

Përkufizimi ligjor /elementët e veprës penale të grabitjes

Neni 329 i KPRK-së thotë:

1. *Kushdo që me përdorim të forcës apo kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personit tjetër, e përvetëson pasurinë e luajtshme të personit të tillë me qëllim që t'i sjellë vetes apo personit tjetër dobi pasurore të kundërligjshme, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.*
2. *Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me sendin e vjedhur me vlerë që tejkalon pesëmijë (5.000) Euro, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej pesë (5) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.*
3. *Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit ose i cili ka me vete armën apo mjetin e rrezikshëm, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej shtatë (7) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.*

4. ...
5. ...

Lidhur me pikën 1 të akuzës neni 283, par 2 i KPRK-së - A.S.

Prokuroria pretendon se ishte i pandehuri A.S. ai që ishte udhëheqësi i grupit të organizuar kriminal dhe se ai i ka organizuar, themeluar, mbikëqyrur, menaxhuar apo drejtuar aktivitetet e grupit të organizuar kriminal - Pika 1 e akuzës, neni 283, paragrafi 2 i KPRK-së. Prokuroria parashton arsyet e mëposhtme për të mbështetur pretendimet e saja;

- i) ishte vetëm i pandehuri A.S. ai i cili ka udhëtuar në të gjitha udhëtimet për në Mbretërinë a Bahrejnit përfshirë një udhëtim në janar 2013, i cili është anuluar; dhe
- ii) përgjimet tregojnë se A.S. është pika ndërlidhëse e të gjitha bisedave mes të pandehurve; dhe
- iii) sipas deklaratës të dëshmitarit R.B. gjatë rrjedhës së bisedës që ai e zhvilloi me E.G., A.S. është identifikua si personi që ka ngarkuar E.G. për të shkuar në Mbretërinë e Bahrejnit për të marrë orët.

Mbrojtja e të pandehurit ishte se ai nuk ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, megjithatë ai nuk e ka kontestuar faktin se ka bërë udhëtimet në fjalë në Mbretërinë e Bahrejnit, pra, sipas mbrojtjes, qëllimi i udhëtimit ka qenë vetëm për turizëm, ndërsa në lidhje me udhëtimin në shtator 2013 për në Mbretërinë e Bahrejnit ai ka qenë që të respektonte besimin e tij fetar dhe të vizitonte Mbretërinë e Bahrejnit gjatë kohës së Ramazanit.

Gjetjet dhe përfundimet e Gjykatës lidhur me par. 2 të nenit 283

Gjykata i dëgjoi provat në lidhje me këtë pretendim, e gjithashtu i janë paraqitur edhe prova të përgjimit në lidhje me këtë akuzë të aktakuzës. Dëshmitari A.B., menaxher i shitjes tek Agjencia e Udhëtimit Xxxx në Prishtinë, konfirmoi në dëshminë e tij (29 janar dhe 3 shkurt 2015) se A.S. kishte udhëtuar tri herë nga Prishtina, Kosovë për në Mbretërinë e Bahrejnit mes korrikut 2015 dhe shtatorit

2015, dhe se A.S. kishte marrë gjithashtu viza për këto udhëtime. A.S. ka qenë i vetmi nga të pandehurit që ka udhëtuar tri herë në Mbretërinë e Bahrejnit.

Përgjimet⁵⁸ e marra nga Policia e Kosovës shkruajnë si më poshtë:

3.10.2013:

Biseda mes A.S. dhe G.A.:

G: a ke nevojë për diçka.

A.S.: jo në të vërtetë, kam pak nevojë për ty, pasi po kam dhimbje koke vëlla, nga të gjitha këto thashetheme. Singerisht po trishtohem, vëlla.

4.10.2013:

Biseda mes A.S. dhe G.A.:

A: mos rri bosh vëlla, sepse unë mërzitem.

7.10.2013:

Biseda mes A.S. dhe G.A.:

G.A.: asgjë ata e shtynë atë, për një javë tjetër, nuk u mbajt fare.

A.S.: e kam llogaritur nëse diçka më bie mua, atëherë ata e bëjnë spektakulare, jo/atëherë gjykimi, pasi këta persona i lidhin sendet vëlla.

Oficeri Policor R.B. ka pasur një bisedë me E.G. më 2 tetor 2013 përmes telefonit dhe ai i ka shkruar prokurorit të rastit një Raport Informues rreth përmbledhjes së bisedës⁵⁹.

Gjykata i ka analizuar me kujdes të gjitha provat e paraqitura nga prokurori në lidhje me pikën 1 të akuzës, neni 283, paragrafi 1 i KPRK-së dhe Gjykata konstaton se ka prova që sugjerojnë se A.S. ka organizuar, apo themeluar, apo mbikëqyrur, apo drejtuar aktivitetet e grupit kriminal të organizuar të përbërë nga të pandehurit A.D., P.F. dhe E. G., megjithatë, gjykata konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme, të gjitha të marra në tërësi, për të përcaktuar përtej dyshimit të

⁵⁸ Urdhëruar nga gjyqtari i procedurës paraprake me kërkesë të prokurorit

⁵⁹ Lidhje, dosje te Policisë 1, tab 15

arsyeshëm se A.S. ka organizuar, apo themeluar, apo mbikëqyrur, apo menaxhuar, apo drejtuar aktivitetet e grupit të organizuar kriminal të sipër përmendur. Përgjimet që janë siguruar dhe që janë paraqitur më sipër nuk përcaktojnë se ai ka qenë udhëheqësi i grupit të organizuar kriminal sa i takon organizimit, themelimit, mbikëqyrjes, apo drejtimit të të gjithë grupit apo anëtarëve të grupit. Përveç kësaj, fakti që i pandehuri ka udhëtuar tri herë në Mbretërinë e Bahrejnit dhe bisedat e përgjuara nuk provojnë udhëheqjen nga ai të grupit të organizuar kriminal.

Raporti Informues i oficerit policor R.B. i datës 2 tetor 2013 dhe i drejtuar prokurorit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës është pranuar si provë e rastit. R.B. është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit me datë 24 nëntor 2014 (faqe 14-15). Ai i referohet raportit dhe deklaron se nuk dëshiron të shtojë apo të heqë diçka nga ai raport. Ky raport përmban një përmbledhje të bisedës që oficeri policor Berisha ka pasur me E.G. përmes telefonit. Ku thuhet se, E.G. i ka treguar atij që ka udhëtuar disa herë në Mbretërinë e Bahrejnit me A.S. dhe me dy persona nga Shqipëria si dhe me G.A.. Ai ka deklaruar se A.S. mendohet se ka paguar banesën e marrë me qira në Mbretërinë e Bahrejnit që të shfrytëzohej nga E.G. Se dy persona nga Shqipëria, P. dhe A. i kanë dhënë atij një telefon me SIM karte të Shqipërisë dhe se ata e kanë udhëzuar E.G. se si të vepronte kur ai të kthehej në Mbretërinë e Bahrejnit. Më tej, E. G. deklaron se si ai mori në posedim 63 orët e Rolex-it dhe se si ai ia dha ato një personi tjetër, i cili po ashtu u arrestua nga Policia e Mbretërisë së Bahrejnit

Ky raport si dhe përmbajtja e tij ashti si dhe bisedat e përmendura më sipër u pranuan si prova, megjithatë, gjykata nuk është e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se A.S. është ai i cili organizoi, themeloi, mbikëqyri, menaxhoi apo drejtoi aktivitetet e grupit të organizuar kriminal në bazë të këtyre dëshmive të përmendura më sipër si dhe faktit se ai udhëtoi tri herë në Mbretërinë e Bashkuar.

Prandaj, në bazë të dëshmive të përmendura më sipër si dhe pas vlerësimit të këtyre dëshmive një nga një si dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, nuk është dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm se A.S. është fajtor ashtu siç ngarkohet sipas pikës 1 të akuzës, andaj, në përputhje me nenin 364 para 1.3 të KPPRK-së i pandehuri lirohet nga para 2 i nenit 283 të KPRK-së.

Lidhur me Akuzën 1- Neni 283, par. 1 i KPRK-së kundër A.S.t, dhe Akuzën 2 kundër R.A., G.A. dhe E.G., pjesëmarrje në ose organizimi i një grupi të organizuar kriminal me qëllimin për të kryer një ose më shumë vepra penale, në shkelje të Nenit 283 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori pretendoi se ka prova se të pandehurit i kanë kryer veprat me të cilat janë akuzuar, duke vënë në dukje se ekziston një grup i organizua kriminal me lidhje ndërkombëtare. Prokurori paraqit argumentet e mëposhtme në mbështetje të akuzave të tij:

- i. Të pandehurit udhëtuan bashkë tre herë të ndryshme për në Bahrejn gjithnjë duke banuar në tre hotele të ndryshme pa një shpjegim të arsyeshëm për këtë;
- ii. I pandehuri R.A. u identifikua nga dëshmitarët nga Kompania e dhënies së veturave me qira që u kishte dhënë veturën me qira (Mitsubishi Gallant i bardhë) të përdorur nga të pandehurit për t'u kthyer në hotelin e tyre pas kryerjes së krimit (video e Bahrejnit, filmimi i Hotelit CCTV);
- iii. Video e prodhuar nga autoritetet e Bahrejnit: ora kur të pandehurit dolën nga hotelet e tyre dhe u kthyen përputhen me orën e grabitjes;
- iv. Të pandehurit u çregjistruan dhe u larguan nga Bahrejni disa orë pas grabitjes dhe një ditë më herët, sipas rezervimeve fillestare të tyre – duke i thënë stafit të Hotelit se ata do të ktheheshin “nesër”.
- v. Në një shkop druri të gjetur nga dyqani Rolex qeliza njerëzore që i përkisnin G.A. sollën një përputhje pozitive të ADN-së - *“Gjasat që ky profil të duket në popullatë është 1 në 5.9 miliardë njerëz.”*;
- vi. Përgjimet që tregojnë interesimin e shqetësuar të të pandehurit nga lajmet për grabitjen dhe dorëza e një ore;
- vii. Pantallonat e shkurtra të përdorura nga A.S. në hotel dhe gjatë grabitjes, të sekuestruara në shtëpinë e tij;
- viii. A.S. u vërejt nga dëshmitari, një argjendar i një argjendarie në Prishtinë duke i ofruar atij një orë shumë të ngjashme me atë që ishte vjedhur;
- ix. Një shënim në dorëshkrim i sekuestruar në shtëpinë e A.S. me fjalët “4 Rolex”;
- x. Të 63 orët e dorës u lanë prapa për t'u marrë nga një amerikan kosovar (E. G.) për t'iu dorëzuar një qytetari turk (I.E.);
- xi. Lidhjet ndërkombëtare – një qytetar turk (I.E.) dhe një qytetar amerikan kosovar (E.G.) të ngarkuar me largimin e orëve të dorës pas kryerjes së krimit – është prova përfundimtare se ekziston një bashkim që nuk u formua rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një vepre, por më tepër një organizatë e strukturuar e formuar prej disa muajsh, e përbërë të paktën nga 7 persona me qëllimin për të kryer një a më shumë vepra penale me synimin për të siguruar përfitim pasuror.

Mbrojtja e të pandehurve ishte se asnjëri prej tyre nuk u përfshi në kryerjen e veprës penale me të cilën akuzohen; megjithatë, asnjëri prej tyre nuk kontestoi se i

kishte bërë udhëtimet në fjalë në Mbretërinë e Bahrejnit. Sipas mbrojtjes, qëllimi i udhëtimeve ishte për qëllimi turizmi dhe biznesi, ndërsa lidhur me udhëtimin në shtator 2013 për në Mbretërinë e Bahrejnit, mbrojtësi i A.S. theksoi se ishte për të respektuar bindjen e tij fetare dhe për të vizituar qytetin në Mbretërinë e Bahrejnit gjatë periudhës së Ramazanit.

Gjetjet dhe përfundimi i gjykatës - Neni 283, paragrafi 1 i KPRK-së lidhur A.S., R.A., G.A. dhe E.G.

Trupi Gjykses i bazoi gjetjet e tij faktike në provat e mëposhtme, të cilat u gjet se ishin plotësisht të besueshme: Raporti i ADN-së, dëshmitë e dëshmitarëve të përmbledhura më sipër, provat e siguruar nga Mbretëria e Bahrejnit – filmime CCTV dhe prova të tjera materiale të marra nga Mbretëria e Bahrejnit, përgjimi i telekomunikimeve, provat e marra përmes seancave të Mundësisë së Veçantë Hetimore dhe provat e mbledhura përmes kërkimeve.

Pasi ka shqyrtuar të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata gjeti se prokurori vërtet ofroi dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme, që provojnë se të pandehurit A.S., R.A., G.A. dhe E.G. e kanë kryer veprën penale të krimit të organizuar, në kundërshtim me nenin 283, par. 1 të KPRK-së, lidhur me Nenin 329, par. 3 të KPRK-së.

Gjykata gjeti se të pandehurit A.S., G.A., R.A. dhe E.G., së bashku me P.F. dhe A.D., E.G. dhe I.E., u morën vesh të merrnin pjesë në një grup të organizuar kriminal, me qëllimin për të kryer veprën penale të grabitjes në Mbretërinë e Bahrejnit. Fakti se organizatori dhe/ose udhëheqësi i grupit të organizuar kriminal nuk mund të zbulohet, nuk pati kurrfarë ndikimi në rezultatin e këtij procesi gjyqësor; se të pandehurit vërtet e kryen krimin e organizuar pjesërisht në Prishtinë dhe pjesërisht në Mbretërinë e Bahrejnit, ndërsa vepra penale e grabitjes u krye në Mbretërinë e Bahrejnit.

Në këtë drejtim, Gjykata konstatoi se origjina e grupit rrjedh së paku nga janari 2013, kur A.S., R.A. dhe dy persona të tjerë⁶⁰, organizuan një udhëtim në Mbretërinë e Bahrejnit, por ai u anulua. Përveç kësaj, ky organizim u konfirmua nga dëshmitari A. B. dhe në dosjen e lëndës ka prova të dokumentuara⁶¹. Më tej,

⁶⁰ B. B. dhe A. G. Sipas Faturës nr. 001338/2013, datë 21/01/2013 R.A. ishte blerësi. Dosja e Policisë, vëllimi 4, Dokumentet e Kontrollit të XXXX-s, që i administruan në seancën gjyqësore të datave 29/01/ dhe 03/02 2015 kur u dëgjua dëshmitari A. B.

⁶¹ Dosja e Policisë, vëllimi faqet 138, 177 dhe 209.

Gjykata gjeti se të pandehurit A.S., A.D., P.F., G.A., R.A. dhe E.G. bënë udhëtime në Mbretërinë e Bahrejnit. Provat e marra nga Agjencia Xxxx Travel dhe përmes Agjencisë xxxx Tours, agjenci udhëtimi në Mbretërinë e Bahrejnit, tregojnë se për këtë u bë prenotimi i fluturimeve dhe hoteleve. Të pandehurit morën viza përmes d.p.z. xxxx në Prishtinë, si garantuese kur aplikuan për viza⁶². Sipas dëshmimeve, udhëtimi i parë në Bahrejn u zhvillua në mes të datave 6-12 korrik 2013 nga A.S. (Gj. Gj.), A.D. dhe P.F.⁶³ Udhëtimi i dytë në Bahrejn ka qenë në mes të 29 korrikut dhe 5 gushtit 2013 nga A.S. (Gj. Gj.), A.D., P.F. dhe G.A., dhe fatura në shumën një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë (1756) USD u lëshua në emrin e A.D.⁶⁴ Provat shkresore zbulojnë datat e hyrjeve dhe daljeve datat të këtyre të pandehurve që përkojnë me këtë periudhë⁶⁵. Provat tregojnë se A.D. dhe P.F. qëndruan në Hotel Al Safir, kurse A.S. (Gj. Gj.) dhe G.A. qëndruan në Hotel Best Western Plus në Bahrejn. Data e çregjistrimit për të gjithë ishte 5 gusht 2013. Udhëtimi i tretë në Bahrejn ishte në mes të datave 5 dhe 12 shtator 2013 dhe të pandehurit A.S., R.A., G.A. dhe E.G. qëndruan në hotele të ndryshme mjaft të afërta me qendrën tregtare⁶⁶. Si zakonisht, vizat u siguruan përshtatshëm; viza për A.S. (Gj. Gj.) skadoi më 29 shtator 2013; viza për E.G. skadoi më 28 shtator 2013, vizat e R.A., P.F., A.D. skaduan të gjitha më 28 shtator 2013. Rezervimi i hotelit u bë më 3 shtator në hotele të ndryshme, data e regjistrimit për të gjithë të pandehurit ishte 5 shtator 2013 dhe data e çregjistrimit ishte planifikuar për 12 shtator 2013. A.S. dhe G. A. qëndruan në Hotel Al Safir, A.D. dhe P.F. qëndruan në Hotel Holiday Villa, kurse R.A. dhe E.G. qëndruan në Hotel Pars International, të gjitha në Bahrejn. Hotelet ku qëndruan të pandehurit nuk ishin më shumë se 20 minuta larg qendrës tregtare. Fatura lidhur me udhëtimin në shtator të vitit 2013, 2,634 USD, u lëshua për A.S., ndonëse ai udhëtoi nën emrin Gj. Gj.⁶⁷.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se strategjia e të pandehurve ishte së pari të vëzhgonin/monitoronin zonën. Kjo u bë duke shkuar për vizitë, më shumë se një herë, në Mbretërinë e Bahrejnit, para kryerjes së grabitjes. Hapat e parë u ndërmorën kur A.S. së bashku me A.D. dhe P.F. vizituan Mbretërinë e Bahrejnit më 6 korrik 2013, dhe më pas vijoi vizita e dytë, kur të pandehurit e lartpërmendur, së bashku me G.A., shkuan në M. në Mbretërinë e Bahrejnit më 29 korrik 2013.

⁶² Dosja e Policisë, vëllimi 4, Dokumentet e Kontrollit të Xxxx-s, që i administruan në seancën gjyqësore kur u dëgjua dëshmitari A. B.

⁶³ Dosja e Policisë, vëllimi 4, Faturat, faqet 62 dhe 321.

⁶⁴ Dosja e Policisë, vëllimi 4, Fatura, faqe 322.

⁶⁵ Dosja e Policisë, vëllimi 4, Dokumentet e Kontrollit të Xxxx-s, që i administruan në seancën gjyqësore kur u dëgjua dëshmitari A. B.

⁶⁶ Kjo konfirmohet edhe nga Hetuesi G. në deklaratën e tij më 3 korrik 2013.

⁶⁷ Dosja e Policisë, vëllimi 4, Dokumentet e Kontrollit të Xxxx-s, që i administruan në seancën gjyqësore kur u dëgjua dëshmitari A. B.

Përveç vëzhgimi të zonës, u vërtetua se të pandehurit u përgatitën që të kishin instrumentet e duhura për të kryer krimin, si dhe për t'u arratisur nga vendi i ngjarjes. Për këtë arsye, që më parë u morën me qira dy automjete: një Toyota Fortuner në “Bahraini Car Rental Company” u mor me qira nga P.F.⁶⁸ dhe një Mitsubishi Gallant me tablla xxx u mor me qira nga R.A. në “Oscar” Car Rental Company⁶⁹. Kjo u konfirmua nga deklaratat, e përmbledhura më sipër, të dëshmitarëve J.V.S. dhe M. S.

Më tej, të pandehurit u siguruan të gjenin veshje femërore – nijab, të paktën një sëpatë, një sprej dhe një karrocë fëmijësh. Mënyra se si u veshën u bë me qëllim që të mos tërhiqnin vëmendjen gjatë hyrjes në qendrën tregtare e City Center Mall në M. dhe të mos tregonin fytyrat e tyre. Ky fakt konfirmohet me deklaratën e palës së dëmtuar M. Z, kur ai theksoi se kishte parë pesë-gjashtë njerëz të veshur në abaya, megjithatë, ai kujtoi se ata po shkonin në kinema. Gjithashtu karroca e fëmijëve u mor për të lënë përshtypjen se ata janë vetëm gra të zakonshme. Sprucoja u mor në rast se do të dilte nevoja për ta përdorur dhe kjo ndodhi kur një pjesëtar i grupit spërkati fytyrën e M. Z.⁷⁰ Sëpata u përdor për të thyer dyert dhe vitrinat, që u konfirmua përmes xhirimeve CCTV nga Rolex Boutique⁷¹, si dhe deklaratat e dëshmitarëve M. Z. dhe Sh. R. B. Së fundi Toyota Fortuner parë, dhe pas kësaj Mitsubishi Gallant u përdorën për të shpëtuar nga vendi i ngjarjes. Kjo është konfirmuar nga xhirimet CCTV nga qendra tregtare City Center Mall në M., si dhe xhirimet CCTV të qytetit⁷². Të gjitha veprimet e lartpërmendura u planifikuan paraprakisht nga anëtarët e grupit, dhe ky model i organizimit dhe ndarjes së detyrave përcakton se të pandehurit i kryen veprat penale me paramendim, dhe se qëllimi i tyre ishte të vidhnin dyqanin e orëve të dorës Rolex Boutique në qendrën tregtare City Center M., pavarësisht nga rreziku i mundshëm po të arrestoheshin atje. Për më tepër, bisedat e përgjuara, siç detajohet më poshtë, tregojnë se të pandehurit kontaktonin me njëri-tjetrin pasi u kthyen në Kosovë.

Për këtë arsye, trupi gjykues konkludon se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet e grupit të organizuar kriminal që janë përcaktuar në nenin 120 të KPRK-së. Të pandehurit vepruan si një grup i strukturuar, ata morën pjesë të gjithë

⁶⁸ Lidhja Materiali Hetimor Bahrejn, vëllimi 3, tabela 13, faqe 109; Lidhja I, Dosja e Policisë, vëllimi 1, tabela 8, faqet 69-79.

⁶⁹ Lidhja Materiali Hetimor Bahrejn, vëllimi 2, tabela 9, faqe 201.

⁷⁰ Materiali i Hetimit në Bahrejn, Vëll. 3, tabela 3, Raporti Mjekësor i M. Z, dhe Tabela 11 që konfirmon se ai u bë objekt i spërkatjes në sy me sprej në ditën kritike.

⁷¹ Luajtur gjatë seancave SIO më 2 dhe 3 korrik 2014.

⁷² Siç u shpjegua nga polici G.A. A. A.

në mënyrë aktive në arritjen e qëllimit të grupit, grupi ekzistoi për një periudhë së paku nga janari 2013 deri në tetor 2013, grupi përmbante më shumë se tre persona⁷³, dhe qëllimi i tyre ishte qartazi financiar ose ndonjë përfitim tjetër material për ta. Duke pasur parasysh markën e orëve të vjedhura⁷⁴, si dhe çmimet e larta të saj në treg⁷⁵, elementi i përfitimit material (shuma e përmendur më poshtë), është i qartë.

Kryerja e grabitjes, si vepër penale e bazë, nga anëtarët e grupit të organizuar kriminal

Sipas një plani të rënë dakord nga të gjithë, më 10 shtator 2013, rreth orës 23:00, A.S., G.A., E.G., R.A., P.F. dhe A.D., të maskuar në veshje femërore islame, me trupat dhe fytyrat e tyre të mbuluara, shkuan në Butikun e Orëve Rolex në qendrën tregtrare të City Centre, M., qytet i Bahrejnit. Ata vozitën një Toyota Fortuna të bardhë, hynë në parkingun e Qendrës Tregtare City Centre në Bahrejn⁷⁶. Pastaj ata hynë të gjithë përmes Portës 5, iu afruan Rolex Boutique dhe sulmuan rojën e sigurisë, M.Z., ku një anëtar i grupit i spërkati sprej piperi në sytë e tij, dhe një anëtar i grupit e goditur atë me një shkop druri në të pasmes (siç u detajua më sipër).

Pasi neutralizoi rojën e sigurisë, grupi i cili përfshinte këta të pandehur theu dritaren dhe derën prej qelqi të Rolex Boutique, që në atë kohë ishte e mbyllur, dhe hyri në Boutique dhe theu disa vitrina ku ishin ekspozuar disa orë dore të shtrenjta, dhe menjëherë pas kësaj të pandehurit A.S., G.A., R.A., E.G., së bashku me anëtarët e tjerë të grupit, grabitën shtatëdhjetë (70) orë dore Rolex dhe nëntë (9) orë dore Theodore që ishin ekspozuar brenda vitrinave të Boutique dhe u larguan duke marrë me vete shtatëdhjetë e nëntë (79) orë dore me vlerë pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë (583,930.00) dinarë bahrejni, që është e barasvlershme me një milion, njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë euro dhe tetë centë (1,162 767,08). Vlera e orëve të dorës u

⁷³ A. S., R.A., G.A., E.G., P.F., A.D., E. G. dhe I.E..

⁷⁴ 70 Rolex dhe 9 Theodore.

⁷⁵ Vlera e orëve u llogarit nga Departamenti i Kontabilitetit të Rolex Boutique.

⁷⁶ Dokumentet shkresore të Lidhjes Bahrain, vëllimi 8, tabela A, CD bashkëngjitur – procesverbal 4:20 i filmimit dhe fotove vijuese.

përcaktua nga Departamenti i Kontabilitetit të Dyqanit të Orëve Rolex . Ky fakt u konfirmua me deklaratën e R.T.P..⁷⁷

Menjëherë pas grabitjes, të pandehurit G.A., E.G., R.A. dhe A.S., së bashku me anëtarët e tjerë të grupit, u larguan nga Qendra Tregtare City Mall në zotërim të 79 orëve të dorës, me një Toyota Fortuner të marrë me qira më parë nga P.F., dhe rrugës në kthim në hotelet e tyre ndërruan automjetet dhe kaluan në një automjet tjetër – një Mitsubishi Gallant, të marrë me qira më parë nga R.A., dhe 63 orë i fshehën në një apartament, të marrë me qira nga një pjesëtar i grupit⁷⁸, në zonën e M.-s dhe u kthyen në hotelet ku po qëndronin, ku të nesërmen, ata u larguan nga Mbretëria e Bahrejnit nga fluturime të ndryshme për në vende destinacioni të ndara në rajonin e Ballkanit.

Të 63 orët e dorës që kishin mbetur në banesë, u morën disa ditë më vonë nga E. G., i cili sipas udhëzimeve të dy individëve nga Shqipëria, fluturoi në një datë të mëvonshme nga Kosova në Bahrejn për të marrë orët e dorës nga banesa ku ishin fshehur. Pastaj E. G. shkoi në një hotel në Qytetin e Bahrejnit, ku u takua me I.E. për t'ia dorëzuar orët e dorës këtij të fundit.

Ky fakt u konfirmua nga deklarata e I.E., e përmbledhur më sipër, ku ai theksoi se E. G. erdhi në banesën e tij dhe solli orët e dorës në fjalë. Si E. G., ashtu dhe I.E. u arrestuan dhe u dënuan nga autoritetet e Bahrejnit, dhe të 63 orët e dorës u thyen dhe iu dorëzuan përsëri dyqanit Rolex. Ky fakt është konfirmuar tashmë nga deklaratat e dëshmitarëve R.T.P. dhe J. R. ku ata të dy konfirmuan se kanë marrë 63 orë dore nga policia Bahrejnit.

Kjo gjendje faktike në lidhje me grabitjen u testua dhe vërtetua plotësisht nga provat gjatë procedurës penale.

Data, koha, vendi i kryerjes së veprës penale të grabitjes, u vërtetuan në bazë të xhirimeve CCTV⁷⁹, si dhe deklaratat e palës së lënduar M. Z. dhe dëshmitarit R. B. të cilët u dëgjuan në seancat e Mundësisë Hetimore të Veçantë. Xhirimet CCTV

⁷⁷ Lista e orëve të vjedhura të dorës me foto, Lidhja e Prokurorisë, Dok. Bahrejnit, tabela 2, faqet 26-32.

⁷⁸ Sipas E. G., ishte A.S. ai i cili mori banesën me qira.

⁷⁹ Dosja e shkresave të prokurorisë, vëllimi 8, tabela A, CD bashkëngjitur & PKR.nr. 314/13 Dosja SIO e Gjykatës II A, tabela 11-CCTV.

reflektojnë momentet kur të pandehurit iu afruan qendrës tregtare City Center dhe parkuan Toyoten Fortuner në parkimin e saj më 10 shtator 2013. Nuk kishte dyshime në lidhje me vërtetësinë e video incizimit.

Xhirimet e CCTV-së pasqyrojnë momentet kur të pandehurit u larguan nga dhomat e hotelit ku po qëndronin në zonën M., në momentin që hynë me Toyotën Fortuner që P.F. kishte marrë me qira më parë, në momentin e grabitjes⁸⁰, rrugën që u ndoq nga të pandehurit me kerr⁸¹, më pas ajo tregon qendrën tregtare, momentet kur të pandehurit mbërritën përsëri në hotelet e tyre dhe të nesërmen në mëngjes, kur të pandehurit u larguan për në aeroport.

Pjesët e mëposhtme të indeksuara me vula kohore të ngulitura në regjistrime u luajtën sërish dhe u shpjeguan nga dëshmitari – polici G.A.A.E.A.S: *“në orën 06:53:41 të pandehurit P.F. dhe A.D. dalin nga hoteli; në 06:24:21 shihet Mitsubishi. Më tej, “Këto janë Gj. Gj. dhe G.A. pa u përmendur koha në regjistrim. E.G. dhe E. G. po dalin, G.A. po hyn në hotel; G.A. dhe E.G. po zbresin nga hoteli në 20:13:15; ata do të ndiqen nga R.A.; kjo në 20:13:35. Në 20:52 mund të shohim R.A.n që zbret nga hoteli dhe kjo është vetura që ata përdorën për të kryer krimin. Tani i shohim ata duke u larguar nga vendi i ngjarjes pasi bënë krimin. Kjo është ajo për të cilën po flisnim. Ai i rrumbullakosur është automjeti që ata përdorën. Ora është 12:5 sekonda. Ne i humbëm ata këtu; kjo është kur ata po kthehen pas kimit, ata shkuan me P.F. dhe A.D., ata shkuan me automjetin, por ata u kthyen me një taksi në 12.27 të mëngjesit. Tani në lift mund të shohim P.F. dhe A.D. në 12.28. Tani mund të shohim Gj. Gj. dhe G.A. dhe shohim se Gj. Gj. ka ndryshuar këmishën e tij, këmisha që kishte veshur kur kreu krimin është në duart e tij, ajo që ka veshur tani i përket E. G.. Pastaj E.G. dhe R.A. po kthehen, ne mund të shohim P.F. dhe A.D. duke dalë nga hoteli duke shkuar në aeroport 01:11 të mëngjesit. Kjo është makina me të cilën u larguan, Corolla e bardhë, i vozitur nga një indian. Ky është Gj. Gj. dhe G.A. duke u çregjistruar dhe duke shkuar në aeroport në 12:20. Tani mund të shohim E.G. dhe R.A. duke u çregjistruar dhe duke dalë nga hoteli në 3:04 të mëngjesit. Tani pamjet filmike nga aeroporti, në fillim Gj. dhe G.A. u largua me Turkish Airlines. Tani mund të shohim P.F. dhe A.D.n: ata me këmisha të bardha, dhe E.G.n dhe R.A.n; ata u larguan me Etihad Airlines”.*

Gjykata i ka kushtuar vëmendje kohës kur të pandehurit dolën nga hotelet e tyre dhe kohës kur ata u kthyen, siç u shpjegua më lart nga dëshmitari G.A.A.E.A.S, dhe arrin në përfundimin se kjo përputhet me kohën kur është kryer grabitja.

⁸⁰ Shkresat e dosjes së prokurorisë, dokumente të Bahrejnit, vëllimi 8, tabela A, CD.

⁸¹ Filmime të CCTV-së të siguruar nga kamerat e Qytetit.

Të gjithë të pandehurit, anëtarë të grupit, dolën nga hotelet e tyre dy-tre orë para kryerjes së grabitjes dhe u kthyen fill pas një ore ose pak më vonë p.sh. P.F. dhe A.D. në 12.27 të pasdites, të ndjekur nga A.S. dhe G.A. dhe në fund E.G. dhe R.A.. Për më tepër, duke marrë parasysh se sipas marrëveshjeve, çregjistrimi i të gjithë të pandehurve ishte 12 shtator 2013 dhe fakti që të gjithë të pandehurit u çregjistruan herët në mëngjes më 11 shtator 2013 (A.S. dhe G.A. në 12.20 të mëngjesit, P.F. dhe A.D. në 01.11 të mëngjesit dhe E.G. dhe R. A. në 03.04 të mëngjesit) ky është një tregues i qartë i përfshirjes së tyre në veprën penale të grabitjes.

Megjithëse dëshmitari-i dëmtuari M. Z. nuk ishte në gjendje të shihte fytyrat e kryerësve, ai konfirmoi se ka parë pesë-gjashtë njerëz të veshur me abaya të hyjnë në qendrën tregtare City Center në M. në orën 11.20 ose 11.00 të mbrëmjes dhe se ata silleshin si burra. Deklarata e tij vërteton filmimet e CCTV-ve të marra në qendrën tregtare City Center që tregonte gjashtë persona të hyjnë në Rolex Boutique, dhe momentin kur njëri prej tyre sulmoi rojën e sigurisë dhe më pas se si ata thyen derën dhe vitrinat, si dhe momentin kur ata morën orët e dorës⁸².

Më tej, dëshmitari Sh.R.B. konfirmoi se kishte dëgjuar kolegun e tij të thirrte për ndihmë dhe, kur shkoi atje, ai gjeti kolegun e tij (M. Z.) të shtrirë, si dhe konfirmoi se i kishte parë këta pesë-gjashtë njerëz të veshur me rroba të zeza duke u larguar me vrap dhe se ata gjuajtën një kaçavidë drejt tij. Ky episod shihet edhe në xhirimet e CCTV-së të marra nga qendra tregtare e City Center. Fill pas kësaj, dëshmitari Sh. R. njoftoi policinë dhe menaxhmentin e Qendrës Tregtare.

Më tej, deklaratat e dëshmitarëve R.T.P. dhe J. R. u gjetën të mbështetshme dhe të besueshme. Deklaratat e tyre vërtetojnë njëra-tjetrën në lidhje me njollat e gjakut, se ekipi i mjekësisë ligjore i mblodhi ato, dhe se lista e inventarit u bë në Rolex Boutique. Në lidhje me këtë, Gjykata konstatoi një mospërputhje të lehtë nëse ka pasur një ose më shumë njolla gjaku, por kjo është normale për shkak të mospërsosërisë së qenies njerëzore, si dhe kohës së kaluar. Sidoqoftë, u konfirmua se policia ishte në vendin e ngjarjes duke siguruar vendin dhe mblodhi të gjitha provat duke përfshirë njollat e gjakut.

Po kështu konfirmohet se menjëherë pas grabitjes që ndodhi më 10 shtator 2013, autoritetet policore të Bahrejnit mblodhën kampionë të ADN-së nga vendi i ngjarjes – Rolex Boutique në qendrën tregtare të City Center në M..

⁸² Shkresat e dosjes së prokurorisë, dokumente të Bahrejnit, vëllimi 8, tabela A, CD.

ADN-ja u gjet në një shkop prej druri të thyer me një gjatësi maksimale prej 74,5 cm i gjetur nga brenda dhomës së ekspozimit. Shkopi prej druri u etiketua si Prova S6. Pas transferimit të juridiksionit nga Mbretëria e Bahrejnit në Kosovë, dhe në bazë të urdhrave të gjyqtarit të procedurës paraprake⁸³, mostra të ADN-së u morën nga A.S., G.A., R.A. dhe E.G..

Agjencia Kosovare për Mjekësi Ligjore / Njësia e Shkencës Juridike kreu ekzaminimin e materialeve të ADN-së me metodat e plota të miratuara me ligj. Raporti me nr. ref. AKF/2014-0753/2014-067 u përfundua më 2 prill 2014⁸⁴, dhe gjetjet e tij ishin si vijon:

'Profili i ADN-së i G.A. përputhet me profilin e ADN-së të marrë marrë nga prova S6 nga skena e krimit, kështu G.A. nuk mund të përjashtohet si dhënës i ADN-së në provën S6.

Gjasat që ky profil të shfaqet në popullatë është 1 në 5.9 miliardë njerëzish'.

Dëshmitarët J.R. dhe R.T.P. konfirmuan se panë njolla gjaku në vendin e ngjarjes në një vitrinë në Rolex Boutique. Ata konfirmuan të dy se Njësia e Mjekësisë Ligjore e Policisë së Bahrejnit siguroi dhe mbloodhi këtë kampion. Siç detajohet më sipër, këta dy dëshmitarë shpjeguan se si ata shkuan në Rolex Boutique pasi ishin informuar në lidhje me grabitjen, ato që ata vërejtën në vendin e ngjarjes, dhe si u bë inventarizimi i orëve të dorës.

Raporti i ADN-së vërteton përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri G.A. është autori i grabitjes në Rolex Boutique. Kjo dëshmi nuk lë dyshim se edhe të pandehurit A.S., R.A. dhe E.G., së bashku me A.D. dhe P.F., ishin me G.A. dhe se edhe ata janë autorë të grabitjes.

Gjykata arriti në këtë përfundim pasi shqyrtoi dhe krahasoi të gjitha provat dhe faktet të tilla si: fakti se të pandehurit udhëtuan bashkë më 5 shtator 2013 në Mbretërinë e Bahrejnit, dhe se ata qëndruan në hotele të ndryshme afër M.-së. Ky fakt u provua përmes faturës 003584/2013⁸⁵, të datës 1 shtator 2013, e lëshuar në emër të A. S., megjithëse ai udhëtoi me emrin Gj. Gj. Krahas kësaj, siç u përmend më lart, përveç E.G.t dhe R.A.t, të pandehurit A.S. dhe G.A., së bashku me A.D. dhe P.F., e vizituan Mbretërinë e Bahrejnit edhe në korrik 2013.

⁸³ Dosja e Gjykatës Themelore të Prishtinës, vëllimi 2, tabela 16; Shkresat e Gjykatës, vëllimi 4, tabela 18.

⁸⁴ Ky raport mund të gjendet në Dosjen e Policisë, vëllimi 7, tabela 9.

⁸⁵ Lëshuar nga Xxxx Travel – Dosja e Policisë, Vëll. 4, Dokumentet e kontrollit të Xxxx-s, dokumenti në faqen 323.

Për më tepër, Gjykatës iu paraqitën provat që rezultuan nga kontrollet e ambienteve të të pandehurve. Bazuar në urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake, banesa e A.S.t u kontrollua më 16 nëntor 2013, ku ndër të tjera, një palë pantallona të shkurtra të llojit denim⁸⁶ u sekuestruan si provë. Siç tregohet në pamjet filmike të CCTV-së të Mbretërisë së Bahrejnit, A.S. kishte veshur një palë pantallona të shkurtra shumë të veçanta të llojit denim ndërsa kryente grabitjen. Kjo provë u mor krahas provave të tjera.

Krahas kësaj, policia gjithashtu sekuestroi një shënim me shkrim dore me marka të orëve të dorës, ku në rreshtin e dytë shkruhet “4 Rolex”⁸⁷. Mbrojtja nuk kishte shpjegime të arsyeshme rreth kësaj letre; prandaj kjo letër nuk mund të përjashtohet si provë që e lidh të pandehurin A.S. me grabitjen. Megjithëse dëshmitari B. H. ishte ngurrues gjatë deklarimeve të tij, pasi u ballafaqua me deklaratën e tij të mëparshme, ai konfirmoi faktin se kur A.S. vizitoi dyqanin e tij “Besa”, ky i fundit kishte një orë dorë Rolex. Në këtë pjesë dëshmitari këmbënguli se kishte parë vetëm gjysmën e orës së dorës, prapëseprapë, ai konfirmoi se kishte treguar orën Rolex kur prokurori i kishte treguar atij disa foto.

Kjo orë dore që A.S. pretendohet se kishte, dhe orët e tjera Rolex nuk u arrit të gjendeshin, mirëpo kjo është provë shtesë që e lidh A.S. me grabitjen në Mbretërinë e Bahrejnit. Ky përfundim bazohet edhe në përmbajtjen e telekomunikimeve të mëposhtme të përgjuara, sepse të pandehurit vërtet folën për një orë dore të caktuar.

Dëshmitari V. S., ekzekutiv i shitjeve në ‘Oscar Rent a Car’ në Bahrejn, i cili dha dëshmi më 3 korrik 2014, tha se më 5 shtator 2013, R.A. mori me qira një veturë, një Mitsubishi Gallant. Fakti që R.A. mori me qira veturën nuk u kontestua nga mbrojtja e tij. Një dëshmitar tjetër, M. S., konfirmoi se një anëtar i grupit, i cili më vonë duket se ishte P.F., mori me qira Toyotën Fortuner.

Dëshmitari G.A.A.E.A.S, polic dhe hetuesi kryesor i çështjes penale në Mbretërinë e Bahrejnit shpjegoi se si ka filluar hetimi, si dhe hapat që ndërmoi Policia në Bahrejn. Mënyra e tij e shpjegimit të ngjarjeve të shikuara në pamjet filmike të CCTV-së u gjet plotësisht e besueshme.

⁸⁶ Dosja e shkresave të policisë, vëllimi 6, tabela 24.

⁸⁷ Dosja II e shkresave të policisë, vëllimi 2, tabela 26, faqet 1-97.

Gjykata e gjeti këtë deklaratë të mbështetshme, sepse ajo u bazua në prova shkresore që u transferuan nga Mbretëria e Bahrejnit në Republikën e Kosovës. Siç u detajua në deklaratën e tij që u përmbledh më sipër, policia e Bahrejnit gjeti se u përdor një Toyota Fortuner për të ikur nga vendi i ngjarjes dhe se ky automjet u mor me qira nën një emër të rremë – emri grek A. S. dhe që më vonë u zbulua se ky person nuk kishte hyrë kurrë në Bahrejn. Se dukej se personi i cili mori me qira këtë veturë ishte P.F.. Kjo u konfirmua edhe nga deklarata e dëshmitarit M. S, dhe pa dyshim këtë e konfirmuan edhe provat materiale.

Gjykata dëgjoi dëshmi në lidhje me pretendimet se E. G. ishte ngarkuar t'i dorëzonte 69 orët e dorës I.E., dhe ky fakt u konfirmua nga dy dëshmitarë. Dëshmitari I.E., në deklaratën e tij të dhënë më 11 dhjetor 2014, konfirmoi në thelb se ishte kontaktuar nga E. G. i cili solli 69 orë dore (60 Rolex dhe 9 Theodore) në banesën e tij në Bahrejn. Ai më tej theksoi se E. G. nuk ka sjellë dokumentet për të transportuar orët e dorës. Sipas këtij dëshmitari, ai i tha E. G.t se transporti nuk mund të bëhej pa dokumentet. Se E. G. i premtoi atij se do t'ia sillte dokumentet më vonë gjatë ditës, por ai u arrestua. Ai gjithashtu dëgjoi që Policia e kishte arrestuar edhe E. G..

Zyrtari policor G.A.A.E.A.S, në deklaratën e tij të dhënë më 3 korrik 2014, konfirmoi se policia në Bahrejn, pas një kërkimi në dhomën e I.E. në hotel, gjeti 69 orët. Ky dëshmitar konfirmoi se I.E. deklaroi në lidhje me dorëzimin e orëve nga E. G.. E. G. gjithashtu e konfirmoi këtë në një bisedë telefonike spontane me policin R.B..

Pas kryerjes së grabitjes në Mbretërinë e Bahrejnit, përgjimet e siguruar nga Policia e Kosovës tregojnë komunikimin midis anëtarëve të grupit të tilla si;

01.10.13 bisedë midis G.A.t dhe PPM:

[...]

PPI: “... tani të kthehet, të merret ajo nga dora e bashkëshortes, dhe t'i kthehet H”

03.10.2013

G: “Lexova atë letrën e gazetës Daily News dhe ata i kishin vënë gjërat në foto atje, në shtrat”

E: “ok shoku, unë i dhashë atij dy ditë, e di çfarë dua të them ...”

03.10.2013

G: *“a ke nevojë për diçka”*.

A: *“jo tamam, më duheshe vetëm për pak, pasi që po më dhemb koka vëlla, nga gjithë këto thashetheme, vërtet po trishtohem vëlla.”*

04.10.2013

PPI thotë se *“ora e dorës, që e kishe dikur, ti e di, atë që mbante H, mbaje ti G”*.

Përgjigjet G *“po”*.

PPI pyet *“ku është tani”*.

G thotë: *“mendoj se e merr axha”*.

04.10.2013- një bisedë mes G.A.t dhe një PPI-je

G: *“e mora vesh, ai na dorëzoi plotësisht”*.

05.10.2013- G.A. dhe PPI

PPI: *“ishin gjashtëdhjetë e tre apo katër (63-4)”*

G thotë: *“vërtetë? ... hajde nesër dhe i numërojmë”*.

05.10.2013- G.A. dhe PPI

G: *“më dërgo atë gjënë ku hymë mbrëmë, atë faqen në internet”*

SMS për G: [www.youtube.com/each/bahrain rolex city centre](http://www.youtube.com/each/bahrain%20rolex%20city%20centre)

07.10.2013

G: *“asgjë, ata e shtynë, për një javë tjetër, nuk u mbajt fare”*.

A: *“Llogarita nëse diçka hidhet në mua, atëherë ata e bëjnë spektakolare, jo/pastaj gjyqi, pasi këta persona i lidhin gjërat vëlla”*.

01.09.2013

Tringa u përpoq t'i dërgonte një SMS⁸⁸ E: "E telefono këtë numër xxxxx ... 31 në viber"

12.09.2013 – T. S. një personi të panjohur

SMS për T "mos guxo⁸⁹ ta lësh atë kyç dore diku".

22.09.2013 – sms nga T. S. për një person të panjohur "A e bëre atë shpirti, çfarë po bën, a bëre pazar"

18.10.2013 – T. S. dhe UFP: "T. flet shumë për "babi nuk ka pse vjen në banesë"

Bazuar në përmbajtjen e transkripteve të mësipërme është vërtetuar se të pandehurit, pasi u kthyen në Kosovë, ishin në kontakt me njëri-tjetrin, përmbajtja e bisedës së tyre është në lidhje me orët e dorës, ata interesohen për lajmet në lidhje me grabitjen në Bahrejn, dhe shprehin frikën se E. G. u dha emrat e tyre autoriteteve të Bahrejnit. Krahas kësaj, T. S., gruaja e A.S., u përpoq t'i dërgonte E. G. numrin e telefonit të A.S.. Për më tepër, ka një tekst sms të dërguar nga T. S. ku e paralajmëron dikë të mos lërë ndonjë orë dore gjëkund.

Përfundim

Çështja qendrore për t'u vlerësuar nga Gjykata është nëse të pandehurit kanë kryer veprën penale të kimit të organizuar siç parashihet në nenin 283, par. 1 të KPRK-së, që adreson kërkesa të caktuara për t'u plotësuar, përkatësisht *actus reus* dhe *mens rea*.

Actus reus përshkruhet si elementet objektive, kurse *mens rea* si elementet subjektive të veprës penale. Në lidhje me këtë, Trupi Gjykues duhet të pyesë nëse në kohën e kryerjes së veprës penale, në rastin në fjalë të grabitjes, ekzistonte një grup i organizuar kriminal.

Më tej, Trupi Gjykues duhet të pyesë nëse secili anëtar i grupit kishte synimin të kryente veprën penale të grabitjes ose, siç thuhet në nenin 283 synimin e tij (të

⁸⁸ Dështoi. Përkthimi në anglishte nuk është i saktë.

⁸⁹ Përkthimi në anglishte gabimisht tregon fjalën 'i dashur'.

grupit të organizuar kriminal) për të kryer grabitjen, që do të thotë nëse grupi i organizuar kriminal kishte qëllim të kryente grabitjen në Bahrejn. Së fundi, Trupi Gjykses duhet të pyesë nëse secili anëtar i grupit mori pjesë aktive në veprimtaritë e grupit dhe nëse kjo pjesëmarrje e tillë kontribuoi në realizimin e veprimtarisë kriminale të grupit, domethënë, grabitjen në Bahrejn.

Në procesin e vendimmarrjes Trupi Gjykses vlerësoi dhe analizoi me kujdes tërësinë e provave që u pranuan, administruan dhe nuk u refuzuan *ab initio* ose nuk u përjashtuan me ndonjë aktvendim. Trupit Gjykses kujton formulimin e nenit 361, paragrafit 1 të KPPRK-së, domethënë, “*Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor*” dhe në paragrafin 2 të të njëjtit neni, gjykata do t’i përmbahet dispozitës në vijim: *Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.*

Nga sa më sipër, trupi gjykses nxori këto përfundime;

Trupi Gjykses vërtetoi se të gjitha elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal apo organizimin e një grupi të organizuar kriminal janë të pranishme në lëndën në fjalë, sipas nenit 283, paragrafi 1, nenit 120, paragrafi 13, të KPRK-së, dhe elementet e veprës penale të grabitjes, sipas nenit 329, paragrafi 3, të KPRK-së.

Ky përfundim rrjedh nga fakti se të pandehurit A.S., R.A., G.A. dhe E.G., bashkë me anëtarë të tjerë të grupit, planifikuan dhe ndërmorën veprime së bashku para kryerjes së grabitjes, p.sh. me organizimin e udhëtimeve, marrjen e vizave, prenotimin e fluturimeve, prenotimin dhe qëndrimin në hotele të ndryshme në afërsi të qendrës tregtare City Center Mall në M., marrjen me qira të automjeteve që do të përdreshin për të shkuar dhe për t’u larguar nga vendi i ngjarjes. Më tej, të pandehurit kryen si grup grabitjen në një mënyrë shumë të sofistikuar – duke u veshur me abaya, si dhe duke siguruar instrumentet për të neutralizuar dhe/ose eliminuar të gjitha pengesat e mundshme p.sh. duke përdorur spërkatës me piper kundër M. Z., dhe përdorimin e sëpates për të thyer vitrinat dhe dyert rrëshqitje e kështu me radhë.

Siç u përmend më parë një anëtar i grupit ndërsa kryente grabitjen, preu veten dhe la kampionin e tij të ADN-së që më pas u përputh pozitivisht me kampionët e marrë nga G.A.. Vetë provat e ADN-së dhe faktet tashmë të vërtetuara në lidhje me organizimin, udhëtimet dhe grabitjen provojnë se G.A. veproi së bashku me

anëtarët e grupit, siç tregohet në xhirimet filmike të CCTV, dhe prova të tjera materiale siç u përmend më lart.

Krahas kësaj, të pandehurit supozohej të çregjistroheshin më 12 shtator 2013, por siç u provua, ata të gjithë u larguan nga Mbretëria e Bahrejnit herët në mëngjesin e 11 shtatorit 2013 dhe fluturuan për në Ballkan. Më tutje kësaj, detyra e E. G.t për të dorëzuar produktin e grabitjes – të 63 orët e dorës iu dorëzuan I.E.s. Për më tepër, kontaktet e gjera mes disa anëtarëve të grupit pasi u kthyen në Kosovë, pa dyshim vërtetojnë se të gjitha veprimet e mësipërme dhe ndarja e detyrave ishin planifikuar paraprakisht, me qëllimin për të kryer grabitjen. Si përfundim, elementet e dashjes, dijenisë dhe pjesëmarrjes aktive, ndonëse e dinin se pjesëmarrja e tillë do të kontribuonte në realizimin e veprimitarisë kriminale të grupit, ishin të pranishme tek të gjithë të pandehurit⁹⁰. Për këtë arsye, të gjitha kërkesat e parashikuara nga neni 283, paragrafi 1, nga neni 120, paragrafi 13, dhe Neni 329, paragrafi 3, të KPRK-së janë plotësuar.

Prandaj, për arsyet e lartpërmendura, Gjykata provoi përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit A.S., R.A., G.A. dhe E.G. kryen veprën penale të krimit të organizuar, në shkelje të nenit 283, paragrafi 1, të KPRK-së, në lidhje me nenin 329, paragrafi 3 të KPRK-së.

Pjesa e liruese në lidhje me H.G. për krimin e organizuar, neni 283, paragrafi 1, i KPRK-së

Sa i përket të pandehurit H.G., Gjykata ka vërtetuar se Zyra e Prokurorisë ka dështuar që të ofrojë dëshmi të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm përfshirjen e të pandehurit H.G. në kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar (pika 2 e Aktakuzes), prandaj, në mungesë të provave, i pandehuri lirohet nga akuza, sipas nenit 364, 1.3 të KPPRK-së.

Prokurori pretendonte se i pandehuri H.G. mbeti në Kosovë si mbështetës i grupit, që së paku një nga orët Rolex të jetë ende në Kosovë, dhe se kjo ishte në zotërim të H.G.t. Në mbështetje të këtij pretendimi, Prokurori i referohet një bisede të

⁹⁰ Duke përjashtuar H.G.

përgjuar, e datës 01 tetor 2013, e zhvilluar në orën 21.14.59⁹¹, ndërmjet një personi të pidentifikuar⁹² dhe G.A. dhe përmbajtja e bisedës është si më poshtë:

G.: Po i dashur, çka ke bë?

PPI: Çka bone, ti më ke thirr?

[...]⁹³

PPI: dëshiron të dalësh?

G: vërtet, mund të ndodhë, tani ne shkojmë atje, ai M. këndon atje, një lloj ndejeje, me H. dhe ca njerëz.

PPI: Cili H, njeri?

G: Me atë, për atë, hej.

PPI: Po i dashur.

G: A e (di⁹⁴) cili ishte problemi i tij?

PPI: Çka?

G: Ndoshta ne do të shkojmë atje.

PPI: Po.

G: po ta kishim, e di ti?

PPI: Ai kopil i ndyrë, nuk mund të bëhet, i dashur.

G: Tani po e kuptoj.

PPI: Kjo është, ti e di se çka është, i dashur, sepse po të ishte për ata, po të ishte për dajën, unë do t'ia thosha atij dajë, ose ata ose ata të tjerët, gjëja është e jotja dhe tani përderisa ia dhashë gruas sime, tani do ta kthej, do ta marr nga dora e gruas sime dhe do t'ia kthej H., t'ia kthej atij, kjo nuk ka kuptim, a është ai normal apo çka, unë vetëm u ndjeva keq, nuk e kam ditur se ku qëndronte problemi, por i dashur ti duhet të vish, vetëm mos u deh, dhe mos fol diçka para tij, sepse pastaj ai fillon që të flasë gjepura.

G: Ah.

PPI: ki kujdes çfarë flet para tij.

G: Po, në rregull.

PPI: Në rregull i dashur, mirupafshim.

Një përgjim tjetër i nënvizuar nga Prokurori ku përmendet emri i H, është ai e datës 04 tetor 2013, në orën 13:27:47⁹⁵.

⁹¹ Lidhja I - Dosja e Policisë, vëllimi 1, tabela 17, numri thirrës 049-... -.95 – numri i thirrur 045-... -.28

⁹² Prokurori pretendon se ishte A.S..

⁹³ Pjeset jo-relevante të bisedës nuk janë shkruar

⁹⁴ Kjo fjalë mungon në përkthimin në gjuhën angleze, sido që të jetë, versioni në gjuhën shqipe përmban atë, prandaj është shtuar nga Gjykata me qëllim të reflektimit të bisedës së plotë dhe kuptimit të saj.

⁹⁵ Dosja I – Dosja e Policisë, Vll. I, tabela 19 numri thirrës 044... 06 numri i thirrur 045... 28.

PPM: Ku po shkoni?

G⁹⁶ po, tek M.

PPM: Në rregull, jo, do të takohemi pasi ta përfundosh⁹⁷

G: Ha.

PPM: Ora të cilën ai⁹⁸ e ka pasur, e di atë që e mbante H, mbaje.

G: Po, po.

PPM: dhe ku është tani?

G: Mendoj se e ka marrë daja, nuk e di nëse daja e ka marrë ende.

PPM: Po, mendoj se ai pisi e ka marrë nga ai.

G: Dhe, a mendon se ai do t'ia japë dajës.

PPM: Jo, vetëm t'ia kthejë dajës dhe të mos e marrë fare.

G: Po, në rregull.

PPM: Në rregull, kur ta përfundosh do të takohemi dhe do të shohim se çka do të bëjmë.

Një përgjim tjetër⁹⁹ u nënvizua nga Prokurori dhe kjo ishte biseda e datës 03 tetor 2013, në orën 18:14:57, ndërmjet G.A. (numri i tij përgjohej) dhe H.G.¹⁰⁰.

[...] ¹⁰¹

G: Këtu në internet po tregohet se dy persona janë arrestuar.

H: Po, po është në gazetat e sodit.

[...] ¹⁰²

H: “Çdo gjë është në rregull, por marrëveshja që e kisha më herët”, që do të thotë se “neve nuk na e ndjen”.

G: Po, e drejtë është.

H: A e di, deri këtu mund të bëjmë punë; nuk kemi asgjë tjetër c'të bëjmë, sepse çështja është ashtu, jo ai, jo ai tjetri, tani mund të themi cilido qoftë, neve nuk na e ndien, marrëveshja është ashtu si ishte”.

⁹⁶ G.A. ishte numër shënimi (urdhri mbi përgjimin ishte lëshuar kundër tij)

⁹⁷ Versioni në gjuhën angleze e përkthyer gabimisht e thotë fjalën “ti”, Tabela 19, faqe 19 (e numëruar me 221).

⁹⁸ Versioni në gjuhën angleze e përkthyer gabimisht e thotë fjalën “ti”, Tabela 19, faqe 19 (e numëruar me 221).

⁹⁹ Dosja I – Dosja e Policisë 1, faqe 23, duke e thirr 044... 06 thirrje 045... 28

G.A. ishte numër shënimi (urdhri mbi përgjimin ishte lëshuar kundër tij)

¹⁰⁰ Kur është pyetur nga anëtarët e shqyrtimit kryesor, H.G. ka konfirmuar që të ketë qenë në zotërimin e atij numri të telefonit.

¹⁰¹ Nuk është relevante.

¹⁰² Nuk është relevante.

I pandehuri H.G. u dëgjua gjatë seancës së 5 gushtit 2015. Ai në thelb e mohoi pretendimin e Prokurorit se përmbajtja e kësaj bisede e përfshin atë në grupin e organizuar kriminal. Në deklaratën e tij, i pandehuri H.G. tha, *“unë tregtoj me automjete dhe G.A. erdhi tek unë me një person tjetër të quajtur D. Ai erdhi tek unë dhe bleu një automjet të tipit Renault Laguna, viti 2013. G.A. nuk e bleu vetë, por vetura u ble nga personi tjetër dhe ai nuk m’i dha të hollat fare, dhe ne bëmë marrëveshje që në rast se personi tjetër nuk i paguan të hollat, ato të holla do të m’i paguan G.A.. Kur erdhi afati për pagesën e të hollave, ata thanë se ata ishin nisur që të shkonin diku, atje ku ata shkojnë ilegalisht; duket se ata kanë dështuar diku t’u referohen këtyre personave që e kalojnë kufirin ilegalisht. Unë i thashë atij se nuk jam i interesuar në këtë sepse ti e di se si ishte marrëveshja.”* Më tej, i pandehuri H.G. theksoi se i kishte thënë Prokurorit se *“Ju nuk i morët përgjimet e numrave të telefonit, ju nuk i morët të gjitha përgjimet e të gjithë numrave, sepse po ta kishit bërë këtë, do ta kishit vënë re se unë kam diskutuar edhe me A.S. dhe R.A., sepse kur vëllai im¹⁰³ u burgos nga policia shqiptare në kufi, ata informuan gruan e E. në shtëpi me telefon se E. ishte paraburgosur atje nën dyshimin në lidhje me këtë rast dhe e tërë familja, unë, një nga motrat e mia dhe anëtarët e tjerë të familjes shkuam atje. Dhe atje ne e kuptuam se pse E. ishte paraburgosur, për çfarë ishte i dyshuar dhe atje pamë listën e të dyshuarve”*.¹⁰⁴

Gjykata ka analizuar me kujdes të gjitha provat e paraqitura nga Prokurori në lidhje me përfshirjen e H.G.t në kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar. Gjykata gjithashtu ka analizuar deklaratën e H.G.. Në një analizë të vëmendshme, provat e Prokurorit mund të sugjerojnë se i pandehuri H.G. mund të ketë qenë i përfshirë në kryerjen e krimit të organizuar; megjithatë, Gjykata gjen se ka prova të pamjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se personi i përmendur në bisedat e zhvilluara ndërmjet G. dhe PPI-së, ishte i pandehuri H.G..

Gjykata ka analizuar me kujdes të gjitha provat e paraqitura nga Prokurori në lidhje me përfshirjen e H.G. në kryerjen e veprës penale të krimit të organizuar. Gjykata gjithashtu ka analizuar deklaratën e H.G.. Në një analizë të vëmendshme, provat e Prokurorit mund të sugjerojnë se i pandehuri H.G. mund të ketë qenë i përfshirë në kryerjen e krimit të organizuar; megjithatë, Gjykata gjen se ka prova të pamjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se personi i përmendur në bisedat e zhvilluara ndërmjet G. dhe PPI-së, ishte i pandehuri H.G..

¹⁰³ E.G.

¹⁰⁴ Procesverbal i shqyrtimit kryesor të datës 05 gusht 2015, faqe 5.

Siç u deklarua më lart, Gjykata i ka pranuar si provë përgjimet e lartpërmendura dhe përmbajtjen e tyre; megjithatë, nuk është bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se H.G. me këtë provë mund të cilësohet si kryerës i veprës penale të pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal. Për më tepër, pretendimi i Prokurorit se i pandehuri H.G. qëndroi në Kosovë si mbështetës i grupit nuk u mbështet me asnjë provë bindëse, prandaj, ai është gjetur jo fajtor dhe në pajtim me nenin 364, paragrafi 1.3, të KPPRK-së, i pandehuri lirohet nga akuza për veprën penale të kriminit të organizuar, në shkelje të nenit 283, paragrafi 1, të KPRK-së.

Sa i përket akuzës 4 të Aktakuzës, trupi gjykues e gjen si të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri H.G. ka kryer veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 374, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së, Ligji nr. 03/L-246, neni 1.20.

Përcaktimi ligjor i mbajtjes nën pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve – neni 374.

1. Kushdo që është pronar, kontrollon apo zotëron armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm që ka të bëjë me të tillë armë do të dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesë qind (7.500) euro, apo me burgim deri në pesë (5) vite.
2. Kur vepra penale e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni përfshin më shumë se katër (4) armë, apo më shumë se katërqind (400) plumba, autori i veprës do të dënohet me dy (2) deri në dhjetë (10) vite burgim.
3. Arma e mbajtur në pronësi, e kontrolluar ose e zotëruar në kundërshtim me këtë nen do të konfiskohet.

Trupi gjykues vëren se kjo vepër penale mund të kryhet në tri mënyra: duke mbajtur në pronësi, duke kontrolluar ose zotëruar armën në shkelje të ligjit të zbatueshëm për të tilla armë. Më tej, duhet theksuar se, nëse vetëm një nga këto kushte përmbushet, atëherë personi mund të konsiderohet si kryerës i veprës penale dhe të ballafaqohet me pasojat ligjore.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Prokurori ofroi dëshmi të besueshme në mbështetje të pretendimit të tij se ishte i pandehuri H.G. ai i cili kontrollonte dhe/ose zotëronte municionin e gjetur gjatë kontrollit të shtëpisë ku jetonte i pandehurit më 08 tetor 2013(xxxxx).

Prokurori pretendoi se më 08 tetor 2013, gjatë zbatimit të urdhrit të ligjshëm të kontrollit në vendin ku jetonte i pandehuri H.G., policia gjeti dy qind e shtatëdhjetë e shtatë (277) fishekë të kalibrit 7.62 mm, katërqind e njëzet e pesë (425) fishekë 9 mm, treqind e tridhjetë e tre (333) fishekë 7.65 mm, pesëdhjetë (50) fishekë 9 mm dhe nëntëmbëdhjetë (19) fishekë 12 mm (gjithsej një mijë e njëqind e katër municione – 1104)¹⁰⁵.

U vërtetua se i pandehuri nuk kishte leje apo autorizim për ta mbajtur këtë municion në zotërim ose kontroll të tij.

Mbrojtja mohoi se i pandehuri H.G. e ka kryer veprën penale, duke deklaruar se të gjitha municionet e gjetura në shtëpinë e të pandehurit H.G. ishin lënë në lidhje me një kontroll të bërë në vitin 2007 në të njëjtën adresë, dhe se babai i tij, Sh.G., ishte dënuar për këtë veprë.

Lidhur me këtë, Gjykatës iu ofruan prova materiale dhe u dëgjuan katër dëshmitarë.

Provat materiale:

- Procesverbali i kontrollit të shtëpisë më 08 tetor 2013.
- Raporti balistik¹⁰⁶ i datës 14 gusht 2014.
- Raporti i Policisë, i datës 05.11.2013, në lidhje me kontrollin e shtëpisë së Sh.G., i kryer më 09 korrik 2007.

Deklaratat e dëshmitarëve:

- N.G., Sh.G.¹⁰⁷, R. A. dhe E. A.¹⁰⁸

-Dëshmitari N.G., oficer i policisë, u dëgjua më 24 nëntor të vitit 2014. Ai i tha Gjykatës se kishte marrë pjesë në kontrollin e shtëpisë së të pandehurit H.G.. Pas përfundimit të kontrollit të shtëpisë ai përpiloi raportin mbi kontrollin, që tregon të

¹⁰⁵ Procesverbali i kontrollit të shtëpisë së të pandehurit, H.G., e datës ...

¹⁰⁶ Pas Aktakuza – Dosja e Prokurorisë, Dosja 1, tabela 13.

¹⁰⁷ Pas Aktakuza – Dosja e Prokurorisë, Dosja 1, tabela 13.

¹⁰⁸ Dëshmitarët e Prokurorisë

gjitha hapat që u ndërmorën lidhur me kontrollin, që do të thotë se kati i parë i shtëpisë në rrugën “xxxx”, nr. 337, në Prishtinë. Dëshmitari konfirmoi se ishte i pandehuri H.G. ai i cili e drejtoi policinë deri tek vendi ku ai jetonte, prandaj kontrolli u bë atje. Dëshmitari gjithashtu tha se kati ku u gjet municioni kishte qasje në të gjitha dhomat. Kur dëshmitari u pyet më hollësisht, ai iu referua raportit të tij¹⁰⁹, pasi ai tregon informatat më të sakta.

-Dëshmitari Sh.G., babai i H.G., u dëgjua më 28 janar 2015. Ai deklaroi se jetonte në një shtëpi të madhe me pesë djemtë e tij, por secili nga ata kishte katin e vet. Më tej, ai deklaroi se ndante të njëjtin kat me të pandehurin H.G.. Lidhur me municionin e gjetur më 08 tetor 2013, ai deklaroi se ky municion ishte i tiji, për çka ishte dënuar dhe tanimë e kishte kryer dënimin në vitin 2013. Se municioni kishte mbetur që nga koha e luftës, dhe kur ishte kryer kontrolli në vitin 2007, policia nuk e kishte marrë tërë municionin. Se as H.G., as djemtë e tjerë të tij nuk kishin dijeni për këtë municion, sepse dhoma ku u gjet municioni i përkiste atij. Si përfundim, ky dëshmitar përjashtoi ndonjë mundësi që H.G. kishte dijeni për këtë municion. Më tej, ky dëshmitar deklaroi se ai nuk kishte blerë ndonjë municion pas përfundimit të luftës së vitit 1999. Ai tha se municioni i gjetur gjatë kontrollit të shtëpisë më 08 tetor 2013 i përkiste atij dhe se i tërë municioni ishte nga koha e luftës. Ai gjithashtu tha se e kishte pasur municionin ndër shtrat dhe e kishte kaluar tek dollapi i teshave ku u gjet municioni gjatë kontrollit të tetorit 2013. Ai gjithashtu deklaroi se ishte në burg kur kishte ndodhur kontrolli i datës 09 tetor 2013. Ai më tej deklaroi se nuk flinte në atë dhomë të fjetjes ku kishte ndodhur kontrolli në tetor 2013. Ai flinte në dhomën e ditës së bashku me nënën e tij.

Dëshmitari R. A. u propozua nga mbrojtësi Z. P., dhe ai u dëgjua më 17 qershor të vitit 2015. Ai tha se ishte i pranishëm kur Policia bëri kontrollin e shtëpisë së H.G., më 08 tetor të vitit 2013, sepse, pasi që ata janë fqinj, ai rastisi të ishte jashtë kur kishte ardhur policia. Ai municion ishte gjetur në dhomën e babait të H.G., dhe në kohën e kontrollit nëna e H.G. po flinte në dhomë. Se kur u pyet nga policia, nëna e H.G. kishte deklaruar se municioni i përkiste bashkëshortit të saj. Se në kohën e kontrollit, babai i H.G. ishte në burg duke kryer dënimin lidhur me municionin.

¹⁰⁹ Dëshmitarët e mbrojtjes.

Dëshmitari, E. A. u propozua nga mbrojtësi Z. P., dhe u dëgjua më 17 qershor 2015. Ai deklaroi se plumbat ishin gjetur në një rën nga dhomat e shtëpisë së H.G., duke theksuar se në të njëjtën dhomë ishte nëna e H.G.t. Më tej, ky dëshmitar tha se në momentin kur policia po bënte kontrollin, ata kishin gjetur rrobat e njerëzve më të vjetër, domethënë rrobat e prindërve të H.G., dhe sipas tij kjo ishte dhoma e prindërve të H.G.. Se në kohën kur ndodhi kontrolli, të pranishëm kishin qenë H.G. dhe anëtarët e familjes së tij, zyrtarët e policisë, ai dhe vëllai i tij R. A. si dëshmitarë. Se babai i H. nuk ishte i pranishëm në ditën kur ishte bërë kontrolli dhe se nuk kishte informacion lidhur me vendndodhjen e tij. Megjithatë, ai kishte parë babanë e H. duke hyrë e dalë nga shtëpia në jetën e përditshme.

Gjykata gjithashtu dëgjoi deklaratën e të pandehurit H.G. gjatë shqyrtimit kryesor më 05 gusht 2015. Në deklaratën e tij i pandehuri në thelb mohoi të kishte kontroll dhe/ose të kishte zotëruar municionin e gjetur në shtëpinë e tij. I pandehuri deklaroi se ky municion kishte mbetur që nga kontrolli i shtëpisë në vitin 2007, sepse policia nuk e kishte marrë të tërën, dhe i kërkoi Gjykatës ta lirojë nga kjo akuzë.

Prokurori e ballafaqoi të pandehurin me Raportin Balistik, që përcakton se fishekët u prodhuan në vitin 2012; megjithatë i pandehuri këmbënguli se ai nuk kishte të bënte fare me municionin.

Gjykata mori parasysh dhe vlerësoi me kujdes provat e paraqitura nga Prokurori dhe mbrojtja dhe linjën e mbrojtjes së H.G..

Pasi dëgjoi dëshmitarët, versionin e të pandehurit dhe pasi analizoi Raportin e Mjekësisë Ligjore, procesverbalin e kontrollit të shtëpisë, të datës 08 tetor 2013, Raportin e Policisë lidhur me kontrollin e shtëpisë të kryer në vitin 2007, Gjykata gjeti përtej dyshimit të arsyeshëm se H.G. është kryerës i veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 374, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së, Ligji Nr. 03/L-246, neni 1.20, prandaj e dënoi atë me tri vjet burgim.

Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues gjeti të rëndësishëm më të lartë Raportin Balistik që tregon qartë se fishekët ishin prodhim i vitit 2012 kështu që është e panevojshme të thuhet se është e pamundur të kesh fishekë para se ato të

prodhoheshin. Më tej, edhe Raporti i Policisë në lidhje me kontrollin e shtëpisë në vitin 2007 nuk lë asnjë dyshim sepse ai deklaroi qartë se policia e konfiskoi të tërë municionin e gjetur në shtëpinë e Sh.G.t.

Gjykata nuk e gjeti të besueshme deklaratën e Sh.G. (babai i H.G.) për arsyen e thjeshtë se ky dëshmitar donte ta çorientonte Gjykatën duke thënë se municioni kishte mbetur nga kontrolli i vitit 2007, sepse kjo ishte në kontradiktë me Raportin e Policisë si provë materiale. Për më tepër, Gjykata vëren se, meqenëse ky dëshmitar ishte babai i të pandehurit, është e pritshme që dëshmia e tij të jetë në mbështetje të djalit të tij, pavarësisht se kishte bërë betimin.

Sa u përket deklaratave të R. dhe E. A., Gjykata arrin në përfundim se ato nuk janë të ndonjë rëndësie të veçantë për vendimin e trupit gjykues, pavarësisht faktit se ata thanë se nëna e H.G. ishte në të njëjtën dhomë ku ishin gjetur plumbat. Arsytet për gjetjen e deklaratave të R. dhe E. A. si të pa mbështetshme ishin se H.G. u kishte treguar oficerëve të policisë për katin ku jetonte. Më tej, babai i të pandehurit H.G. deklaroi se kjo dhomë ishte përdorur si depo, kështu që Gjykatës iu paraqitën versione kundërthënëse nga personat që u ftuan të dëshmojnë në dobi të të pandehurit.

Prandaj, pas vlerësimit të provave të lartpërmendura një nga një dhe në tërësi, Gjykata arriti në përfundimin se i pandehuri H.G. e ka kryer veprën penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, në shkelje të nenit 374, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së, Ligji Nr. 03/L-246, neni 1.20, prandaj e dënoi atë me tre vjet burgim.

CAKTIMI I DËNIMIT

Trupi gjykues, para se të merret saktësisht me dënimin që duhet shqiptuar në lidhje me të pandehurit,¹¹⁰ dhe para se të përcaktojë faktorët rëndues dhe lehtësues në këtë lëndë, duhet t'u kushtojë kujdes vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës

¹¹⁰ Duke përjashtuar H.G., i cili u lirua nga akuza për veprën penale të krimit të organizuar.

dhe të Gjykatës së Apelit në lidhje me lëndët ku një person i akuzuar është dënuar për krim të organizuar.

Caktimi i dënimit për akuzën e krimit të organizuar

Lëndët **S.A dhe të tjerët** (Gjykata Supreme e Kosovës, Vendimi i datës 02 tetor 2012) dhe **J.P.** (Gjykata e Apelit, Vendimi i datës 22 tetor 2013) i duken trupit gjykues se përcaktojnë këto propozime si më poshtë:-

- a. Se dënimi për veprën penale të krimit të organizuar kërkon të provohet kryerja e një ‘krimi të mundësuar’ prej saj.
- b. Se kryerja e krimit të mundësuar është pjesë përbërëse e veprës penale të krimit të organizuar.
- c. Se vepra penale primare, kësisoj, është ajo e krimit të organizuar.
- d. Se të lejosh që një dënim të strukturohet ndryshe do të ishte e barasvlershme me një dënim të dyfishtë.
- e. Se në strukturimin e dënimit për krim të organizuar, dënimi duhet të shqiptohet për atë vepër penale, e kryer në bashkëlidhje me vepra të tjera penale.
- f. Se duhet të caktohet një dënim i vetëm për krim të organizuar.

Prandaj trupi gjykues në këtë lëndë procedoi me dënimin e të pandehurve me burgim për veprën penale të krimit të organizuar, në shkelje të nenit 283, paragrafi 1, të KPRK-së, e kryer në lidhje me veprën penale të grabitjes, në shkelje të nenit 329, paragrafi 3, të KPRK-së. Gjykata, kësisoj, do të shqiptojë vetëm një dënim, për akuzën e krimit të organizuar, dhe për këtë arsye, në këtë lëndë nuk lind asnjë çështje për dënim unik.

Struktura e dënimit.

1. Së pari, Gjykata e konsideron të përshtatshme të përcaktojë se ku qëndron sjellja e të pandehurit në gamën e peshës së veprës.
2. Trupi gjykues pastaj do të identifikojë faktorët rëndues, faktorët të cilët janë përkatës, por mund të trajtohen si “neutralë” në kuptim të dënimit, dhe pastaj do të identifikojë faktorët lehtësues. Gjykata pastaj do të peshojë faktorët dhe të arrijë në dënimin që duhet shqiptuar.

3. Trupi gjykues vëren se të pandehurit A.S., R.A., G.A. and E.G. u gjetën fajtorë për krim të rëndë të kryer jashtë territorit të Kosovës.
4. Trupi gjykues vëren se vepra penale e pjesëmarrjes aktive në një grup të organizuar kriminal është vepër penale e rëndë në Republikën e Kosovës. Sipas nenit 283, paragrafi 1, Gjykata mund të shqiptojë gjobë deri në dyqind e pesëdhjetë mijë (250,000) euro dhe burgim me së paku shtatë (7) vjet. Në këto kushte, trupi gjykues ka diskrecion shumë të gjerë sa i përket dënimit të përshtatshëm që duhet caktuar.
5. Trupi gjykues u referohet këtu gjetjeve faktike të tij lidhur me përgjegjësinë e të pandehurve.

Para se të procedojë për të treguar dënimin e supozuar që duhet të tërheqë ky krim, trupi gjykues e konsideron të përshtatshme të identifikojë faktorët rëndues që janë të pranishëm në këtë lëndë:-

1. E para, trupi gjykues gjeti përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit janë fajtorë për veprën penale të krimit të organizuar, e lidhur me grabitjen. Ky faktor është tejet i rëndësishëm në përcaktimin e fajësisë së të pandehurve.
2. Se veprat penale u kryen me qëllimin për të siguruar një përfitim financiar; ky është padyshim një faktor rëndues duke marrë parasysh se vepra ndodhi në një shtet tjetër dhe rezultoi në përdorimin e forcës dhe shkaktimin e dëmit të madh pasuror ndaj dyqanit Rolex në Bahrejn. Për më tepër, roja i sigurisë M. Z. pësoi lëndime.

Në mënyrë të ngjashme Gjykata vëren se një i akuzuar ka të drejtë të testojë plotësisht provat kundër tij dhe ta drejtojë lëndën në mënyrën që ai dëshiron dhe se vetë-deklarimi jo fajtor është diçka për të cilën i akuzuari nuk do të dënohej kurrë. Megjithëse pati prova të shumta kundër të pandehurve, asnjëri prej tyre nuk u vetë-deklarua fajtor, as tregoi ndonjë pendim për veprat penale. Prandaj, në këtë lëndë nuk ekziston asnjë rrethanë lehtësuese.

Trupi gjykues beson se duke marrë parasysh rrethanat rënduese, humbjen e lehtësimit për arsyet e cekura më lart, dhe në mënyrë të vendosur faktorët lehtësues me më pak peshë, se dënimi i saktë që duhet caktuar ndaj të pandehurit A.S. është, për rrjedhojë, dymbëdhjetë (12) vjet burgim. Arsyeja për këtë është se gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se ai luajti rol shumë aktiv në grup duke bërë më

shumë përpjekje se të tjerët në këtë lëndë. Të pandehurit R.A., G.A. dhe E. A. duhet të dënohen me njëmbëdhjetë (11) vjet burg.

Gjithashtu të pandehurit A.S., R.A., G.A. dhe E.G. gjobiten me 12,550 euro secili nisur nga pesha e veprës penale dhe për shkak të gjetjeve të Gjykatës se i vetmi qëllim ishte përfitimi pasuror.

Në lidhje me të pandehurin H.G., arsyet e njëjta u morën parasysh gjatë përcaktimit të dënimit. U vërtetua përtej dyshimit të arsyeshem se ai është kryerësi i veprës penale sipas Nenit 374, paragrafët 1 dhe 2, të KPRK-së, Ligji nr. 03/L-246, Neni 1.20. Megjithëse kishte prova kundër tij, ai nuk u vetë-deklarua fajtor, as tregoi ndonjë pendim. Për më tepër, një sasi e konsiderueshme municioni u gjet në posedim dhe/ose kontroll të tij, prandaj gjykata vlerësoi se dënimi prej tre vjetësh burgim do të ishte i përshtatshëm.

Si përfundim, kur vendosi lidhur me dënimet për të pandehurit A.S., R.A., G.A., E.G. dhe H.G., Gjykata i kushtoi veçanërisht vëmendje përgjegjësisë penale të të gjithë të pandehurve, dhe vjen në përfundimin se me këto dënime, do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet në nenin 41 të KPRK-së, dhe se këto dënime janë në proporcion me shkallën e rrezikut të veprave penale, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurve.

Në bazë të nenit 83 (1) të KPRK-së, koha e kaluar në paraburgim nga 8 tetori 2013 (G.A., R.A., H.G.), 16 nëntori 2013 (A.S.) dhe 17 shtatori 2013 (E.G.) deri në datën e këtij Aktgjykimi, do të përfshihen në periudhën e dënimit.

Paraburgimi kundër A.S., R.A., G.A. dhe E.G. vazhdohet derisa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë, por jo më gjatë se afati i dënimit me burgim të shqiptuar në Aktgjykimin e shpallur më 7 gusht 2015.

Municioni konfiskohet në pajtim me paragrafin 3 të nenit 374 të KPRK-së.

Kërkesa pasurore juridike për kompensim të dëmit

Sa i përket kërkesës pasurore juridike të palëve të dëmtuara, Gjykata i thirri ato në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 11 dhjetor 2014, dhe ato u informuan në afat se në pajtim me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ato kanë të drejtë të bëjnë kërkesë pasurore juridike për kompensim dëmi nëse dëshirojnë. Të dyja palët deklaruan se do ta përdorin këtë të drejtë. Më tej, më 28 maj 2015, Gjykata përmes Njesisë për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar kontaktoi me

autoritetet e Bahrejnit dhe kërkoi që palët e dëmtuara të informohen se Gjykata nuk kishte pranuar ndonjë kërkesë për kompensim, dhe kërkoi që palët e dëmtuara të informohen për të drejtën e tyre që të paraqesin fjalë përfundimtare nëse dëshirojnë. Pak ditë më vonë, Gjykata u informua se palët e dëmtuara nuk dëshirojnë të paraqesin ndonjë fjalë përfundimtare.

Gjatë seancës së mbajtur më 17 qershor 2015, Prokurori i dorëzoi Gjykatës dhe të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre dy Kërkesa pasurore juridike për kompensim dëmi: një nga pronari i studios artet moderne, në shumën e përgjithshme prej 623,406 eurosh, dhe kërkesa pasurore juridike e dytë për kompensim dëmi nga z. M. Z., roje, në shumën e përgjithshme prej 10.000 dollarësh amerikanë. Mbrojtja kërkoi nga Gjykata që t'i referojë palët e dëmtuara të ndjekin të drejtat e tyre përmes kontestit gjyqësor.

Trupi gjykues vlerësoi gjerësisht të dy kërkesat pasurore juridike dhe erdhi në përfundimin se ato duhet të përcillen në kontest civil. Sa i përket kërkesës pasurore juridike të Rolex-it, trupi gjykues tërheq vëmendjen në deklaratën e Menaxherit të dyqanit, i cili u dëgjua më 02 korrik 2014, ku në mënyrë eksplicite ai deklaroi se të gjitha orët ishin të mbuluara me sigurim dhe se ata presin që Kompania e Sigurimeve të sjellë një vendim në lidhje me këtë çështje. Për më tepër, ky dëshmitar deklaroi se Kompania do të kompensojë çdo gjë: orët e humbura, ato të dëmtuara, fitimin e humbur, si dhe do të kthejë shumën e parave që ky dyqan ka paguar për të mbuluar dëmet e shkaktuara nga të pandehurit.

Trupi gjykues thekson se vetë kërkesa pasurore juridike nuk bën fjalë nëse Kompania e Sigurimeve e ka kompensuar Dyqanin Rolex, as tregon fazën e kësaj procedure në Mbretërinë e Bahrejnit. Duke pasur parasysh se ishte një procedurë në vazhdim në Mbretërinë e Bahrejnit, trupi gjykues e konsideroi më të përshtatshme që t'i referojë palët e dëmtuara t'i ndjekin kërkesat pasurore juridike të tyre në kontest civil. Për më tepër, gjatë vlerësimit të këtyre kërkesave pasurore juridike, trupi gjykues konsideroi se përfundimi i këtij shqyrtimi gjyqësor do të ishte zgjatur po të vendoste edhe lidhur me këto kërkesa. Megjithëse kërkesat pasurore juridike tregonin shumat, trupi gjykues ka në mendje çështjet që ngritën mbrojtësit, prandaj ka konsideruar se këto çështje kërkojnë më tepër kohë që të trajtohen. Për më tepër, të pandehurit janë në paraburgim dhe Gjykatës iu desh të dilte me vendim sapo të mbyllej procedura e provave. Natyrisht, Gjykata nuk pati asnjë qëllim të minonte të drejtat që gëzojnë palët e dëmtuara; megjithatë, kërkesat pasurore juridike të palëve të dëmtuara ka më shumë të ngjarë të jenë synuar për t'u vendosur në procedurë civile, sepse çështjet kryesore nuk ishin qartësuar si të

tilla; nëse Kompania e Sigurimit i kompensuar vërtet, nëse po, në çfarë mase e kështu me radhë.

Arsyetimi i njëjtë është edhe sa i përket kërkesës pasurore juridike për kompensim të palës së dëmtuar M. Z. sepse në deklaratën e tij të dhënë më 11 dhjetor 2014, ai theksoi se kishte mbulim nga kompania e sigurimeve, dhe kërkesa pasurore juridike e tij hesht në lidhje me këtë.

Prandaj, për hir të shmangies së një vendimi të ndërthurur, palët e dëmtuara u referuan t'i ndjekin kërkesat pasurore juridike për kompensim në kontest gjyqësor civil. Duke vepruar kështu, Gjykata zbatoi nenin 463, paragrafi 2, të KPPRK-së që thotë [...] “Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesshëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.” Prandaj, nisur nga sa më lart, trupi gjykues arriti këtë përfundim dhe e konsideron si të panevojshme ta diskutojë atë më tutje.

Për këto arsye, Gjykata gjen si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Marie Tuma

Kryetare e Trupit Gjykses

Muhamet Musliu

Proces-mbajtës

Mjet ligjor:

Personat e autorizuar mund të bëjnë ankesë në formë të shkruar kundër këtij Aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës për Gjykatën e Apelit, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të Aktgjykimit, në pajtim me nenin 380, paragrafit 1, të KPPRK-së.